GJYKATA E RRETHIT
TIRANE
Nr. 12910 Aktit

12910

A M C
ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS
Nr. 17
Data 23.12.95

Tirane, me 22 Nentor 1995

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM
PER REGJISTRIM PERSONI JURIDIK

Sot, me date 22 Nentor 1995, une Floriana Tafa gjyqtare prane kesaj gjykate, pasi studjova kerkesen dhe materialet e tjera te paraqitura nga Ministria e Financave per regjistrimin e Shoqerise Anonime pa oferte publike "Albanian Mobile Communications" sh.a (AMC sh.a) si person juridik ne Regjistrin Tregtar

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "Albanian Mobile Communications sh.a. eshte krijuar ne baze te Ligjit 7296, date 20 Prill 1995 "Per Transformimin e Ndermarrjeve Shteterore ne Shoqeri Tregtare" dhe te Vendimit 609, date 23 Tetor 1995 te Keshillit te Ministrave dhe zoterohet teresisht nga Ministria e Financave si Aksioner i Vetem;
se kohezgjatja e shoqerise eshte e pacaktuar, me seli ne Tirane, Rruga e Durresit;
me kapital 2 milion leke te nenshkruar teresisht ne diten e krijimit te saj,
se Keshilli Mbikqyres i Shoqerise perbehet nga Edmond Leka, Mimoza Dhembi e Gjergj Buxhuku;
se shoqeria do te kryeje implementimin e rrjetit mobil GSM ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe do te ofroje edhe sherbime te tilla, si:
-komunikime baze te levizshme ne rrjetet lokale te bazuara ne kanalet radio,
-komunikime baze ne rrjetet interurbane ne transmetimet radio,
-komunikime nderkombetare ne cdo lloj mjeti transmetimi dhe komutimi,
-komunikime te dhenash ne nivelin kombetar e ate nderkombetar,
-komunikime multimediale dhe ISDN,
-komunikime teletekst dhe videotekst,
-komunikime te anijeve ne afersi te bregut shqiptar dhe te avioneve ne hapesiren ajrore shqiptare,
-sherbime me vlere te shtuar,
-sherbime te komunikimit publik me monedhe,
-karta krediti ose karta te parapaguara etj.

Kerkesa per regjistrimin e Shoqerise si person juridik ne Regjistrin Tregtar eshte e mbeshtetur ne ligj dhe

PER KETO ARSYE,

une gjyqtarja, ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe te Ligjit 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe duhen Respektuar nga Shoqerite Tregtare"

VENDOSA:

Regjistrimin e shoqerise anonime "Albanian Mobile Communications"(AMC) sh.a, si person juridik ne Regjistrin Tregtar,
me aksioner te vetem Ministrine e Financave,
me kohezgjatje te pacaktuar;
me kapital 2 milion leke te nenshkruar teresisht ne diten e krijimit te saj,
me anetare te Keshillit Mbikqyres Edmond Leka, Mimoza Dhembi e Gjergj Buxhuku;
me seli ne Tirane, Rruga e Durresit;
me objekt implementimin e rrjetit mobil GSM ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe kryerjen e sherbimeve te tilla, si:
-komunikime baze te levizshme ne rrjetet lokale te bazuara ne kanalet radio,
-komunikime baze ne rrjetet interurbane ne transmetimet radio,
-komunikime nderkombetare ne cdo lloj mjeti transmetimi dhe komutimi,
-komunikime te dhenash ne nivelin kombetar e ate nderkombetar,
-komunikime multimediale dhe ISDN,
-komunikime teletekst dhe videotekst,
-komunikime te anijeve ne afersi te bregut shqiptar dhe te avioneve ne hapesiren ajrore shqiptare,
-sherbime me vlere te shtuar,
-sherbime te komunikimit publik me monedhe,
-karta krediti ose karta te parapaguara etj.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne gjykaten e Apelit.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR /[illegible]/ AKT.
5212

V E N D I M
I
GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 15.5.1998 une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane [illegible] ,mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit Z.Ylli Bufi per depozitimin ne rregjistrin tregtar te Urdherit nr. 102 date 6.04.1998 per ndryshimin e Keshillit Mbikqyres te sh.a."A.M.C." dhe te vendimit te Keshillit Mbikqyres nr.2 date 10.04.1998 ne baze te nenit 105 dhe 98 te ligjit 7638 date 19.11.1992 dhe

KONSTATOVA

Se aktet e paraqitura nga kerkuesi jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj

PER KETE ARSYE :
Ne baze te nenit 24 te ligjit nr. 7667 date 28.01.1993

V E N D O S A :

- Pranimin e kerkeses.
-Depozitimin e Urdherit nr.102 date 6.04.1998 te aksionerit te vetem te shoqerise duke bere shenimin ne fleten perkatese te rregjistrit ne kolonen 4 dhe 5 me kete permbajtje:
Zevendesimin e anetareve te pare te Keshillit Mbikqyres :
1) z. Edmond Leka , 2) znj. Mimoza Dhembi , 3) z.Gjergj Buxhuku nga
1) z. Apostol Noti, 2) z. Pirro Koci , 3) z. Dhame Pite.
- Depozitimin e vendimit te Keshillit Mbikqyres nr.2 date 10.04.1998 me kete permbajtje:
1) z.Adrian Shehu , Drejtor i Pergjithshem i SH.A. "A.M.C." lirohet nga detyra.
2) z.Genc Hamzaraj emerohet Drejtor i Pergjithshem i SH.A. "A.M.C.".

Tirane, me 15.5.1998

GJYQTARE
[illegible]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 12910/1 **VENDIMI**
6979

VENDIM
I
GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 29.08.99 une gjyqtare e Gjykates Rrethit Tirane Emila Capo mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Zv/Ministri I Ekonomise Publike dhe Privatizimit per depozitimin ne rregjistrin tregtar te projektit per bashkimin e sh.a."Albanian Mobile Communictions" me sh.a. "Uzina Telekomit" Tirane dhe

K O N S T A T O V A

Se shoqeria anonime "Albanian Mobile Communications" Tirane eshte rregjistruar si person juridik ne gjykaten e rrethit Tirane me vendimin nr.12910, date 27.11.1995 Sh.a."Uzina Telekomit" Tirane eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr.14617,date 23.04.1996.
Me V.K.M.NR.279,date 22.04.1996 eshte vendosur bashkimi I ketyre shoqerive me ane te perthithjes ne zbatim te nenit 253 te ligjit 7638,date 19.11.1992.Shoqeria anonime e krijuar quhet "Albanian Mobile Communications"Tirane me kapital 813.822.000 lekedhenumer aksionesh 813.822.
Se aktet e paraqitura nga kerkuesi jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj.

PER KETE ARSYE :

Ne baze te nenit 24 te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin e projektit per bashkimin e sh.a."Albanian Mobile Communications" Tirane me sh.a."Uzina e Telekomit" Tirane me ane te perthithjes nga sh.a."Albanian Mobile Communications" ne baze te nenit 253 te ligjit 7368,date 19.11.1992.Shoqeria e re ekrijuar quhetsh.a."Albanian Mobile Communications" Tirane me kapital 813.822.000 leke dhe numer aksionesh 813.822..

GJYQTARE

Emila Capo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 12910/2 **VENDIMI**
6975

VENDIM
I
GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 24.08.99 une gjyqtare e Gjykates Rrethit Tirane Emila Cako mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Ministri I Ekonomise Publike dhe Privatizimit per depozitimin ne rregjistrin tregtar te urdherit per bashkimin e sh.a."Albanian Mobile Communictions" me sh.a. "Uzina Telekomit" Tirane dhe

K O N S T A T O V A

Se shoqeria anonime "Albanian Mobile Communications" Tirane eshte rregjistruar si person juridik ne gjykaten e rrethit Tirane me vendimin nr.12910, date 27.11.1995 Sh.a."Uzina Telekomit" Tirane eshte rregjistruar si person juridik me vendimin nr.14617,date 23.04.1996.
Me V.K.M.NR.279,date 22.04.1996 eshte vendosur bashkimi I ketyre shoqeriveme ane te perthithjes ne zbatim te nenit 253 te ligjit 7638,date 19.11.1992.Me urdherin nr.269,date 15.07.1999 Ministri I E.P.P. ka vendosur bashkimin e ketyre shoqerive.Shoqeria ere quhet "Albanian Mobile Communications"Tirane me kapital themeltar 813.822.000leke dhe numer aksionesh 813.822.
Se aktet e paraqitura nga kerkuesi jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj.

PER KETE ARSYE :

Ne baze te nenit 24 te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin e Urdherit per bashkimin e sh.a."Albanian Mobile Communications" Tirane me sh.a."Uzina e Telekomit" Tirane me ane te perthithjes nga sh.a."Albanian Mobile Communications" ne baze te nenit 253 te ligjit 7368,date 19.11.1992.
Te ndahen rregjistrimet nga njeri-tjetri.

GJYQTARE

Emila Capo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 12910/3 **Akt.**
71 94

VENDIM

I

GJYQTARIT TE VETEM

Une, gjyqtare e Gjykates se Rrethit Tirane M. Deda, sot me date 14-10-1999 mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Zv/Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit Z.Pajtim Bello per depozitimin ne rregjistrin tregtar te Urdherit nr.269/1. date 21.09.1999 te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit. per disa ndryshime ne aktet e themelimit te Sh.A."Albanian Mobile Communications" Tirane dhe

K O N S T A T O V A

Se shoqeria anonime "Albanian Mobile Communications" Tirane eshte rregjistruar si person juridik ne Gjykaten e rrethit Tirane me vendimin Nr.12910. date 27.11.1995.

Me Urdherin nr.269/1, date 21.09.1999 te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit kerkohet depozitimi ne rregjistrin tregtar i ndryshimeve ne aktet e themelimit te Sh.a. "Albanian Mobile Communications" Tirane si me poshte:

I. Statuti i shoqerise ndryshon si me poshte:

Neni 1 formulohet

Emri i shoqerise

Eshte themeluar shoqeria anonime e emertuar"Albanian Mobile Communications" Sh.a. shkurt "A.M.C." sh.a.

Neni 2 formulohet:

Selia

2.1 Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Laprakë, Rruga Gjergj Legisi.

2.2 Mbledhja e Jashtëzakonshme e aksionereve mund të hapë ose të mbyllë seli te tjera dytësore në Shqipëri dhe jashtë.

2.3 Drejtoria mund të hapë ose te mbyllë çdo lloj zyre tjetër pa përfaqësi te përhershme, në Shqipëri apo jashtë.

2.4 Lidhur me marrëdhëniet ndërmjet Shoqërisë dhe aksionerëve, vendbanimi i çdo aksioneri është ai i përcaktuar në regjistrin e aksionerëve.

Neni 3 formulohet:

Kohezgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar

Neni 4 formulohet:

Objekti

4.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë eshte implementimi i rrjetit të lëvizshëm GSM ne të gjithë territorin e Republikës së Shqipërise dhe jashtë. Shoqëria do të ofrojë shërbimet e mëposhtme:
komunikim bazë të lëvizshem ne rrjetin lokal te bazuar në kanalet e radios;
komunikim bazë në rrjetin ndër-qytetar i lidhur me transmetimin me radio;
komunikim ndërkombëtar të çfarëdo lloj transmetimi dhe komotimi;
komunikim të dhënash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
komunikim të multimedias dhe ISDN, komunikim me teletekst dhe videotekst;
radio-komunikim detar, ajror, hapësinor dhe satelitor;
shërbime me vlerë të shtuar, shërbime të komunikimit publik me monedha, karta krediti apo karta të parapaguara, etj.

4.2 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, për të arritur qëllimet e përmendura, Shoqëria mund te:
kryejë çdo transaksion lidhur me pasuri te luajtshme apo të paluajtshme, gjithashtu edhe çdo aktivitet tregtimi, financiar, qiradhënieje apo hipotekimi, i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm nga Drejtoria me qëllim që të arrihet qëllimi i Shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos kryhen ne tejkalim të atyre të përmendura më sipër;
kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi
nënshkruajë letra me vlerë apo garanci te çfarëdo lloji, duke përfshirë garancitë e pagimit të kambialit;

marrë, direkt apo indirekt, interesa ne shoqëri të tjera, të cilat mund të kenë qëllim të njëjtë me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë

Neni 5 formulohet:

Kapitali i Shoqerise - Aksionet

5.1 Kapitali i nënshkruar dhe plotesisht i paguar i Shoqërisë është 813 822 000 leke, i cili përbëhet nga 813 822 aksione me vlerë nominale prej 1,000 (një mijë) lekë për aksion. Çdo aksion është i pandashëm dhe siguron te drejtën e një vote.

5.2 Transferimi inter vivos i aksioneve te Shoqërisë i nënshtrohet të drejtës se parablerjes në favor te aksionerëve te tjere, te cilët mund te ushtrojnë këtë te drejtë brenda 20 ditësh nga marrja e letrës se derguar me poste rekomande që permban oferten. Percaktimet që parashikohen ne kete Nen nuk do te zbatohen për shitjet dhe transferime e kryera nga aksionerët ne favor te aksionereve te tjerë. Megjithatë, ne këtë rast, transferimi duhet t'i njoftohet me parë aksionerëve te tjerë me shkrim. Te gjitha njoftimet e parashikuara ne kete Nen duhet t'i adresohen edhe Shoqërisë.

5.3 Ne rastin e rritjes se kapitalit te Shoqerisë, aksionet e reja i ofrohen aksionereve ne proporcion me numrin e aksioneve te zoteruara, ne bazë te Nenit 155 dhe me pas, te ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" ("Ligji").

5.4 Drejtoria mund te udhëzojë qe te leshohet një çertifikatë e re ne vend te ndonjë çertifikate te lëshuar me parë nga Shoqëria te konsideruar te humbur ose te shkatërruar. Kur autorizohet lëshimi i një çertifikate te re, Drejtoria, me diskrecionin e tij dhe si një kusht paraprak i lëshimit te tyre, mund te percaktojë afatet dhe kushtet që konsiderohen te përshtatshme, dhe mund te kërkojë dëmshperblimet e konsideruara te përshtatshme, per te mbrojtur Shoqërinë nga ndonjë padi e cila mund te ngrihet kundër saj lidhur me çertifikatat te cilat pretendohen te kenë humbur ose te jetë shkatërruar.

Neni 6 formulohet:

Mbledhja e Aksionereve

6.1 Organi vendim-marrës i Shoqerisë eshte Asambleja e Aksionerëve, e cila perbehet prej te gjithë aksionereve te Shoqerisë. Mbledhja e Aksionerëve mund te jete e Zakonshme apo e Jashtëzakonshme. Mbledhja e Aksionerëve mund te mblidhet edhe ne një vend te ndryshëm nga selia, brenda Shqipërisë.

6.2 Mbledhja e Aksionereve thirret nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës ose nga Kryetari i Drejtorisë. Ajo mund te thirret gjithashtu ne perputhje me Nenin 132 te Ligjit.

6.3 Thirrja e Mbledhjes se Aksionereve rregullohet nga Ligji.

6.4 Mbledhja e Aksionereve do te konsiderohet e thirrur ne menyrën e duhur edhe nëse nuk janë respektuar formalitetet që rregullojnë procedurën e thirrjeve, me kusht që të gjithë Aksionerët janë të pranishëm apo perfaqësohen me prokurë dhe të gjithë anetarët e Këshillit Mbikqyrës, Drejtorët dhe Kontrolluesit janë të pranishëm.

6.5 Aksionerët të cilët janë regjistruar që prej të paktën 5 (pesë) ditësh në regjistrin e aksionerëve dhe aksionerët të cilët depozitojnë aksionet e tyre në bazë të udhëzimeve dhe afateve të përcaktuara në njoftimin e thirrjes mund të marrin pjesë në Mbledhjen e Aksionerëve. Njoftimi i thirrjes duhet të japë mundësinë aksionerët e huaj të depozitojnë aksionet e tyre në një bankë, e cila duhet të jete korrespondent i një banke të autorizuar, te ndodhur në vendin ku aksioneri i huaj ka vendbanimin sipas regjistrit të aksionerëve. Në këtë rast, aksioneri i cili dëshiron te ndjekë mbledhjen, duhet të depozitojë çertifikatën e depozitimit të aksioneve në bankë ne vend te aksioneve.

6.6 Të gjitha Mbledhjet e Aksionerëve drejtohen nga Kryetari i Drejtorisë apo ne vend të tij nga Zëvendës Kryetari, ose, nese keta persona nuk janë të disponueshëm, nga nje Anëtar i Drejtorisë apo edhe nga një aksioner i emëruar nga Mbledhja e Aksionereve. Mbledhja e Aksionerëve cakton një sekretar të mbledhjes, i cili mund të jete ose jo aksioner.

6.7 Aksionerët mund të përfaqesohen ne Mbledhjen e Aksionerëve, me një prokurë te shkruar, nga një aksioner tjetër ose nga bashkëshorti/ja e tij/saj. Megjithatë, çdo aksioner apo person i tretë nuk mund te përfaqesojë me shumë se tre aksionerë të tjerë.

6.8 Kryetari ka kompetenca te plota për të verifikuar prokurat dhe rregullsinë e tyre, te drejtën e aksionerëve dhe përfaqësuesve te tyre për të marrë pjesë në Mbledhjen e Aksionerëve dhe të vendosë nëse ajo është e mbledhur rregullisht dhe nëse është i pranishëm quorumi i aksionerëve me qëllim që të merren vendime te vlefshme; ai ka gjithashtu të drejtën të drejtojë diskutimet dhe të përcaktojë metodat dhe procedurat e votimit.

6.9 Procesverbalet e mbledhjeve nenshkruhen nga Kryetari i Mbledhjes dhe nga sekretari.

Neni 7 formulohet:

Mbledhja e Zakonshme

7.1 Mbledhja e Zakonshme e aksionereve do te mbahet te pakten nje here ne vit brenda 6 muajsh nga fundi i vitit financiar ,me qellim qe te diskutohen ,shqyrtohen dhe miratohen raportet financiarete vitit te kaluar financiar.

7.2 Mbledhja e zakonshme e aksionereve quhet vlefteshmerisht e mbledhur ne mbledhjen e saje te pare ne se marrin pjese aksioneret,te pranishem apo te perfaqsuar qe zoterojne te pakten 25% te aksioneve me te drejte vote.Ne rast se ky quorum nuk arrihet

mund te mbahet nje mbledhje e dyte, pa u kerkuar ndonjë quorum. Mbledhja e Zakonshme e Aksionerëve merr vendim me shumicën e aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar.

Neni 8 formulohet

Mbledhja e Jashtezakonshme

8.1 Vetëm Mbledhja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të vendosë ndryshimin e statutit në të gjitha nenet e tij.

8.2 Mbledhja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve quhet e thirrur vlefshmërisht me mbledhjen e saj të parë nëse marrin pjesë Aksionerët, të pranishëm ose të përfaqësuar, të cilët zotërojnë të paktën 50% (pesëdhjete perqind) të aksioneve me të drejtë vote, dhe me mbledhjen e dytë nëse marrin pjesë Aksionerë, të pranishëm apo të përfaqësuar, qe zotërojnë të paktën 25% (njëzet e pese perqind) të aksioneve me të drejtë vote.

8.3 Në rast se ky quorum nuk arrihet, mbledhja e dytë mund të shtyhet për një datë te mëvonshme, por jo më vonë se 2 muaj nga data e thirrjes së mbledhjes së parë

8.4 Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve vendos me një shumicë prej 3/4 (tre te katërtat) e aksionereve, të pranishem apo të përfaqësuar.

Neni 9 formulohet:

Përbërja dhe Emërimi i Anetarëve të Këshillit Mbikqyrës

9.1 Këshilli Mbikqyres perbëhet nga nje numër prej 3 (tre) deri 12 (dymbedhjete) anëtarë. 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve emerohen nga Asambleja e Aksionerëve. 1/3 (një e treta) e anëtarëve emërohen nga punemarresit e shoqërisë, në përputhje me Ligjin

9.2 Afati i qëndrimit të tyre në detyre eshtë 2 (dy) vjet dhe ata të gjithë mund te rizgjidhen. Anëtarët e emëruar nga Mbledhja e Aksionerëve mund të revokohen për çfarëdo arsye nga Mbledhja e Zakonshme e Aksionerëve. Anëtaret e emëruar nga punëmarrësit mund te revokohen në përputhje me ligjin.

9.3 Në rast vdekjeje, shkarkimi apo dorëheqje, vendet vakant duhet te zëvendesohen brenda jo me shume se 3 muajsh. Anetaret e Këshillit Mbikqyrës, te emeruar per te zëvendësuar një anëtar tjetër, do te qendrojne ne post për te gjithë kohën e mbetur te mandatit te paraardhësit.

9.4 Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk mund te marrin pjesë ne me shume se 5 (pesë) Këshilla Mbikqyrës te tjera te shoqerive anonime, te cilat kanë selinë e tyre ne territorin e Republikës se Shqipërisë.

9.5 Në përputhje me ligjin, Mbledhja e Aksionerëve mund të caktojë shpërblim për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës.

Neni 10 formulohet:

Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Këshillit Mbikqyrës

10.1 Këshilli Mbikqyrës emëron një Kryetar dhe një Zëvendës Kryetar nga anëtarët e tij të cilët janë caktuar të thërrasin mbledhjet e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe mund të rizgjidhen.

10.2 Kryetari dhe Zëvendës Kryetari i Këshillit mund të marrin shpërblim shtesë, të caktuar nga Këshilli.

10.3 Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një sekretar qoftë edhe jo nga anëtarët e tij.

10.4 Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjet e Këshillit drejtohen nga Zëvendës Kryetari.

Neni 11 formulohet:

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

11.1 Këshilli Mbikqyrës mblidhet rregullisht të paktën një herë në tre muaj dhe sa herë që interesi i Shoqërisë e kërkon, me thirrjen e Kryetarit ose, në mungesë të tij, të Zëvendës Kryetarit.

11.2 Kryetari do të thërrasë Këshillin Mbikqyrës brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga kërkesa e motivuar e Drejtorisë ose të 1/3 (një të tretës) së anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Nëse kjo kërkesë mbetet pa përgjigje, kërkuesi mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit, duke përcaktuar rendin e saj të ditës.

11.3 Thirrja bëhet 3 (tre) ditë para mbledhjes, me anë të një letre, telegrami, teleksi apo telefaksi. Thirrja mund të jetë e vlefshme edhe kur është gojore apo pa ndonjë afat kohor nëse anëtarët e Këshillit Mbikqyrës do ta pranojnë atë.

11.4 Çdo thirrje përmban rendin e ditës të propozuar të mbledhjes.

11.5 Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në çfardo vendi tjetër të treguar në thirrje.

11.6 Procesverbali mbahet nga sekretari dhe nënshkruhet nga ai dhe nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës. Procesverbalet mbahen në një regjistër të veçantë.

11.7 Këshilli Mbikqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme pa praninë e të paktën gjysmës së anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Në raste votash të barabarta, vota e Kryetarit është vendimtare.

Neni 12 formulohet:

Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

12.1 Këshilli Mbikqyrës emëron anëtarët e Drejtorisë, duke caktuar një prej tyre Kryetar të Drejtorisë, dhe përgjigjet për mbikqyrjen e politikave dhe aktiviteteve të Shoqërisë.

12.2 Këshilli Mbikqyrës ka përgjegjësinë të sigurojë që aktivitetet dhe funksionimi i Shoqërisë janë në përputhje me ligjin. Ai rishikion dhe mbikqyr çdo situatë aktuale apo të mundshme konflikti interesash dhe, në përputhje me ligjin, merr prej anëtarëve të Drejtorisë të gjitha njoftimet e konflikteve aktuale apo të mundshme të interesave apo interesave materiale që ata mund të kenë me Shoqërinë. Këshilli Mbikqyrës nxjerr udhëzime në lidhje me ruajtjen e sekretit dhe konfidencialitetit për informacionet në lidhje me Shoqërinë si dhe kontrollon zbatimin e tyre.

12.3 Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të kryejë të gjitha verifikimet dhe mbikqyrjet që i quan të përshtatshme për përmbushjen e të gjitha detyrave të tij.

12.4 Këshilli Mbikqyrës i paraqet Këshillit Mbikqyrës komentet e tij mbi raportin vjetor të nxjerrë nga Drejtoria në përputhje me Nenin 130 të Ligjit.

12.5 Këshilli Mbikqyrës, ndër të tjera, mbikqyr aktivitetin e Drejtorisë, miraton kriteret e marrjes në punë, vendet e punës dhe shpërblimet e punonjësve të shoqërisë dhe jep autorizimin për lidhjen e marrëveshjeve që kërkojnë autorizim në bazë të Ligjit.

Neni 13 formulohet:

Drejtoria

13.1 Shoqëria drejtohet nga një Drejtori e përbërë nga një numër prej 3 (tre) deri në 9 (nëntë) Drejtorësh, të cilët mund të jenë ose jo aksionerë, të emëruar nga Këshilli Mbikqyrës. Këshilli Mbikqyrës emëron Kryetarin e Drejtorisë ndërmjet Drejtorëve të emëruar, dhe, nëse është e nevojshme, një Zëvendës Kryetar dhe një apo më shumë Drejtorë Ekzekutivë, të cilëve Drejtoria mund t'u delegojë disa nga kompetencat e saj.

13.2 Drejtorët emërohen për një afat prej 2 (dy) vitesh me të drejtë rizgjedhjeje.

13.3 Kryetari i Drejtorisë përfaqëson ligjërisht shoqërinë. Këshilli Mbikyrës gjithashtu mund t'i japë Zëvendës Drejtorit dhe Drejtorit Ekzekutiv, nëse ka, ose një Drejtori kompetencën të përfaqësojnë shoqërinë së bashku apo më vete.

13.4 Përfaqësuesit e mësipërm ligjorë të shoqërisë mund të emërojnë një përfaqësues "ad negotia" për ushtrimin e detyrave apo kategorive të detyrave të veçanta, brenda kufijve të kompetencave të dhëna.

13.5 Këshilli Mbikqyrës mund të vendosë shpërblime për anëtarët e Drejtorisë në momentin e emërimin e tyre.

13.6 Anëtarët e Drejtorisë mund të shkarkohen nga Këshilli Mbikqyrës në çdo kohë për arsye të ligjshme, në bazë të Ligjit.

13.7 Në rast të ndonjë vendi bosh në Drejtori për shkak vdekje, dorëheqje, shkarkimi, mungese kualifikimi apo çdo shkaku tjetër, pasardhësi që do të plotësojë vendin do të zgjidhet nga Këshilli Mbikqyrës në mbledhjen e parë që ndjek lënien bosh të vendit Pasardhësi do të përfundojë mandatin e personit në vendin e të cilit ai është emëruar Nëse shumica e anëtarëve heq dorë nga detyra, prezumohet se e gjithë Drejtoria ka hequr dorë dhe si rrjedhim Këshilli Mbikqyrës duhet menjëherë të procedojë për emërimin e një Drejtorie të re.

Neni 14 formulohet:

Mbledhja e Bordit të Drejtorëve

14.1 Kryetari thërret mbledhjen e Drejtorisë, duke përcaktuar rendin e ditës, në çdo kohë që e quan të nevojshme apo në rast se ai merr një kërkesë me shkrim nga të paktën një anëtar i Drejtorisë ose i Këshillit Mbikqyrës. Kërkesa duhet të përmbajë listën e çështjeve apo temave që duhen diskutuar. Në rast se Kryetari refuzon të therrasë mbledhjen brenda 2 (dy) ditëve nga marrja e kërkesës, mbledhja mund të thirret nga personi kërkues. Drejtoria do të thirret me anë të një letre rekomande, telegrami ose telefaksi të dërguar të paktën 3 (tre) ditë përpara mbledhjes. Në rast urgjence mbledhja mund të thirret nga telegrami apo telefaksi i dërguar një ditë para ditës së caktuar të mbledhjes. Në rast se Kryetari mungon ose për ndonjë arsye nuk ka mundësi të marrë pjesë në mbledhje, të gjitha funksionet e përcaktuara në këtë nen i transferohen Zëvendës Kryetarit, nëse ka, ose Drejtorit më të vjetër në detyrë. Drejtoria do të mblidhet në mënyrë të vlefshme edhe nëse nuk është bërë njoftimi formal i thirrjes, me kusht që të gjithë Drejtorët të jenë të pranishëm.

14.2 Bordi mund të emërojë një Sekretar për të mbajtur procesverbalin dhe i verifikon ato me anë të firmave së bashku me Kryetarin ose, në rast se ai mungon, me një prej anëtarëve të pranishëm. Sekretari mund të jetë edhe një person i cili nuk është anëtar i Drejtorisë.

14.3 Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve do të mbahen të paktën një herë në tre muaj, në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër, në Shqipëri apo jashtë, dhe mund të zhvillohen edhe me telekonferencë ose videokonferencë, ose me anë të mjeteve të ngjashme

elektronike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të identifikohen dhe tu jepet mundësia të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë aktive në to. Nëse ekzistojnë këto kushte Drejtoria quhet e mbledhur në vendin ku ndodhen Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të mbajnë procesverbalin dhe të venë firmat e mbledhjes në librin përkatës të mundshëm.

14.4 Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve quhen të mbledhura në mënyrë të vlefshme kur janë të pranishëm shumica e Drejtorëve. Vendimet e Drejtorisë janë të vlefshme kur miratohen me votën pro të shumicës së Drejtorëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, vota e Kryetarit është vendimtare.

Neni 15 formulohet:

Kompetencat e Drejtorisë

15.1 Drejtorisë i jepen të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të nevojshme për arritjen e qëllimit të Shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji apo Statuti ia rezervon organeve të tjera.

15.2 Drejtoria do të mbajë llogaritë e duhura dhe do të pregatisë pasqyrat financiare në përputhje me Ligjin. Drejtoria i paraqet një raport Këshillit Mbikqyrës të paktën një herë në tre muaj. Drejtoria i paraqet Këshillit Mbikqyrës llogaritë vjetore me qëllim që t'i verifikojë dhe kontrollojë ato të paktën brenda tre muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 16 formulohet:

Kontrollorët

16.1 Kontrolli i brendshëm i shoqërisë kryhet nga tre ekspertë kontabël të autorizuar, të emëruar për një vit financiar.

16.2 Kontrollorët emërohen nga Mbledhja e Zakonshme e Aksionerëve, e cila emëron gjithashtu dy Kontrollorë alternativë.

16.3 Në bazë të Nenit 93 të Ligjit, Kontrollorë të parë emërohen:

_____

_____

_____

16.4 Kontrollorë alternativë emërohen:

_____

_____

Neni 17 formulohet:

Viti Financiar – Inventari – Llogaritë Vjetore

17.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti.

17.2 Drejtoria mban një regjister të rregullt të pasurisë dhe të aktivitetit të [illegible] përputhje me ligjin. Në fund të vitit financiar, Drejtoria harton inventarin e pasurisë [illegible] në këtë datë dhe llogaritë vjetore për vitin financiar.

Neni 18 formulohet:

Rezultati i Vitit Financiar dhe Përcaktimi i Fitimit

18.1 Drejtoria harton bilancin vjetor me përputhje me ligjin. 5% e fitimit [illegible] rezultojnë nga bilanci i miratuar në bazë të dispozitave të Ligjit mbahet për [illegible] kryesore deri sa kjo rezervë të arrijë 10% e kapitalit të shoqërisë.

18.2 Fitimi i mbetur shpërndahet me bazë të vendimeve të Mbledhjes së Aksionerëve [illegible] shpërndarjen e dividentëve apo zërave të fitimit.

Neni 19 formulohet:

Likujdimi dhe Mbyllja

19.1 Shoqëria ka të drejtë e mbyllur me rastet e parashikuara në Ligj. Në rast mbyllje Mbledhja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve emëron një apo më shumë likuidatorë, [illegible] dhënë atyre kompetencat përkatëse.

19.2 Shoqëria mund gjithashtu të shpërndahet apo të bashkohet me një tjetër me vendim [illegible] të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Aksionerëve.

Neni 20 formulohet:

Dispozita Përfundimtare

20.1 Në përputhje me Ligjin Nr. 7926, datë 20.04.1995 ndryshuar me akte [illegible] ligjore, për sa kohë që Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit e Republikës [illegible] Shqipërisë, për llogari të qeverisë Shqiptare do të jetë e vetmja aksionere, pavarësisht [illegible] nenet e këtij statuti.

a) asambleja perbehet nga aksioneri I vetem I perfaqesuar nga Ministri I Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe per kete arsye nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9.1, nuk zbatohen.

b) keshilli mbikqyres perbehet nga tre anetare te cilet emerohen nga Ministri I Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

c) 85% e fitimit neto qe rezulton nga bilanci mbahet per rezervat e zhvillimit. Fitimi I mbetur duke zbritur rezerven kryesore I kalon Buxhetit te Shtetit.

d) persa nuk eshte shprehur ne statut, I referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

II. Ndryshimin ne aktet e themelimit te "Albanian Mobile Communications" sh.a. Tirane.

1) Pika 2 e aktit themelimit formulohet:

Objekti I Shoqerise eshte:

Objekti I aktivitetit te shoqerise eshte implementimi I rrjetit te levizshem GSM ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte. Shoqeria do te ofroje sherbimet e meposhteme:

komunikim baze te levizshem ne rrjetin lokal te bazuar ne kanalet e radios;
komunikim baze ne rrjetin nderqytetar I lidhur me transmetimin me radio;
komunikim nderkombetar te cfaredolloj transmetimi dhe komotimi;
komunikim te dhenash me nivel kombetar dhe nderkombetar;
komunikim te multimedias dhe ISDN, komunikim me teletekst dhe videotekst;
radiokomunikim detar ajror, hapesinor dhe satelitor;

sherbime me vlere te shtuar,sherbime te komunikimit publik me monedha,karta krediti apo karta te parapaguara etj.
Ne perputhje me legjislacionin shqiptar per te arritur qellimet e permendura shoqeria mund te :
kryeje cdo transaksion lidhur me pasurite e luajtshme apo te paluajtshme,gjithashtu edhe cdo aktivitet tregtimifinanciar,qiradhenie apo hipotekimi,i cili mund te konsiderohet I dobishem apo I nevojshem nga drejtoria me qellim qe te arrihet qellimi I shoqerise me kusht qe keto aktivitete te mos kryhen ne tejkalim te atyre te permendura me siper,
kryeje aktivitet publikimi dhe reklamimi,
nenshkruaje letra me vlere apo garanci te cdo lloji,duke perfshire garancite e pagimit te kambialit,
marre dierk apo indirekt interesa ne shoqeri te tjera te cilat mund te kene qellim te njejte me ate te shoqerise,ne Shqiperi apo jashte.

2) Pika 3 e aktit te themelimit formulohet :

Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne Tirane,Laprake,rruga Gjergj Legisi.

Nga shqyrtimi I akteve te depozituara rezulton se kerkesa e paraqitur eshte e bazuar dhe dokumentacioni I paraqitur me kete rast eshte I plote.

PER KETE ARSYE:

Ne baze te nenit 24 te ligjit nr.7667,date 28.01.1993

V E N D O S A :

Depozitimin ne zyren e rregjistrit tregtar te urdherit nr.269/1,date 21.09.1999 te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit z.Ylli Bufi lidhur me disa ndryshime ne aktet e themelimit te sh.a. "Albanian Mobile Communications" Tirane,duke bere shenimin shenimin ne fleten perkatese te rregjistrit ne kolonen Nr.4 dhe 5.
Te ndahen rregjistrimet me vije nga njera-tjetra. Te publikohet vendimi I mesiperm.

GJ Y Q T A R E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. AKT. 2510/4

V E N D I M
I
GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 17.01.2000, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane Marjona Lleshi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Zv Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit Z.Pajtim BELLO per depozitimin ne rregjistrin tregetar te Urdhrit nr.6 date 8.1.2000 "Per ndryshim ne Keshillim Mbikqyres" dhe

KONSTATOVA

se aktet e paraqitura nga kerkuesi jane te plota dhe kerkesa e bazuar ne ligj.

PER KETE ARESYE:

ne baze te nenit 24 te Ligjit nr. 7667 date 28.01.1993

V E N D O S A:

-Pranimin e kerkeses.
-Depozitimin e urdhrit nr. 6 date 8.1.2000 te aksionerit te vetem te shoqerise duke bere shenimin ne fleten perkatese te rregjistrit ne kolonen 4 dhe 5 me kete permbajtje: "Zevendesimin e anetarit te Keshillit Mbikqyres te shoqerise AMC SH.A. Z. Aposto NOTI nga Z. Pirro XHIXHO".

Tirane, me 17.01 **2000**

G J Y Q T A R E

Marjona Lleshi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT TIRANË

Nr. i Vendimit 12910/5

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETËM

Sot, më datë 21.12.2000, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Enkela Bajo pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "Albanian Mobile Comunications – AMC" sh.a. (më poshtë referuar si "Shoqëria") e paraqitur prej drejtorit të përgjithshëm të Shoqërisë, si dhe dokumentat e tjera bashkëngjitur kërkesës,

KONSTATOVA:

Shoqëria **"Albanian Mobile Communications - AMC"** Sh.A. është regjistruar si person juridik me vendim nr. 12910 datë 27 nëntor 1995. Ortaku Themelues i saj është Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit e Republikës së Shqipërisë. Në bazë të ligjit 8515 datë 21 07.1999 dhe ligjit 8660 datë 18.09.2000 shoqëria është privatizuar duke i shitur 85% të aksioneve shoqërisë së të drejtës greke Cosmoholding Albania S.A.

Më datë 23.08.2000 është zhvilluar mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Shoqërisë me pjesëmarrjen e 100% të kapitalit për të diskutuar mbi këtë rend dite:

1. Paraqitjen në Asamble të letrave të dorëheqjes të anëtarëve të Këshillit të Mbikqyrjes;
2. Paraqitjen në Asamble të letrave të dorëheqjes të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.
3. Emërimi i anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikqyrës.

Cosmoholding Albania S.A zotëruese e 85% të aksioneve përfaqësohej nga Z. Stefanos Octapodas dhe Z. Alexandros Athanasiou. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit përfaqësohej nga Z. Pirro Xhixha.

Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës pas një diskutimi të hollësishëm, Asambleja me unanimitet vendosi të pranojë dorëheqjen e Z. Pirro Xhixha dhe Z. Dhame Pite nga posti i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës Asambleja me unanimitet vendosi pranimin e dorëheqjes së Z. Genci Hamzaraj nga posti i drejtorit të shoqërisë.

Në lidhje me pikën e tretë të rendit të ditës pas një diskutimi të hollësishëm Asambleja me unanimitet vendosi të emërojë anëtarë të këshillit mbikqyrës të shoqërisë:

- Z. Nikolaos MANASIS, qytetar grek, lindur më 05.07.1944, në Selanik dhe banues në Athinë, Kifissia (43, Petros Str.), Pass. nr. M 545536; dhe
- Z. Dimitris SCOULICARIS, qytetar grek, lindur më 12.06.1938, në Kriti Kritsa Lasithiou dhe banues në Athinë (Agathoupoleos Str.), Pass. nr. M 234959

Në vijim të sa më sipër në datë 23 gusht 2000 u zhvillua Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë për të zgjedhur drejtorinë e re. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm Z. Nikolaos Manasis dhe Z. Dimitris Scoulicaris.

Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës vendosi të emërojë Drejtorinë e Shoqërisë si më poshtë:

1. Drejtor i Përgjithshëm	Z. Stefanos Octapodas
2. Zv. Drejtor i Përgjithshëm	Z. Genc Hamazaraj
3. Anëtar	Z. Evangelos Martigopoulos
4. Anëtar	Z. Elias Fotiadis
5. Anëtar	Z. Nikolaos Tsolas
6. Anëtar	Znj. Irini Nikolaidi

Sot më datë 12.12.2000, duke u mbështetur në Nenin 8 të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", Z. Stefanos Octapodas ka paraqitur kërkesë para Gjykatës së Rrethit Tiranë për të depozituar në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate vendimet e mësipërme.

Pasi shqyrtova kërkesën e saj çmova se ajo është e drejtë dhe e bazuar në ligj

PËR KËTO ARSYE:

Dhe në bazë të ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar"

VENDOSA:

Pranimin e kërkesës së Shoqërisë Albanian Mobile Communications – AMC Sh.A.

Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë të vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë datë 23 gusht 2000 dhe vendimit të Këshillit Mbikqyrës datë 23 gusht 2000.

Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse në kolonën nr.....7....., dhe nr. rendor ..... në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të kësaj Gjykate, duke bërë vërejtjet me bojë të kuqe.

Tiranë më 4. 12.2000

GJYQTARE

ENKELA BAJO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr 12910/6

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me datë 5/6 . 06.2001, unë gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Rrethit Tiranë Anila Capo, pasi mora në shqyrtim kërkesën e kërkuesit, Shoqërisë "Albanian Mobile Communications AMC" Sh.A., shkurt "AMC" Sh.A. e përfaqësuar me prokurë nga Av. Erinda Ballanca lindur në Tiranë, më 29.10.1973 dhe pasaportë nr. 0368205

K O N S T A T O V A SE :

Shoqëria "AMC" Sh.A., (më poshtë, "Shoqëria") është një shoqëri anonime me ofertë publike e të drejtës shqiptare me seli në Rr. Gjergj Legisi, Laprakë, Tiranë, regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit të Tiranës me vendimin nr. 12910 datë 27.11.1995.

Shoqëria ka një kapital të nënshkruar dhe të paguar prej 813.822.000 lekë, i cili përbëhet nga 813.822.000 aksione me vlerë nominale prej 1.000 lekë. Kë Shoqëri e ushtron aktivitetin e saj kryesor në fushën e telekomunikacioneve, asisti si është parashikuar me hollësi në vendimin e Gjykatës.

Në datën 29.03.2001 është zhvilluar Mbledhja e Zakonshme e Asamblesë së Shoqërisë "AMC" Sh.A., ku qenë të pranishëm Z. Stefanos Oktapodas, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të Cosmoholding Albania Sh.A., Z. Vasil Pano, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, dhe Z. Genci Hamzaraj në cilësinë e të ftuarit, që së bashku përbëjnë quorumin.

Në këtë mbledhje u parashtrua fakti se Z. Dimitris SCOULICARIS, anëtari i Këshillit Mbikqyrës (më poshtë, "Këshilli"), kishte hequr dorë nga nga çdo angazhim në grupin e Cosmote-s dhe kështu iu propozua Mbledhjes ta zëvendësojë atë, duke zgjedhur një anëtar të ri të Këshillit, në përputhje me nenin 105 të Ligjit 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare". Kryetari sugjeroi zgjedhjen e një anëtari të ri të Këshillit, e pikërisht të Z. Megaklis STOUKIDIS, qytetar grek, inxhinier elektronik, me eksperiencë të madhe në sektorin e telekomunikacioneve të lëvizshme, profili profesional i të cilit i prezantohet të pranishmëve nga ana e kryetarit. Pasi ortakët i analizuan ato dhe pasi diskutuan rreth tyre në detaj, vendosën me unanimitet por marrjen e vendimit si më poshtë vijon:

- Zgjedhjen e Z. Megaklis STOUKIDIS, qytetar grek, lindur në Lesvos (Greqi), më 6.12.1953 e banues në Agiou Dimitrou, Psyhico (Greqi), me numër pasaporte M 873513, si anëtar i ri i Këshillit Mbikqyrës të AMC-së, në postin e Zëvendës Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës të AMC-së. Z. Megaklis STOUKIDIS zëvendëson Z. Dimitris SCOULICARIS.

Pasi shqyrtova kërkesën e Shoqërisë dhe dokumentacionin shoqërues, çmova se ajo është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE

dhe në bazë të ligjit 7638 datë 19.11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe të ligjit 7667 datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare"

VENDOSA

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Proçesverbalit të Asamblesë së Zakonshme të shoqërisë "AMC" Sh.A., me datë 29.03.2001, të vërtetuar rregullisht nga noteri, së bashku me dokumentet shoqëruese që janë:

   a) Prokurë e lëshuar në datë 27.03.2001, nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Z. Mustafa Muçi, në favor të Z. Vasil Paro, Drejtor i Drejtorisë së Privatizimit të Sektorëve Strategjikë pranë kësaj Ministrie, për të përfaqësuar këtë institucion në Mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme të Shoqërisë me datë 29.03.2001.

   b) Prokurë e lëshuar në datë 09.03.2001, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Cosmoholding Albania Sh.A., Z. Evagelos Martigopoulos, në favor të Z. Stefanos Oktapodas, për të përfaqësuar Cosmoholding Albania Sh.A., në Mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme, me datë 29.03.2001.

   c) Proçesverbal i mbledhjes nr. 7 të Bordit të Drejtorëve të Cosmoholding Albania Sh.A., datë 22.0[illegible].2001, ku është vendosur, ndër të tjera, edhe për tagrat e përfaqësimit të Drejtorit të Përgjithshëm Z. Evagelos Martigoluplos në lidhje me mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të shoqërisë "AMC" Sh.A., të vërtetuar rregullisht nga noteri.

3. Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit Tregtar për të bërë ndryshimet përkatëse me nr. vendor _____ në kolonën _____ duke bërë vijëzimet me bojë të kuqe.

GJYQTARE

ANILA CAPO

Tiranë, më __ __.05.2001

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË-TIRANË
Nr. i Vendimit 12910/7

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 26 Shkurt 2002, unë gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë-Tiranë, Enkela BAJO, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "Albanian Mobile Communications" Sh.A., shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar me Vendimin gjyqsor Nr. 12910, datë 27.11.1995, e përfaqësuar nga Z. Stefanos Oktapodas në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë, si dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur,

KONSTATOVA:

Shoqëria "Albanian Mobile Communications" Sh.A., shoqëri e së drejtës shqiptare, është regjistruar me Vendimin gjyqsor Nr. 12910, datë 27.11.1995.

Kjo Shoqëri ka një kapital të nënshkruar dhe të paguar prej 813.822.000 lekë, i cili përbëhet nga 813.822.000 aksione me vlerë nominale 1.000 lekë secili.

Veprimtarinë kryesore, kjo Shoqëri e ushtron në fushën e telekomunikacioneve, ashtu sikurse është parashikuar me hollësi në vendimin e Gjykatës.

Më datën 20 Dhjetor 2001, u thirr mbledhja e Këshillit Mbikqyrës të kësaj Shoqërie. Ishin të pranishëm Z. Nikolaos Manasis në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës dhe Z. Megaklis Stoukidis, në cilësinë e Nën-Kryetarit të këtij Këshilli. Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës u zhvillua rregullisht dhe në të u morën vendimet e mëposhtme:

1. Emërimi i Z. Evangelos Martigopoulos në cilësinë e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve;
2. Emërimi i Z. Elias Fotiadis në cilësinë e Nën-Kryetarit të Bordit të Drejtorëve;
3. Emërimi i Z. Stefanos Oktapodas në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv;
4. Caktimi i të drejtave dhe përgjegjësive të Kryetarit, Nën-Kryetarit të Bordit të Drejtorëve dhe Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë, të cilat paraqiten me hollësi në Procesverbalin dhe Vendimin e Këshillit Mbikqyrës;
5. Miratimi i dorëheqjes së Z. Genc Hamzaraj nga detyra e Nën-Drejtorit të Pergjithshëm. Si pasojë e kësaj dorëheqjeje dhe vendimeve të mësipërme, Bordi i Drejtorëve do të ketë përbërjen e mëposhtme:

   1) Z. Evangelos Martigopoulos, Kryetar;
   2) Z. Elias Fotiadis, Nën-Kryetar;
   3) Z. Stefanos Oktapodas, Drejtor Ekzekutiv;
   4) Z. Nikolaos Tsolas, anëtar;
   5) Z. Irini Nikolaidi, anëtar.

Më datë 07.02.2002, Shoqëria "Albanian Mobile Communications" Sh.A. i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë - Tiranë depozitimin në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, datë 20.12.2001.

PËR KËTO ARSYE

meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të plotësuara në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 28.01.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Dispozitat që rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës.
- Depozitimin në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë, datë 20.12.2001.
- Urdhërimin e zyrës së Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr. rendor _—_, në kolonën _—_ duke ndarë regjistrimet me bojë të kuqe.

Tiranë, 26/ 2 /2002

GJYQTARE

Enkela BAJO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË-TIRANË
Nr. i Vendimit 12910/3

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 15. 7. 2002, u.ë gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë-Tiranë. Majlinda Dogga, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "Albanian Mobile Communications" Sh.A., shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar me Vendimin gjyqsor Nr. 12910, datë 27.11.1995, e përfaqësuar nga Z. Stefanos Oktapodas në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë, si dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur,

KONSTATOVA:

Shoqëria "Albanian Mobile Communications" Sh.A., shoqëri e së drejtës shqiptare, është regjistruar me Vendimin gjyqsor Nr. 12910, datë 27.11.1995.

Më datën 31 Maj 2002, u thirr Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve të kësaj Shoqërie, e cila vendosi si vijon:

1. Të miratojë bilancin, llogarinë e fitimeve dhe humbjeve dhe inventarin e Shoqërisë për vitin 2001;

2. Të destinojë të gjitha të ardhurat që rezultojnë nga bilanci i Shoqërisë për rritjen e rezervave të Shoqërisë, duke patur parasysh investimet që AMC ka planifikuar për vitin 2002.

3. Të miratojë dorëheqjen e Z. Nikolaos Manasis nga detyra e Kryetarit dhe anëtarit të Këshillit Mbikqyrës dhe të emërojë Z. Eleftherios Dionisiou Antonakopoulos si anëtar të ri dhe Kryetar të këtij Këshilli.

4. Të depozitojë pranë Regjistrit Tregtar Proçes Verbalin e zgjedhjes së anëtarit të tretë të Këshillit Mbikqyrës së AMC-së Z. Ilir Duka, me cilësinë e përfaqësuesit të punonjësve të Shoqërisë.

5. Të miratojë emërimin e personave të mëposhtëm si Ekspertë Kontabël të Autorizuar për kontrollin e brendshëm të AMC-së gjatë vitit financiar 2001:

   - Mr. Jorgji Bollano;
   - Mr. Kosta Nika.

6. Të emërojë personat e mëposhtëm si Ekspertë Kontabël të Autorizuar për kontrollin e brendshëm të AMC-së gjatë vitit financiar 2002:

- Mr. Jorgji Bollano;
- Mr. Kosta Nika.

7. Të miratojë ratifikimin e kontratave të lidhura nga Shoqëria nga Janari i vitit 2001 deri më sot.

Shoqëria "Albanian Mobile Communications" Sh.A. i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë - Tiranë depozitimin në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të Vendimit të Asamblesë së Zakonshme të Shoqërisë, datë 31.05.2002.

PËR KËTO ARSYE

meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të plotësuara në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 28.01.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Dispozitat që rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës.
- Depozitimin në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të Vendimit të Asamblesë së Zakonshme të Shoqërisë, datë 31.05.2002.
- Urdhërimin e zyrës së Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr. rendor _____, në kolonën _____ duke ndarë regjistrimet me bojë të kuqe.

Tiranë, ___/___/2002

GJYQTARE

Majlinda DOGGA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË-TIRANË
Nr. i Vendimit 12910/9

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 26.9.2003, unë gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë-Tiranë, Majlinda Dogga, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "Albanian Mobile Communications" Sh.A., shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar me Vendimin gjyqsor Nr. 12910, datë 27.11.1995, e përfaqësuar nga Z. Stefanos Oktapodas në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë, si dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur,

KONSTATOVA:

Shoqëria "Albanian Mobile Communications" Sh.A., shoqëri e së drejtës shqiptare, është regjistruar me Vendimin gjyqsor Nr. 12910, datë 27.11.1995.

Më datë 2 Korrik 2002 është mbajtur mbledhja e Këshillit Mbikqyrës të kësaj Shoqërie në të cilën, ndër të tjera u vendos riemërimi i anëtarëve të mëposhtëm të Drejtorisë:

1. Z. Evangelos Martigopouolos, Kryetar;
2. Z. Elias Fotiadis, Nën-Kryetar;
3. Z. Stefanos Oktapodas, Drejtor Ekzekutiv;
4. Z. Nikolaos Tsolas, anëtar;
5. Znj. Irini Nikolaidi, anëtare.

Më datën 28 Maj 2003, u thirr Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve të AMC-së, e cila ndër të tjera vendosi si më poshtë:

1. të emërojë personat e mëposhtëm si Ekspertë Kontabël të Autorizuar për kontrollin e brendshëm të AMC-së gjatë vitit financiar 2003:

   - Z. Jorgji Bollano;
   - Z. Kosta Niko.

2. të emërojë Z. Kyriakakis Konstantinos Ioanis, lindur në 28.07.1949 dhe banues në Kiffisias 44, Greqi, mbajtës i pasaportës Nr. N475020 si anëtar të Këshillit Mbikqyrës deri më 29.05.2005;

3. të emërojë Z. Megaklis Stoukidis, lindur më 6.12.1953 dhe banues në Agiou Dimitriou, Athinë, mbajtës i pasaportës nr. M873513, si anëtar të Këshillit Mbikqyrës të AMC deri më 29.05.2005;

Më datë 10 Korrik 2003, u mbajt Asambleja e Jashtzakonshme e Aksionerëve të shoqërisë, e cila ndër të tjera vendosi të ndryshojë Nenin 16.1 dhe 16.2 të Statutit të shoqërisë si më poshtë:

"16.1 Kontrolli i brendshëm i shoqërisë kryhet nga dy ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar, të emëruar për një vit financiar.

16.2 Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen nga Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve, e cila emëron gjithashtu një ose më shumë zëvendsekspertë kontabël të autorizuar."

Shoqëria "Albanian Mobile Communications" Sh.A. i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë - Tiranë depozitimin në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të Procesverbalit të Mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës datë 2.07.2002 dhe të Vendimit e Procesverbalit të Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë, datë 28.05.2003.

PËR KËTO ARSYE

meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të plotësuara në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 28.01.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Dispozitat që rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës.
- Depozitimin në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të Procesverbalit të Mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës datë 2.07.2002;
- Depozitimin në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të Vendimit e Procesverbalit të Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë, datë 28.05.2003;
- Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë, datë 10.07.2003
- Urdhërimin e zyrës së Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr. rendor _____, në kolonën _____ duke ndarë regjistrimet me bojë të kuqe.

Tiranë, 26 / 9 /2003

GJYQTARE

Majlinda Dogga

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË-TIRANË
Nr. i Vendimit 12.5.6/16

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETËM

Mr. Stefanos OKTAPODAS is called to chair this ordinary shareholders meeting. The Chairman invites Mr. Krenar LOLOCI to act as secretary. The Chairman verifies and acknowledges that the following shareholders, representing the 100 % of the share capital of the Company, are present at the meeting:

Present in person:

- COSMOHOLDING – ALBANIA S.A., represented by Mr. Stefanos OKTAPODAS and by Mr. Alexandros ATHANASIOU, representing 85 % of the share capital of the Company;
- MINISTRY OF PUBLIC ECONOMY AND PRIVATIZATION, represented by Mr. Pirro XHIXHO, representing 15 % of the share capital of the Company;

There are also present, as observers, Mr. Krenar LOLOCI and Mr. Genci HAMZARAJ.

* * *

The Chairman controls the regularity of the convocation of the general meeting. The Chairman, in compliance with Art. 133 of law no. 7638 dated 19.11.1992 "*On Commercial Companies*", as amended, noting that is regularly present 100 % of the share capital of the Company declares the meeting regularly held.

* * * *

The President open the discussion following the items indicated in the agenda.

1. SUBMISSION TO THE ASSEMBLY OF LETTERS OF RESIGNATION OF THE MEMBERS OF THE COUNCIL OF SUPERVISORS

Motion:

The President presents to the Assembly the letters of resignation of Mr. Pirro XHIXHO and Mr. Dhame PITE as members of the Council of Supervisors of the Company

After throughout discussion on the issue, the Assembly unanimously

APPROVES

the resignation of Mr. Pirro XHIXHO and Mr. Dhame PITE from their quality of members of the Council of Supervisors of the Company.

* * * *

2. SUBMISSION TO THE ASSEMBLY OF LETTERS OF RESIGNATION OF THE MEMBERS OF THE BOARD OF DIRECTORS

Motion:

The President presents to the Assembly the letter of resignation of Mr. Genci HAMZARAJ as General Manager of the Company. The President informs the Assembly that Mr. Hamzaraj resignation is being examined by the Assembly because of the resignations of the members of the Council of Supervisors. Once the Assembly will appoint new members of the Council of Supervisors, such resignation will be forwarded to them for approval and, eventually, appointment of new Board of Directors.

After throughout discussion on the issue, the Assembly unanimously

APPROVES

the resignation of Mr. Genci HAMZARAJ from the position of General Manager of the Company.

* * * *

3. MISCELLANEOUS

Due to the issue raised in item , above, the Assembly asks to the President to include in the agenda a new issue to be discussed as follow:
"Appointment of members of the Supervisory Council"

After throughout discussion on the issue, the Assembly unanimously

APPROVES

to include in the agenda to be discussed today such issue.

Following such proposal and in compliance with Artt. 105 and following of law no. 7638 dated 19.11.1992 "*On Commercial Companies*", as amended, and Art. 9 of the by-laws of the Company, the President invites the Assembly to vote:

After throughout discussion on the issue, the Assembly unanimously

APPOINTS

- Mr. Nikolaos MANASIS Greek citizen, born on 5-07-1944, in Thessaloniki Kalamaria and resident in Athens Kifissia (43, Proteos Str.), Pass. no.M 545536; and
- Mr. Dimitris SCOULICARIS, Greek citizen, born on 12-06-1938, in Kriti Kritsa Lasithiou and resident in Athens (35, Agathoupoleos Str.) , Pass. no.M 234959;

In compliance with Artt. 109 and following of law no. 7638 dated 19.11.1992 "*On Commercial Companies*", as amended, the Assembly invites the Company's employees to appoint their members of the Supervisory council. In this respect an invitation will be exposed on the main entrance of the AMC building.

The Assembly invites the Council of Supervisors to appoint without delay a new Board of Directors.

* * * *

The Assembly suggests the date for the next Ordinary Assembly of the Company to be held at AMC headquarters on September 13, 2000 at 11.00 in first call and 12.00 in second call. The Assembly unanimously agrees on such date.

* * * *

The Chairman informs the shareholders that the matters to be resolved by decision of the ordinary shareholders meeting have been resolved upon and declares the meeting closed at 12.00 on August 23, 2000.

The Chairman	**The Secretary**
Mr. Stefanos OKTAPODAS	Mr. Krenar LOLOCI

Albanian Mobile Communications AMC –Sh.A
Rruga Gjergj Legisi, Laprakë, Tiranë
Tel: _ _ _ _ _ _ *Fax:* _____

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES SË ZAKONSHME TË AKSIONERËVE TË ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS AMC-Sh.A.

Në vitin 2000, më ditën e 23të të muajit Gusht, ora 10:00, u mbajt në selinë e Shoqërisë të vendosura në Rruga "Gjergj Legisi", Laprakë, Tiranë thirrja e parë e mbledhjes së zakonshme të aksionerëve të shoqërisë ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS AMC-Sh.A. ("Shoqëria"), për të diskutuar sa më poshtë:

RENDI I DITËS

1. **PARAQITJEN NË ASAMBLE TË LETRAVE TË DORËHEQJES TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË MBIKQYRJES;**
2. **PARAQITJEN NË ASAMBLE TË LETRAVE TË DORËHEQJES TË ANËTARËVE TË BORDIT TË DREJTORËVE;**
3. **TË NDRYSHME.**

***

Z. Stefanos OKTAPODAS, është ngarkuar me drejtimin e kësaj mbledhje të zakonshme të aksionerëve. Presidenti, fton Z. Krenar LOLOCI të kryejë detyrën e sekretarit. Kryetari verifikon dhe deklaron se aksionerët e mëposhtëm, përfaqësues të 100 % të kapitalit të Shoqërisë, janë të pranishëm në mbledhje:

Të pranishëm personalisht:

- COSMOHOLDING - ALBANIA S.A, përfaqësuar ligjërisht nga Z. Stefanos OKTAPODAS dhe Z. Alexandros ATHANASIOUS, të cilët përfaqësojnë 85 % të kapitalit aksioner të Shoqërisë.
- MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT, përfaqësuar ligjërisht nga Z Pirro XHIXHO, i cili përfaqëson 15 % të kapitalit aksioner të Shoqërisë;

Ndodhen gjithashtu të pranishëm, si vëzhgues, Z. Krenar LOLOCI dhe Z. Genci HAMZARAJ.

***

Presidenti kontrollon rregullshmërinë e thirrjes së mbledhjes së përgjithshme. Presidenti, në përputhje me Nenin 133 të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar,

paşi vëren se është i pranishëm rregullisht 100 % e kapitalit aksioner të Shoqërisë, deklaron mbledhjen rregullisht të mbledhur.

****

Presidenti, hap diskutimin sipas pikave të përcaktuara në rendin e ditës:

1. PARAQITJEN NË ASAMBLE TË LETRAVE TË DORËHEQJES TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË MBIKQYRJES;

Presidenti i paraqet Asamblesë letrat për dorëheqjen e Z. Pirro XHIXHO dhe Z. Dhame PITE si anëtarë të Këshillit të Mbikqyrjes të Shoqërisë.

Pas diskutimit në tërësi të çështjes, Asambleja unanimisht

MIRATOI

dorëheqjen e Z. Pirro XHIXHO dhe Z. Dhame PITE nga cilësia e anëtarëve të Këshillit të Mbikqyrjes të Shoqërisë.

****

2. PARAQITJEN NË ASAMBLE TË LETRAVE TË DORËHEQJES TË ANËTARËVE TË BORDIT TË DREJTORËVE;

Presidenti i paraqet Asamblesë letrën e dorëheqjes së Z. Genci Hamzaraj si Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë. Presidenti informon Asamblenë se dorëheqja e Z. Genci Hamzaraj po shqyrtohet nga Asambleja dhe për shkak të dorëheqjes së anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Me emërimin e Këshillit Mbikqyrës të ri, kjo dorëheqje do t'u paraqitet atyre për pranim dhe emërimin e Bordit të Drejtorëve të ri.

Pas diskutimit në tërësi të çështjes, Asambleja unanimisht

MIRATOI

dorëheqjen e Z. Genci HAMZARAJ nga posti i Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë.

****

3. TË NDRYSHME.

Për arësye të një çështje të lindur në pikën, 1 më sipër, Asamblea i kërkoi Presidentit të përfshijë në rendin e ditës një çështje të re për t'u diskutuar sa më poshtë:

"Emërimin e anëtarëve të Këshillit të Mikqyrjes"

Pas diskutimit në tërësi të çështjes, Asambleja unanimisht

MIRATOI

Të përfshijë në rendin e ditës për t'u diskutuar sot një çështje të tillë.

Në bazë të këtij propozimi dhe në përputhje me Nenin 105 të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe Nenit 9 të statutit të Shoqërisë, Presidenti fton Asamblenë të votojë pro:

Pas diskutimit në tërësi të çështjes, Asambleja unanimisht

EMËROI

- Z. Nikolaos MANASIS, qytetar grek, lindur më 05.07.1944, në Selanik dhe banues në Athinë, Kifissia (43, Petros Str.), Pass. nr. M 545536; dhe
- Z. Dimitris SCOULICARIS, qytetar grek, lindur më 12.06.1938, në Kriti Kritsa Lasithiou dhe banues në Athinë (Agathoupoleos Str.), Pass. nr. M 234959;

Në përputhje me Nenin 109 të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet përkatëse, Asamblea fton punonjësit e Shoqërisë të emërojnë anëtarët e tyre të Këshillit të Mbikqyrjes. Për këtë arësye do të ekspozohet një ftesë në hyrjen kryesore të ndërtesës së AMC-së.

Asambleja fton Këshillin e Mbikqyrjes të emërojë pa vonesë Bordin Drejtorëve të ri.

***

Asambleja sugjeron se Mbledhja e Zakonshme tjetër e Shoqërisë do të mbahet në selinë e AMC-së në datën 13 Shtator 2000, në orën 11:00 në thirrjen e parë dhe 12:00 në thirrjen e dytë. Asambleja unanimisht ra dakort në lidhje me datat e mësipërme.

***

Kryetari informon aksionerët se çështjet që u paraqitën për zgjidhje, me vendim të asamblesë si zakonshme u zgjidhën dhe e deklaron mbledhjen të mbyllur në orën 12:00, më 23 Gusht 2000.

Kryetari

Z. Stefanos OKTAPODAS

Sekretari

Z. Krenar LOLOCI

PULLË TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 6686 Rep.
Nr. _____ Kol.

VËRTETIM

Sot, më datë 11.12.2000, në Zyrën e Noterisë, para meje Mimoza Sadushi, u paraqitën personalisht:
1. Z. Stefanos OKTAPODAS, qytetar grek, lindur më 15.08.1955, në Athinë të Greqisë, dhe banues po aty në Heraklio Attica, me numër pasaporte N 585499, me cilësinë e Kryetarit të Mbledhjes së Zakonshme të Shoqërisë AMC Sh.A;
2. Z. Krenar LOLOÇI, qytetar shqiptar, lindur më 11.07.1957, në Tiranë, dhe banues po aty në Rr. "Zef Jubani", P. 3. Ap. 502, me numër pasaporte EV 220042 me cilësinë e Sekretarit të Mbledhjes së Zakonshme të Shoqërisë AMC Sh.A,
të dy madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilëve u binda pasi verifikova pasaportat e tyre, të cilët më deklaruan se këtë Proçesverval të Mbledhjes së Zakonshme të Shoqërisë AMC Sh.A, datë 13 Shtator 2000 e kanë hartuar jashtë zyrës së noterisë, me vullnetin e tyre ~~të plotë~~ dhe të lirë, dhe unë e vërtetoj atë sipas kërkesave të ligjit.

NOTERE

Mimoza SADUSHI

VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot, më datë 11.12.2000, deklarova se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i saktë i versionit anglisht dhe anasjelltas.

PËRKTHYESE

Entela XHEXHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. Rep. 6687

VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot më 11.12.2000, përpara meje, noteres, Mimoza Sadushi me zyrë noterie në Tiranë, u paraqit Entela Xhexhi, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, e cila më deklaroi se ka përkthyer dokumentin e mësipërm nga anglishtja në shqip, njëlloj me origjinalin, dhe e nënshkroi atë përpara meje, noteres, dhe unë e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERE

Mimoza SADUSHI

PULLË TAKSE
100 LEKË

ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS
(AMC)

MINUTES
OF
SUPERVISORY COUNCIL (SC)

Upon the request of Mr. Nikolaos Manasis, which constitutes one-thirds of the SC members, the Supervisory Council met on August 23, 2000. The agenda is the election of the Chairman and vice Chairman of the SC and the appointment of the members of the Board of Directors.

Two members of the SC were present:
Mr. Nikolaos Manasis and
Mr. Dimitris Scoulicaris

The SC member, who represents the AMC employees, has not been appointed yet.

Since two out of three SC members are present the meeting is valid. Mr. Scoulicaris, expressing his regret concerning the fact that the AMS employees has not been appointed yet, as well as his determination to influence on solving this problem, proposed as a Chairman of the SC Mr. Manasis. Mr. Manasis proposed that Mr. Scoulicaris became vice Chairman. The proposals were accepted.

The SC appointed the Board of Directors which consists of the following members:

1. General Director	Mr. Stefanos Octapodas
2. Vice General Director	Mr. Genc Hamazaraj
3. Member	Mr. Evangelos Martigopoulos
4. Member	Mr. Elias Fotiadis
5. Member	Nikolaos Tsolas
6. Member	Irini Nikolaidi

Having decided that, Mr. Manasis declared the meeting closed.

Chairman
Nikolaos Manasis

Vice Chairman
Dimitris Scoulicaris

Albanian Mobile Communications AMC - Sh.A.
Rruga Gjergji Legjisi, Laprake, Tirana
Tel: _____ *Fax:* _____

ANNEX TO THE MINUTES OF SUPERVISORY COUNCIL HELD ON AUGUST 23, 2000

MEMBERS OF THE BOARD OF DIRECTORS

In compliance with Art. 97 of law no. 7638 dated 19.11.1992, as amended, on "*Commercial Companies*", and Art. 19, paragraph 4 of law no. 7632, dated 4.11.1992 on "*the first part of the Commercial Code*" the following persons have been appointed as Directors of Albanian Mobile Communications AMC - Sh.A.

1. **GENERAL DIRECTOR**
   Mr. Stefanos OKTAPODAS, Greek citizen, Profession: Financial controller, born on 15-08-1955, in Athens Greece and resident in Athens Heraklio Attica, Pass. no. N 585499;

   Authorized signature: _____

2. **VICE GENERAL DIRECTOR**
   Mr. Genz HAMZARAJ, Albanian citizen, Profession: ENGINEER, born on 28.07.1961, in VLORE and resident in TIRANA, Pass. no. 1506397;

   Authorized signature: _____

3. **MEMBER OF THE BOARD OF DIRECTORS**
   Mr. Evangelos MARTIGOPOUOLOS, Greek citizen, Profession: CEO, born on 11-1 1959 , in Attica N. Palatia and resident in Athens N. Psichico (20, K. Palama Str.) , Pass. no. M 388447;

   Authorized signature: _____

4. **MEMBER OF THE BOARD OF DIRECTORS**
   Mr. Elias FOTIADIS, Greek citizen, Profession: CFO, born on13-12-1955, in Ileia Pyrgos and resident in Athens Halandri (11, Paparigopoulou Str.), Pass. no. N 473723;

   Authorized signature: _____

5. **MEMBER OF THE BOARD OF DIRECTORS**
   Mr. Nikolaos TSOLAS, Greek citizen, Profession: Enfineer, born on 11-02-1952, in Serres Chrysos and resident in Athens Vrilissia (59A, Thermopy , Pass. no.M 2550027.

   Authorized signature: _____

6. **MEMBER OF THE BOARD OF DIRECTORS**
   Ms. Irini NIKOLAIDI, Greek citizen, Profession: Legal Counsel, born on 17-11-1968, in Athens and resident in Athens Kolonaki (12 Ravine Str.) , Pass. no.M 699839;

   Authorized signature: _____

ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS (AMC)

PROÇESVERBAL I KËSHILLIT MBIKQYRËS

Më 23 Gusht 2000, me kërkesë të Z. Nikolaos Manasis, i cili përfaqëson një të tretën e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, u mbajt një Mbledhje e këtij të fundit. Rendi i ditës është zgjedhja e Kryetarit dhe Zv. Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës dhe emërimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Ishin të pranishëm dy anëtarë të Këshillit Mbikqyrës:

Z. Nikolaos Manasis *dhe*
Z. Dimitris Scoulicaris

Anëtari i Këshillit Mbikqyrës, i cili përfaqëson punonjësit e AMC-së, nuk është emëruar ende në detyrë prej tyre.

Meqënëse dy nga tre anëtarët e Këshillit të Mbikqyrjes janë të pranishëm, mbledhja konsiderohet e vlefshme. Z. Scoulicaris, duke shprehur keqardhjen e tij në lidhje me faktin se punonjësit e AMC nuk kanë emëruar ende përfaqësuesit e tyre, manifestoi vendosmërinë e tij për të influencuar në zgjidhjen e këtij problemi, propozoi si Kryetar të Këshillit të Mbikqyrjes Z. Manasis. Z. Manasis propozoi që Z. Scoulicaris të emërohet në postin e Zv. Kryetarit. Propozimet u miratuan.

Këshilli i Mbikqyrjes emëron Bordin e Drejtorëve i cili përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

1. Drejtor i Përgjithshëm	Z. Stefanos Octapodas
2. Zv. Drejtor i Përgjithshëm	Z. Genc Hamazaraj
3. Anëtar	Z. Evangelos Martigopoulos
4. Anëtar	Z. Elias Fotiadis
5. Anëtar	Nikolaos Tsolas
6. Anëtar	Irini Nikolaidi

Pas marrjes së vendimit të mësipërm, Z. Manasis deklaroi mbledhjen të mbyllur.

KRYETAR	**ZV. KRYETAR**
Nikolaos Manasis	Dimitris Scoulicaris

Albanian Mobile Communications AMC –Sh.a
Rruga Gjergj Legjisi, Laprakë, Tiranë
Tel: _____ *Fax:* _____

SHTOJCË E PROÇESVERBALIT TË KËSHILLIT MBIKQYRËS MBAJTUR MË 23 GUSHT 2000

ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE

Në përputhje me Nenin 97 të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "*Për Shoqëritë Tregtare*", i ndryshuar, dhe Nenit 19, paragrafi 4 i ligjit nr. 7632 datë 4.11.1992 "*Mbi pjesën e parë të Kodit Tregtar*" personat e mëposhtëm janë emëruar si Drejtorë të Albanian Mobile Communications AMC – Sh.A.

1. **DREJTOR I PËRGJITHSHËM**
   Z. Stefanos OKTAPODAS, qytetar Grek, Profesioni: Kontrollor Finance, lindur më 15.8.1955, në Athinë Greqi dhe banues në Athinë Heraklio Attica, Pas. nr. N 585499;

   Firma e autorizuar: _____

2. **Zv. DREJTOR I PËRGJITHSHËM**
   Z. Genci Hamzaraj, qytetar Shqiptar, Profesioni: Inxhinier, lindur më 28.07.1961, në Vlorë dhe banues në Tiranë, Pas. nr. 1506397;

   Firma e autorizuar: _____

3. **ANËTAR I BORDIT TË DREJTORËVE**
   Z. Evangelos MARTIGOPOUOLOS, qytetar Grek, Profesioni: Menager i Larte, lindur më 11.1.1959, në Attica N. Palatia dhe banues në Athinë N. Psichico (20, K. Palama Str.), Pas. nr. M 388447;

   Firma e autorizuar: _____

4. **ANËTAR I BORDIT TË DREJTORËVE**
   Z.Elias FOTIADIS, qytetar Grek, Profesioni: Menaxher i Lartë, lindur më 13.12.1955, në Ileia Pyrgos dhe banues në Athinë Halandri (11, Paparigopoulou Str.), Pas. nr. N 473723;

   Firma e autorizuar: _____

5. **ANËTAR I BORDIT TË DREJTORËVE**
   Z. Nikolaos TSOLAS, qytetar Grek, Profesioni: Inxhinier, lindur më 11.02.1952, në Serres Chrysos dhe banues në Athinë Vrilissia (59A, Thermopy), Pas. nr. M 2550027;

   Firma e autorizuar: _____

6. **ANËTAR I BORDIT TË DREJTORËVE**
   Z. Irini NIKOLAIDI, qytetar Grek, Profesioni: Këshilltar Ligjor, lindur më 17.11.1968, në Athinë dhe banues në Athinë Kolonaki (12 Ravine Str.), Pas. nr. M 699839;

   Firma e autorizuar: _____

PULLË TAKSE 100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. Rep. 6684
Nr. Kol. .....

VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot më 11.12.2000, përpara meje, noteres, Mimoza Sadushi, me zyrë noterie në Tiranë, u paraqitën personalisht:

- Z. Nikolaos MANASIS, qytetar grek, lindur më 05.07.1944, në Selanik dhe banues në Athinë, Kifissia (43, Petros Str.), Pass. nr. M 545536; dhe
- Z. Dimitris SCOULICARIS, qytetar grek, lindur më 12.06.1938, në Kriti Kritsa I asithiou dhe banues në Athinë (Agathoupoleos Str.), Pass. nr. M 234959;

Në cilësinë e anëtarëve të këshillit mbikqyrës të AMC sh.a., madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurava pasi verifikova dokumentat përkatës të identifikimit të cilët më deklaruan se dokumenti i bashkëngjitur është procesverbali i mbledhjes së këshillit mbikqyrës të shoqërisë datë 23 gusht 2000. Në prani të përkthyeses Enkelejda Muçaj e nënshkruan dokumentin e mësipërm para meje noteres dhe unë vërtetoj nënshkrimin në bazë të ligjit.

NOTERE
Mimoza Sadushi

VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot, më 11.12.2000, deklarova se versioni shqip i dokumentit është një përkthim i saktë i versionit anglisht dhe anasjelltas.

PËRKTHYESE
Enkelejda Muçaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. Rep 6685

VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot më 11.12.2000, përpara meje, noteres, Mimoza Sadushi, me zyrë noterie në Tiranë, u paraqit Enkelejda Muçaj, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, e cila më deklaroi se ka përkthyer dokumentin e mësipërm nga aglishtja në shqip, njëlloj me origjinalin, dhe e nënshkroi atë përpara meje, noteres, dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE
Mimoza Sadushi

PULLË TAKSE 100 LEKE

L I G J

Nr.8660, datë 18.9.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KONTRATËS PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME AMC"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Kontrata për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime AMC", lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe konsorciumit Cosmote/Telenor, i klasifikuar i pari në tenderin për AMC-në.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2749, datë 22.9.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH

Korrik 25,2000

Kjo kontratë lidhet më 25 korrik 2000

midis

Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, Sheshi Skënderbej, e përfaqësuar nga Shkëlqesia e Tij, Ministri Mustafa Muçi (më poshtë referuar si "Shitësi")

dhe

Z. Evangelos Martigopoulos dhe Z. Ivar Sliper (më poshtë "Nënshkruesit"), për dhe në

emër të Cosmoholding - Albania S.A., një shoqëri në formim e sipër sipas të drejtës së Greqisë, (më poshtë "Blerësi), aksionerët e së cilës janë Cosmote Mobile Telecommunications S.A. dhe Telenor International AS.

Meqënëse ekzistojnë këto Kushte Paraprake

a) Albanian Mobile Communications Sh.A. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), është një shoqëri aksionere shtetërore e krijuar rregullisht sipas të drejtës shqiptare me seli në Tiranë, Laprakë, Rruga Gjergj Legjisi, me kapital aksioner 813,822,000 leke të paguar plotësisht;

b) Shitësi është pronar i 813,822 aksioneve të zakonshme, me një vlerë nominale prej 1,000 lekë secili, që përfaqësojnë 100% të tërë kapitalin e emetuar të Shoqërisë;

c) Blerësi është një shoqëri e specializuar në fushën e telekomunikacionit;

d) Në mbështetje të Ligjit Nr. 8515, datë 21.7.1999, "Për privatizimin e shoqërisë aksionere Albanian Mobile Communications (AMC)" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 121/2000 " Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 581, datë 8.12.1999, për kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e shoqërisë aksionere AMC Sh.A.", datë 18.3.2000, Shitësi ka për qëllim t'i shesë Blerësit një numër prej 691,748 aksionesh të zakonshme të Shoqërisë, që përfaqësojnë 85% të kapitalit të saj aksioner;

e) Blerësi ka për qëllim të blejë 691,748 aksione të zakonshme të Shoqërisë, aktualisht të zotëruara nga Shitësi;

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, PALËT BIEN DAKORD si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Përveç termave të tjera të përkufizuara gjetkë në këtë Kontratë, për qëllimet e saj, palët dhe termat që vijojnë do të kenë kudo kuptimin e mëposhtëm:

"Llogari" — do të thotë llogaritë e Shoqërisë për vitin finaciar të mbyllur në Datën e Fundit Kontabël, duke përfshirë raportin zyrtar të ekspertëve kontabël të autorizuar mbi këto llogari, raportin përkatës të drejtorëve dhe shënimet për këto llogari;

"Kontratë" — do të thotë kjo Kontratë për Blerje Aksionesh, duke përfshirë si një pjesë përbërëse të saj, kushtet paraprake të mësipërme, si dhe shtojcat bashkëngjitur të nënshkruara e të shkëmbyera ndërmjet Blerësit dhe Shitësit;

"Mbyllje" — do të thotë blerja dhe shitja e Aksioneve, regjistrimi i

Blerësit si aksioner i ri, miratimi nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, pagesa e pjesës së Çmimit të paguesheme në Datën e Mbylljes dhe, në përgjithësi, nënshkrimi dhe shkëmbimi i gjithë dokumenteve dhe kryerja, përmbushja e gjithë detyrimeve, respektivisht të kërkuara për t'u nënshkruar dhe shkëmbyer, kryer dhe përmbushur në Mbyllje në përputhje me këtë Kontratë me qëllim që të mundësojë Blerësin të bëhet pronar legjitim i 85% të aksioneve të Shoqërisë;

"Data e Mbylljes" do të thotë data në të cilën aktualisht Mbyllja do të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të saj;

"Konsulentët" do të thotë këshilltarët e Shitësit për transaksionin objekt të kësaj Kontrate, të emërtuar Banca d'Intermediazione Mobiliare IMI S.p.A., Bain Cuneo e Associati Inc. dhe Studio Legale Tonucci - Organizatë Profesionale;

"Parapagesë" do të thotë shuma prej US$ 1,606,000 (një milion e gjashtëqind e gjashtëmijë), paguar nga Blerësi në Datën e Mbylljes siç parashikohet në nenin 3, paragrafi 3, numri 1 i Kontratës;

"Barrë" do të thotë çdo hipotekë, detyrim, peng, garanci, kufizim, e drejta e refuzimit të parë, e drejta e parablerjes, e drejtë ose interes e një palë të tretë, barrë ose interesa sigurimi të çdo lloji, ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje preferenciale (duke përfshirë, por pa u kufizuar në transferimin e një titulli ose të një marrëveshje mbajtjeje) që kanë pasoja të ngjashme;

"Forca Madhore" do të thotë çdo urdhër, rregullore, ose direktivë qeveritare, e botuar në formën e ligjit ose jo, ose çdo sanksion me natyrë kombëtare ose ndërkombëtare, kryengritje, trazira, trazira civile, luftë (e deklaruar ose jo), aksione ose kërcënime për aksione grupesh ose individësh terroristë apo guerrilie, greva ose lëvizje të tjera sindikaliste, zjarre, përmbytje, tërmete, ose ndonjë shkak tjetër që nuk është rezultat i fajit ose neglizhencës së Palëve, ose secilës prej tyre, qofshin ose jo të ngjashme me sa më sipër, me kusht që një ngjarje e tillë të jetë jashtë kontrollit të Palës së dëmtuar.

"Data e Fundit Kontabël" do të thotë 31.12.1999;

"Humbje" ose "Humbjet"	do të thotë çdo dëm, kosto, shpenzime të kryera, humbje ose detyrime të cilat janë pasojë direkte dhe/ose indirekte e shkeljes së parashikimeve dhe garancive të specifikuara në nenin 5;
"Materiale" (dhe variantet e saj)	do të thotë, në lidhje me një ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht, se kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht – që veçmas ose së bashku, ka një pasojë e ndikim domethënës ose plotësisht të kundërt (përkeqësues) në gjendjen ekonomike, pasurore, financiare dhe tregtare të Shoqërisë dhe/ose të veprimtarisë së saj në tërësi, në një mënyre të tillë që vendimi për të kryer transaksionin do të ndikohej në të kundërt kurdo që kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht të njihet prej Blerësit, ose që kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht mund të çojë në një Pasojë Materiale Përkeqësuese;
"Pasojë Materiale Përkeqësuese"	do të thotë çdo ndikim në aktivitetin e Shoqërisë që passjell një pagesë ose një Humbje, veçmas ose në tërësi, në një shumë jo më të vogël se 50,000 (pesëdhjetë mijë) dollarë amerikanë;
"Pala" ose "Palët"	do të thotë Blerësi ose Shitësi ose të dy së bashku, siç mund të kërkohet në kontekst;
"Çmimi i Blerjes"	do të thotë çmimi që Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e Aksioneve siç tregohet në nenin 3 dhe në përputhje me mekanizmin e përcaktuar aty;
"Deklarata për Çmimin e Blerjes"	do të thotë deklarata e shkruar, në formën e rënë dakord në Shtojcën A, të nënshkruar nga drejtuesi përkatës i çdo banke të caktuar nga Shitësi – dhe të treguar në tabelën e paraqitur në nenin 3, që vërteton se Çmimi i Blerjes është krediturar në llogaritë e Shitësit ose të personave juridikë të tjerë të caktuar nga Shitësi në ato banka;
"Aksione"	do të thotë një numër prej 691.749 aksione të zakonshme plotësisht të paguara të Shoqërisë me një vlerë nominale prej 1,000 lekë secili, numër i barabartë me 8[illegible]% të aksioneve të emetuara të kapitalit të Shoqërisë. Aksionet përfaqësohen nga çertifikata bashkëngjitur Shtojcës 3.

Titujt në këtë Kontratë nuk kanë ndonjë ndikim në interpretimin e saj.

Neni 2

Qëllimi i kësaj kontrate

Në bazë të kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate, në Datën e Mbylljes Shitësi do t'i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi Aksionet dhe çdo të drejtë që u përket Aksioneve, të lira nga çdo Barrë, për një vlerë të barabartë me shumën e përcaktuar në nenin 3 dhe në mënyrën e parashikuar po aty;

Mbyllja e transaksionit të parashikuar në këtë Kontratë që do të kryhet në Datën e Mbylljes, do të zhvillohet në zyrat e Shitësit në datën për të cilën do të bien dakord së bashku Palët.

Neni 3

Çmimi i blerjes dhe metoda e pagesës

Çmimi i pranuar për çdo Aksion është 123.7445 dollarë amerikanë (njëqind e njëzet e tre dollarë e 0.7445 cent) dhe, kështu, shuma totale e Çmimit të Blerjes për Aksionet është 85,600,000 dollarë amerikanë (tetëdhjetëepesë milionë e gjashtëqind mijë), dhe do të paguhet në përputhje me dispozitat e parashikuara këtu dhe sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.

Të drejtat e dividendëve do të lindin për secilin prej Aksioneve nga Data e Mbylljes.

Shitësi do të paguajë Totalin e Çmimit të Blerjes si më poshtë:

1. Në Datën e Mbylljes, Parapagimi do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë rrjedhëse Nr. 8900405600 e hapur nga Banca d'Intermediazione Mobiliare IMI S.p.A, Swift Code IMITITMM, në Bank of New York, New York Swift Code IRVTUS3N si pjesë e Çmimit total të Blerjes;

2. Në datën e Mbylljes, shuma prej 41,194,000 (dyzet e njëmilion e njëqind e nëntëdhjetë e katërmijë) do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë ekzistuese të Shitësit në Bankën e Shqipërisë në emrin e vet me BIS Bank of International Settlements Basle, Switzeland, nëpërmjet Rezervave Federale, Banka e Nju Jorkut, Swift Code BISACF ABA No. 021085732;

3. Në ditën e njëqintetetëdhjetë pas Datës së Mbylljes, shuma e mbetur prej US$ 42,800,000 dollarë ameriakne (dyzetedy milion e tetëqind mijë) do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë ekzistuese të Shitësit në Bankën e Shqipërisë në emrin e vet me BIS Bank of International Settlements Basle, Switzeland, nëpërmjet Rezervave Federale, Banka e Nju Jorkut, Swift Code BISACF ABA No. 021085732.

Nëpërmjet kësaj Kontrate, Blerësi është shprehimisht i autorizuar nga Shitësi t'i paguajë Parapagimin drejtpërdrejt Këshilltarëve, në llogarinë bankare të përmendur më sipër, si Shpërblim për Suksesin për shërbimet këshillimore të Konsulentëve në shitjen e Aksioneve, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 12.8.1999.

Në Datën e Mbylljes, Blerësi merr përsipër t'i paraqesë Shitësit një garanci bankare për përmbushjen e detyrimeve, të lëshuar në favor të Shitësit për shumën e barabartë me shumën e mbetur për t'u paguar sipas paragrafit 3, pika 3, këtu sipër, në formën e përshkruar në Shtojcën C.

Neni 4

Mbyllja

Në mbyllje:

a) Shitësi do të:

1. Dorëzojë çertifikatën që përfaqëson Aksionet e regjistruara rregullisht në favor të Blerësit në përputhje me legjislacionin shqiptar;

2. Të nënshkruajë dhe dorëzojë, dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumenteve të tjerë të nevojshëm sipas legjislacionit shqiptar, për t'i dhënë Blerësit një titull të mirë dhe të tregtueshëm mbi Aksionet ose për të realizuar në mënyrën e duhur qëllimin e kësaj Kontrate;

3. Të bëjë të mundur dorëheqjen e të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë, duke filluar nga Data e Mbylljes;

4. T'i kthejë Blerësit Garancinë Bankare për Tenderin që i është dorëzuar së bashku me ofertën detyruese.

dhe

b) Blerësi do:

1. T'i dorëzojë Shitësit Mandat Pagesat e Çmimit të Blerjes në shumat e caktuar në nenin 3, paragrafi 3, pikat 1 dhe 2;

2. T'i dorëzojë Shitësit aktet e themelimit dhe dokumentet që vërtetojnë kompetencat e përfaqësuesit të tij, si dhe të gjitha dokumentet e instrumentet e tjera në lidhje me shitjen e blerjen e Aksioneve të parashikuara në këtë Kontratë që mund të jenë të nevojshme për të realizuar qëllimin e saj.

3. T'i paraqesë Shitësit garancinë bankare për plotësimin e detyrimeve në përputhje me nenin 3, paragrafi 5.

Në mbyllje, Blerësi do të fitojë titullin mbi Aksionet në Datën e Mbylljes dhe do të përfitojë çdo dividend të deklaruar ose të paguar, si dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me to, duke filluar nga Data e Mbylljes.

Shitësi do të bëjë të mundur që në Datën e Mbylljes, ose në çdo datë tjetër pas Mbylljes të vendosur nga Blerësi, thirrjen e mbledhjes së aksionerëve të Shoqërisë, rendi i ditës i së cilës do të përcaktohet në marrëveshje me Blerësin dhe do të përfshijë - ndër të tjera - emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në vend të atyre që do të kenë dhënë dorëheqjen; Blerësi do të ketë të drejtën të përcaktojë emrat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që do të emërohen pa cenuar kufizimet, në qoftë se ka të tilla, të parashikuara në ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", dhe në amendamentet e tij të mëvonshme, si dhe në dispozitat e tjera shqiptare statutore të aplikueshme.

Neni 5

Deklarimet dhe garancitë e Shitësit

Shitësi me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton në lidhje me Shoqërinë, si dhe me transaksionin të parashikuar prej kësaj Kontrate, të gjitha çështjet që vijojnë deri në datën e nënshkrimit të saj. Shitësi gjithashtu garanton se çdo garanci dhe deklarim do të jetë i vërtetë, i

saktë dhe joçorientues, sikur të ishte bërë në Datën e Mbylljes.

5.1 Organizimi

Shoqëria është themeluar në mënyrën e duhur dhe ekziston rregullisht sipas ligjeve shqiptare, nuk është në pamundësi pagese, dhe është plotësisht e aftë, me të drejta dhe autoritet të plotë, të zhvillojë e kryejë aktivitetin e saj siç e kryen aktualisht dhe të zotërojë asetet dhe pronat e saj siç i zotëron aktualisht. Shoqëria zhvillon aktivitet sipas një liçencë të vlefshme, siç tregohet në Shtojcën E, dhe nuk ka shkelur asnjë prej afateve të kësaj Liçence.

5.2 Autorizimi

Të gjitha aktet legjislative dhe/ose procedurat e tjera të kërkuara prej legjislaconit shqiptar për t'u marrë nga Shitësi ose në emër të tij, për ta autorizuar atë të lidhë dhe zbatojë këtë Kontratë, janë ndërmarrë rregullisht dhe në mënyrën e duhur, kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga Shitësi në mënyrën e duhur dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe të detyrueshëm ndaj tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

Nënshkrimi i kësaj Kontrate nuk kërkon ndonjë njoftim të mëtejshëm ose depozitim, aprovim, autorizim, ose ndonjë instrument tjetër, nga ndonjë autoritet publik ndërkombëtar ose kombëtar ose nga ndonjë autoritet tjetër qeveritar ose rregullator.

5.3 Mungesa e Konflikteve

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate, realizimi i transaksionit të parashikuar nga kjo Kontratë dhe plotësimi i kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj Kontrate nga Shitësi nuk bie në konflikt, ose nuk rezulton të përbëjë ndonjë shkelje ose mospërmbushje, ose të krijojë ndonjë të drejtë për prishjen a përfundimin, anullimin ose përshpejtimin e ndonjë detyrimi ose humbjeje të ndonjë përfitimi material, ose nuk krijon ndonjë barrë mbi ndonjë biznes, aset ose pronë a pasuri të Shitësit, me ose sipas ndonjë dispozite, vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të zbatueshme për Shitësin.

5.4 Pronësia

Shitësi është pronari dhe përfituesi i vetëm ligjor i Aksioneve në numrin e përcaktuar në nenet 1 dhe 2.

Aksionet janë të përcaktuara dhe të emetuara sipas rregullave dhe janë plotësisht të pagueshme.

Aksionet janë të lira dhe të çliruara nga çdo Barrë e çfarëdo lloji dhe Shitësi do të ketë të drejtë, kompetencë dhe autoritet të plotë për t'i shitur, për t'i kaluar pronësinë e tyre të tretëve, transferuar dhe dorëzuar Aksionet në përputhje me afatet e kësaj Kontrate.

Nuk ekziston asnjë kontratë a marrëveshje, rregullim ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë Barrë në lidhje me Aksionet ose ndonjë numër aksionesh të autorizuara por të pa-emetuara në kapitalin e Shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon të ketë të drejtën e ndonjë Barre në lidhje me ndonjë nga Aksionet.

Përveç kësaj Kontrate, nuk ekziston asnjë kontratë a marrëveshje, rregullim ose detyrim që kërkon krijimin, akordimin, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin, ose dhënien një personi të së drejtës (të kushtëzuar ose jo) të kërkojë akordimin, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e ndonjë aksioni në kapitalin e Shoqërisë (duke përfshirë, pa kufizim, një mundësi ose të drejtë parablerjeje ose kthimi).

5.5 Filialet

Shoqëria nuk ka ndonjë filial.

5.6 Llogaritë financiare

Llogaritë financiare janë përgatitur mbi baza të rregullta e të qëndrueshme në përputhje

me të drejtën shqiptare dhe me standardet, parimet dhe praktikat e zbatuara ndërkombëtare, dhe në mënyrë të veçantë parimet e kontabilitetit të Komitetit Ndërkombëtar të Standardeve Kontabël (KNSK).

Asnjë ndryshim nuk është bërë në politikat kontabël në përgatitjen e Llogarive të Shoqërisë për secilin nga dy vitet financiare të përfunduara në Datën e Fundit Kontabël, përveç atyre të deklaruara në bilancet dhe llogaritë e fitimeve dhe të humbjeve për këto vite.

Llogaritë paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të aseteve, detyrimeve dhe të gjendjes së aktiviteteve të Shoqërisë siç është në Datën e Fundit Kontabël, si dhe të fitimeve dhe të humbjeve të Shoqërisë për vitin finaciar të përfunduar në Datën e Fundit Kontabël.

Nuk ekzistojnë detyrime, pagesa, borxhe dhe, në përgjithësi, rreziqe materiale të Shoqërisë, të cilat nuk janë deklaruar rregullisht dhe në mënyrën e duhur në Llogaritë ose për të cilat të mos jenë akorduar fonde ose rezerva të arsyeshme.

5.7 Regjistrat Kontabël dhe Libra të tjerë të Shoqërisë

Regjistrat kontabël dhe librat e Shoqërisë, në zotërim ose nën kontrollin e saj janë të azhornuara, të mbajtur në mënyrën e duhur dhe të gjitha regjistrimet në regjistrat dhe librat kontabël janë mbajtur në përputhje të plotë me të drejtën shqiptare dhe me standardet, parimet dhe praktikat e zbatuara ndërkombëtare.

5.8 Mungesa e ndryshimeve materiale

Biznesi i Shoqërisë është zhvilluar në mënyrë normale, duke e konsideruar atë si një preokupim të vazhdueshëm; dhe asnjë ndryshim thelbësor nuk ka ndodhur në aktivin dhe pasivin e treguar në Llogaritë dhe nuk ka asnjë ulje të vlerës reale neto të aktivit të Shoqërisë në bazë të vlerësimeve të bëra dhe të përllogaritura në Llogaritë.

Që nga Data e Fundit Kontabël. Shoqëria është drejtuar dhe ka operuar në mënyrën e duhur dhe Shitësi nuk ka dijeni se vetë Shitësi dhe/ose Shoqëria ka:

- Hyrë në ndonjë marrëveshje, vlera e të cilave kalon US$ 10,000, me përjashtim të atyre të raportuar në Shtojcën E, ose
- Marrë përsipër ndonjë detyrim ose përgjegjësi materiale, ose
- Kryer ndonjë veprim tjetër që mund të shkaktojë që ndonjë nga deklaratat ose garancitë e Shitësit që përmbahen në këtë Kontratë, të bëhen të pavërteta ose të parregullta.

Që prej 15.7.2000 Shoqëria nuk ka:

a) pësuar asnjë ndryshim material dhe përkeqësues në asetet, pronat ose në aktivitetet e saj të biznesit;

b) pësuar asnjë ngjarje ose rrethanë materiale në lidhje me asetet, biznesin ose pronat e saj, që rrezikon materialisht të pengojë, ndalojë, dëmtojë ose të cenojë në ndonjë mënyrë tjetër materiale dhe përkeqësuese rezultatet e veprimtarisë së saj në tërësi;

c) hyrë në asnjë transaksion ose kontratë, ose nuk ka ndryshuar ose përfunduar asnjë transaksion ose kontratë që në mënyrë të arsyeshme mund të sillte një pasojë materiale dhe përkeqësuese për asetet, pronat dhe aktivitetet e biznesit të saj;

d) shitur, transferuar, vënë peng, dhënë me qira ose disponuar në ndonjë mënyrë tjetër asetet ose pronat që ajo zotëron;

e) punësuar personel ose nuk e ka rritur shkallën e kompensimit të pagueshëm ose që do të bëhet i tillë ndaj punonjësve, përveç rritjes të bërë sipas praktikave të mëparshme në përputhje me çdo shpërblim ekzistues ose me plane të tjera, ose nuk ka ndryshuar organizimin e punës së saj në asnjë mënyrë materiale;

f) fituar asnjë pasuri të palujtshme ose nuk ka bërë as edhe një shpenzim kapitali

(prekshëm ose të paprekshëm) që kalon shumën US$ 10,000 ;

g) fituar ose poseduar, në çfarëdo lloj forme, interesa në kapitalin e shoqërive të tjera ose nuk ka fituar, poseduar ose hyrë në marrëdhënie qiraje (si qiramarrës ose qiradhënës) për ndonjë biznes ose pjesë biznesi;

h) deklaruar ose paguar asnjë dividend me përjashtim të shumës 100,000 lek që është pjesë e dividentit të 1999, ose nuk ka blerë ose fituar në ndonjë mënyrë tjetër interesa në pasurinë e saj (equity);

i) rënë dakord për të bërë ndonjë nga të mësipërmet.

Shitësi garanton se pas Ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, Shoqëria nuk do të bëjë asnjë shpenzim ose nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim pa miratimin paraprak nga ana e Përfaqësuesit të Blerësit.

5.9. Taksa dhe Konfliktet

Shoqëria ka depozituar, në kohën e duhur, të gjitha deklaratat për taksat periodike dhe vjetore që parashikohen në ligjet për taksat që zbatohen për Shoqërinë. Këto deklarata tatimore janë përgatitur rregullisht dhe në mënyrën e duhur dhe të gjitha taksat dhe detyrimet direkte ose indirekte të pagueshme, janë paguar plotësisht dhe në kohë. Për sa më sipër është lëshuar nga Autoritetet tatimore shqiptare një vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore ashtu siç tregohet në Shtojcën F.

Nuk ekziston asnjë konflikt në proces ose potenciali, me përjashtim të atyre të treguara në Shtojcën G.

Në lidhje me çështjen gjyqësore në proces kundër autoriteteve tatimore shqiptare për llogaritjen e gabuar të humbjeve nga konvertimi i valutës së huaj për vitin 1997 (shiko Shtojcën G), në rast se Shoqëria do të ndëshkohet, me vendim të formës së prerë, për të paguar shumën e kërkuar nga autoritetet tatimore ose ndonjë shumë tjetër që vendoset nga gjykata, Shitësi do ta lirojë Blerësin nga pagimi i një shume të tillë të përcaktuar në vendimin e mësipërm.

5.10. Asetet e Prekshme

Shoqëria ka titull pronësie të plotë, të mirë dhe të tregtueshëm mbi të gjitha asetet dhe pronat e saj, të renditura në Shtojcat H, I, dhe J (duke përfshirë pronat individuale dhe të paluajtshme) që ose janë pasqyruar në Llogaritë e Datës së Fundit Kontabël ose që janë fituar pas kësaj Date, dhe ky titull nuk është objekt i ndonjë kufizimi, hipoteke, pengu, barre, detyrim ose të drejtë të çfarëdo lloji në përfitim të të tretëve.

5.11 Asetet e Paprekshme

Shoqëria është pronarja e vetme dhe ekskluzive e markave tregtare, patentave, e emrave tregtarë, know-how-ve dhe të çdo të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale të saj të nevojshme për zhvillimin e biznesit të saj siç tregohet në Shtojcën K, si dhe ka të drejtë t'i përdorë këto, dhe nuk ka cënuar asnjë markë tregtare, patentat, emër tregtar, dhe know - how, dhe asnjë të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale.

Shoqëria është liçencuar në mënyrën e duhur për përdorimin e softuerëve të saj.

Këto asete të paprekshme janë plotësisht të përdorshme nga ana e Shoqërisë pa qenë nevoja për pagimin e ndonjë licence, tarife ose të ndonjë detyrimi tjetër të ngjashëm.

5.12 Marrëveshjet

Shoqëria nuk është palë në ndonjë marrëveshje me shkrim që nuk është përmbushë plotësisht, me përjashtim të atyre të deklaruara dhe të evidentuara nga Shitësi sipas dokumentacionit të bashkëngjitur kësaj Kontrate siç përcaktohet në Shtojcën L.

5.13. Punonjësit

Shoqëria nuk është dhe nuk ka qenë kurrë palë e ndonjë kontrate punësimi ose në ndonjë kontratë tjetër angazhimi me ndonjë palë të tretë. Shoqëria nuk është palë në ndonjë kontratë shitjeje, agjencie, komisioni ose konsulence.

Të gjithë Punonjësit janë të regjistruar rregullisht në librat dhe regjistrat përkatës së bashku me shpërblimet totale që i paguhen secilit prej tyre, në përputhje me ligjet dhe rregullat e zbatueshme. Lista e punojësve të Shoqërisë dhe pagat e tyre janë paraqitur në Shtojcën N.

Shoqëria ka bërë të gjitha depozitimet dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet që kërkohen për t'u bërë ose për t'u ndërmarrë sipas ligjeve e rregullave të zbatueshme për sigurimet shoqërore, për punën dhe mirëqënien në lidhje me secilin nga Punonjësit. Të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe mirëqënies në bazë të ligjeve dhe rregullave, si dhe të kontratës kolektive, nëse ka të tillë, janë paguar plotësisht.

Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, të bordit të drejtorëve ose çdo ekspert kontabël i Shoqërisë dhe çdo punonjës ka marrë vitin e fundit financiar vetëm shumat e paraqitura në Llogaritë dhe asnjë nga ata nuk ka të drejtë të marrë ndonjë shumë tjetër përveç atyre të treguara në këto Llogari.

5.14. Pajtueshmëria me ligjin

Shoqëria e ka drejtuar biznesin e saj në të gjitha aspektet materiale në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat përkatëse shqiptare. Deri në Datën e Mbylljes, Shoqëria nuk ka shkelur asnjë statut, ligj, rregull, rregullore, urdhër, dekret, direktivë, leje ose kërkesë të ngjashme të zbatueshme ndaj aseteve dhe pronave (qofshin këto të luajtshme ose të paluajtshme, të prekshme ose të paprekshme të zotëruara, të liçencuara, të disponuara me qira ose ndryshe) ose ndaj kontratës dhe të drejtat të parashikuara prej saj, të cilat mund të kenë një Pasojë Materiale Përkeqësuese mbi aktivitetin e saj.

Shoqëria zotëron në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme, pa i shkelur ato, të gjitha ejet materiale, liçencat dhe miratimet ose autorizimet e tjera që kërkohen nga statutet, ligjet, rregullat, rregulloret, urdhrat, dekretet ose direktivat e zbatueshme, në lidhje me pronësinë, përdorimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e biznesit të saj ose të çdo aseti dhe prone të saj ose të çdo kontrate dhe të drejte me të cilat Shoqëria është e lidhur.

5.15 Garancitë, Detyrimet dhe Dëmshpërblimet

Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë kapital hua, as të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes me përjashtim të atyre të treguara në Shtojcën N.

Shoqëria nuk është palë dhe nuk është përgjegjëse në bazë të ndonjë marrëveshjeje garancie, dëmshpërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një palë të tretë.

5.16 Mbyllja e Shoqërisë, vënia në administrim dhe pamundësia e pagesës

Asnjë urdhër nuk është nxjerrë, asnjë ankesë nuk është paraqitur, ose asnjë vendim nuk është marrë për mbylljen e Shoqërisë ose për emërimin e ndonjë likuidatori të përkohshëm për Shoqërinë, si dhe asnjë urdhër nuk është nxjerrë për vënien në administrim të Shoqërisë; dhe Shoqëria nuk është e insolvente ose e paaftë të paguajë borxhet e saj.

5.17 Pullat e taksës, taksat dhe detyrimet e tjera

Nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pullat, taksa ose detyrime të tjera në lidhje me këtë Kontratë dhe me transferimin e aksionevë në emër të Blerësit.

5.18 Shtojcat

Shtojcat e mëposhtme që i janë bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohen si pjesë përbërëse e saj:

Shtojca A: Deklarata e Çmimit të Blerjes;

Shtojca B: Certifikata e Aksioneve;

Shtojca C: Garanci Bankare;

Shtojca D: Liçenca e Shoqërisë;

Shtojca E: Marrëveshjet e nënshkruara nga Shoqëria;

Shtojca F: Raporti mbi çështjet tatimore;

Shtojca G: Raporti në lidhje me çështjen në proces;

Shtojca H: Lista e pasurive të paluajtshme të Shoqërisë;

Shtojca I: Lista e stacioneve ekzistuese bazë të Shoqërisë;

Shtojca J: Lista e pajisjeve dhe aseteve të Shoqërisë (invetari);

Shtojca K: Lista e licencave për markat tregtare, patentat dhe softuer-ët e Shoqërisë;

Shtojca L: Lista e kontratave të qirasë të nënshkruara nga Shoqëria për Pasuritë e paluajtshme;

Shtojca M: Lista e punonjësve të Shoqërisë dhe pagat e tyre;

Shtojca N: Kontratat e huasë të nënshkruara nga Shoqëria;

Shtojca O: Plani i Biznesit i Blerësit.

Për të shmangur çdo dyshim, Shitësi garanton dhe deklaron se përmbajtja e shtojcave të mësipërme është e vërtetë dhe e saktë dhe do të jetë e tillë në Datën e Mbylljes.

Neni 6

Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

Blerësi i bën deklarimet dhe i jep garancitë e mëposhtme Shitësit. Secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë në Datën e Mbylljes.

6.1 Organizimi

Blerësi është një shoqëri e themeluar, e organizuar dhe që ekziston rregullisht sipas të drejtës greke, me aftësi paguese, me kompetencë dhe autoritet të plotë të kryejë aktivitetin e saj, siç e kryen aktualisht, dhe të zotërojë asetet dhe pronat e saj, siç i zotëron aktualisht.

6.2 Autorizimi

Të gjitha aktet e Shoqërisë dhe/ose procedurat e tjera që kërkohet të ndërmerren nga ose për t'u marrë nga ose në emër të Blerësit, për ta autorizuar atë të lidhë dhe zbatojë këtë Kontratë, janë ndërmarrë rregullisht dhe në mënyrën e duhur, kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga Blerësi në mënyrën e duhur dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe të detyrueshëm ndaj tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

Nënshkrimi i kësaj Kontrate nuk kërkon ndonjë njoftim të mëtejshëm ose depozitimin, aprovimin, autorizimin, ose çfarëdo instrumenti tjetër, nga ndonjë autoritet publik ndërkombëtar ose kombëtar ose nga ndonjë autoritet tjetër qeveritar ose rregullator të vendit të Blerësit.

6.3 Mungesa e Komisionerëve

Blerësi nuk ka detyrime për të paguar ndonjë komision, tarifë ndërmjetësimi ose pagesa

të ngjashme ose komisione në lidhje me transaksionin e parashikuar në këtë Kontratë, pagimi i të cilave të mund të kërkohej në mënyrë të vlefshme nga Shoqëria ose Shitësi.

6.4 Mungesa e Konflikteve

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate, realizimi i transaksioneve të parashikuara nga kjo Kontratë dhe plotësim i kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj Kontrate nga Shitësi nuk bie në konflikt, ose nuk rezulton të përbëjë ndonjë shkelje ose mospërmbushje, ose të krijojë ndonjë të drejtë për prishjen a përfundimin, anullimin ose përshpejtimin të ndonjë detyrimi ose humbje të ndonjë përfitimi material, ose nuk krijon ndonjë barrë mbi ndonjë biznes, asetet ose pronë a pasuri të Shitësit, me ose sipas ndonjë dispozite të (i) statutit të Blerësit ose të dokumenteve të tjera të themelimit, ose (ii) të ndonjë kambiali, bonoje, hipoteke, porosi, deed of trust[1], licencë, qira, kontratë ose marrëveshje, në të cilat Blerësi është palë, ose (iii) të ndonjë vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të zbatueshme për Blerësin ose mbi biznesin, asetet ose pronat e Blerësit.

Nënshkrimi i kësaj Kontrate nuk përbën shkelje të ndonjë ligji ose dhe të vetë akteve të Shoqërisë të Blerësit që mund të ndikojë në vlefshmërinë ose në forcën detyruese të kësaj Kontrate.

Neni 7

Detyrime të tjera të Blerësit

7.1 Mbajtja e selisë në Shqipëri

Blerësi do të mbajë selinë e Shoqërisë në Republikën e Shqipërisë.

7.2 Investimet dhe plani i biznesit

Blerësi do të zhvillojë, me përpjekjet e tij me të mira, aktivitetet e telefonisë së lëvizshme të Shoqërisë me qëllim që ta bëjë këtë biznes më konkurues dhe efektiv në treg në përputhje me planin e tij të Biznesit, siç përshkruhet në Shtojcën O.

Në mënyrë të veçantë, Blerësi do të zbatojë brenda periudhës së parashikuar të paktën 60% (gjashtëdhjetë) të shumës së investimeve të përshkruar në planin e biznesit.

Në rast se pas tre vjetësh nga nënshkrimi i kësaj Kontrate, Blerësi nuk do të ketë plotësuar detyrimet e mësipërme, në lidhje me investimet e parashikuara deri në vitin e tretë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit shumën prej US$ 1,500,00 (një milion e pesëqind mijë dollarë), me përjashtim të rastit kur mosplotësimi i tyre nuk varet prej Blerësit për çfarëdolloj arsye.

Neni 8

Kushtet e mbylljes

Detyrimi i Blerësit për të blerë Aksionet dhe detyrimi i Shitësit për t'ia shitur ato Blerësit Aksionet janë objekt i plotësimit ose i heqjes dorë, në ose përpara Datës së Mbylljes, të kushteve të mëposhtme:

---

[1] Institut i së drejtës angleze, shumë i ngjashëm me lënien në hipotekë, sipas të cilit titulli i ligjshëm mbi një pasuri të paluajtshme i kalon një ose më shumë dorëzanësve, për të siguruar pagimin e një shume parash ose plotësimin e detyrimeve të tjera.

8.1 Autorizimet

Të gjitha autorizimet, pëlqimet, urdhrat ose miratimet, ose deklaratat, ose depozitimet, ose skadimi i afateve të periudhave pritëse, të vendosura nga ndonjë entitet ose autoritet qeveritar, të nevojshme për realizimin e shitjes dhe të blerjes do të jenë marrë, depozituar ose të jenë lëshuar, ose sipas rastit, Autoriteti kompentent do të ketë hequr dorë prej tyre. Në mënyrë të veçantë, me kërkesën e Shitësit, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë do të marrë vendimin për ta paraqitur këtë Kontratë për ratifikim në Kuvend, ratifikim i cili do të bëhet përpara pagimit të shumës së parashikuar në nenin 3, paragrafi 3, numri 3.

8.2 Mungesa e vendimeve ose kufizimeve

Asnjë ligj i zbatueshëm ose vendim i miratuar, i hyrë në fuqi, i shpallur ose i detyrueshëm ose i nxjerrë nga ndonjë entitet qeveritar, as edhe ndonjë kufizim a ndalim tjetër ligjor, që pengon ose ndalon kryerjen e blerjes dhe shitjes së Aksioneve, nuk do të ketë fuqi juridike.

8.3 Kushtet për Detyrimet e Blerësit

Detyrimi i Blerësit për të blerë Aksionet dhe për të bërë pagesat për to në Mbyllje është objekt të plotësimit ose të heqjes dorë nga Blerësi, në ose përpara Datës së Mbylljes së kushteve të mëposhtme:

(a) Deklarimet dhe Garancitë.

Deklarimet dhe garancitë e Shitësit të bëra në këtë Kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale, në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, si dhe në momentin përkatës të Mbylljes, sikur të jenë bërë në atë kohë, përveç rastit kur vlefshmëria e këtyre deklaratave dhe garancive ka shprehimisht një datë më të hershme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale, në këtë datë më të hershme), përveç rasteve që, veç e veç ose në tërësi, nuk ka të ngjarë që në mënyrë të arsyeshme të sjellin një Pasojë Materiale Përkeqësuese.

(b) Plotësimi i Detyrimeve të Shitësit

Shitësi do të ketë kryer ose përmbushur në të gjitha aspektet materiale të gjitha detyrimet dhe marrëveshjet e kërkuara nga kjo Kontratë për t'u kryer ose përmbushur nga ana e Shitësit në kohën e Mbylljes, përveç rasteve që, veç e veç ose në tërësi, nuk ka të ngjarë që në mënyrë të arsyeshme të sjellin një Pasojë Materiale Përkeqësuese.

(c) Mungesa e Proceseve

Në kohën e Mbylljes nuk do të ketë procese të filluara e të papërfunduara: (i) që kundërshtojnë, kufizojnë ose ndalojnë shitjen dhe blerjen e Aksioneve prej Blerësit, (ii) që ndalojnë ose kufizojnë pronësinë ose menaxhimin prej Shoqërisë të ndonjë pjese materiale të biznesit ose të aseteve të Shoqërisë, (iii) që kërkojnë vendosjen e kufizimeve në aftësinë e Blerësit për të fituar, mbajtur ose ushtruar të drejtat e plota të pronësisë mbi Aksionet, (iv) që kërkojnë të ndalojnë Blerësin të kontrollojë efektivisht ndonjë pjesë materiale të Shoqërisë; me kusht që nga ky kusht të jetë hequr dorë nga Blerësi për ndonjë padi, ankim ose procedim (me përjashtim të ndonjë padie, ankimi ose procedimi nga ndonjë entitet qeveritar) dhe në qoftë se Shitësi do t'i sigurojë Blerësit dëmshpërblim të kënaqshëm në mënyrë të arsyeshme për Blerësin, në formë e përmbajtje, për këto padi, ankime ose procedime.

8.4. Kushte për Detyrimet e Shitësit

Detyrimi e Shitësit për të shitur, transferuar dhe dorëzuar Aksionet është objekt i

mëposhtme:

(a) Deklarimet dhe Garancitë

Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit të bëra në këtë Kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe në kohën e Mbylljes sikur të ishin bërë në këtë kohë, përveç rastit kur këto deklarata dhe garanci i referohen shprehimisht një datë më të hershme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektat materiale, në këtë datë më të hershme).

(b) Plotësimi i Detyrimeve të Blerësit.

Blerësi do të ketë kryer ose përmbushur në të gjitha aspektet materiale të gjitha detyrimet dhe marrëveshjet e kërkuara nga kjo Kontratë për t'u kryer ose përmbushur në kohën e Mbylljes.

(c) Mungesa e Procedimeve

Nuk do të ketë procedime të filluara ose të papërfunduara nga ndonjë entitet qeveritar (ose procedime nga ndonjë person tjetër me mundësi të arsyeshme për të patur sukses), që kundërshtojnë ose kërkojnë kufizimin ose ndalimin e shitjes dhe blerjes së Aksioneve, ose që kërkojnë të përfitojnë nga Shitësi në lidhje me blerjen dhe shitjen e Aksioneve të ndonjë dëmi që është material në lidhje me Shitësin; me kusht që nga një detyrim tillë të jetë hequr do të nga Shitësi në lidhje me ndonjë padi, ankesë ose procedim (me përjashtim të ndonjë padie, ankimi ose procedimi nga një entitet qeveritar) dhe në qoftë se Blerësi i siguron Shitësit dëmshpërblim të kënaqshëm në mënyrë të arsyeshëm për Shitësin, në formë dhe përmbajtje, në lidhje me këto padi, ankime ose procedime.

Neni 9

Dëmshpërblimi nga Shitësi

9.1 Detyrimet e Shitësit

Shitësi bie dakord të mos dëmtojë ose të kompensojë Blerësin ose Shoqërinë, sipas rastit, sipas kushteve dhe brenda kufijve, të rëna dakord më poshtë, nga çdo humbje që rrjedh nga ose që varet nga fakte ose rrethana të ndodhura përpara Datës së Mbylljes edhe nëse humbja shfaqet pas kësaj date.

Çdo dëmshpërblim për t'u paguar nga ana e Shitësit sipas kësaj Kontrate do të bëhet i pagueshëm vetëm kur Humbja përkatëse, siç vendoset nga një Gjykatë ose autoritet tjetër kompetent, është bërë e pagueshme.

Për qartësi, asnjë shkelje ose shkelje e pretenduar e ndonjë deklarate ose garancie nuk i jep të drejtë Blerësit të dëmshpërblehet, në rast se nga kjo shkelje nuk ka rezultuar ndonjë Humbje për Shoqërinë, siç vendoset me vendim të Gjykatës ose të ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

9.2 Ekskluziviteti dhe ndalimi i dublimit të mjeteve mbrojtëse

Është rënë dakord që e drejta për të marrë dëmshpërblim sipas kësaj dispozite, përjashton dhe nuk do të dublohet nga ndonjë e drejtë, mjet mbrojtës, pretendim ose mënyra të tjera mbrojtjeje të mundshme për Blerësin në lidhje me shkeljen nga ana e Shitësit të deklarimeve dhe garancive të specifikuara në nenin 5.

9.3 Përjashtimet dhe kufizimet

Detyrimi për dëmshpërblim i Shitësit sipas kësaj kontrate do të hyjë në fuqi vetëm ku shuma totale e Humbjeve, objekt i kërkesës për dëmshpërblim nga ana e Blerësit në tërësi e kalon shumën US$ 1,000,000 (një milion), me kusht që nëse ky limit kalohet, Shitësi do të jetë përgjegjës ose i detyruar të paguajë vetëm shumën mbi kufi.

Në asnjë rast shuma totale që duhet të paguhet nga Shitësi si dëmshpërblim në bazë t ketij neni nuk do të kalojë 50 (pesëdhjetë) % të Çmimit të Blerjes.

Shumës që duhet të paguhet nga Shitësi, sipas kësaj dispozite, në lidhje me një kërkes për dëmshpërblim, do t'i zbritet:

(i) çdo shumë që Shoqëria ka marrë në bazë të çdo politike sigurimi që është në fuqi n datën e kësaj Kontrate ose nga çdo palë e tretë në lidhje me çështjen specifike që është objekt kërkesës për dëmshpërblim ndaj Shoqërisë;

(ii) çdo përfitim nga taksat në favor të Blerësit ose të Shoqërise si rezultat i ngjarjes q solli pagimin e dëmshpërblimit.

Shitësi do të ketë të drejtën e kompesimit, ndaj çdo Humbjeje e cila është objekt i nj pretendimi nga ana e Blerësit, të shumës të çdo aseti apo kredie të rastësishëm, që rrjedh os varet nga rrethanat ose veprimet e ndodhura ose të ndërmarra përpara Datës së Fundit Kontabë dhe që nuk janë pasqyruar në Llogaritë.

Në asnjë rast Shitësi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit në lidhje me ndonjë shkelj të pretenduar të deklaratave dhe garancive, njoftimi i të cilave i është dhënë Shitësit pas 2 muajve nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

9.4 E drejta e Shitësit në lidhje me Humbjet

Blerësi bie dakord të njoftojë Shitësin për çdo fakt që mund t'i shkaktojë Shoqërisë nj humbje për t'u dëmshpërblyer, për të cilën Shitësi mund të konsiderohet përgjegjës menjëher pas marrjes dijeni, dhe në çdo rast brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes dijeni, me kusht q në rast se afati i fundit për të depozituar një ankesë ose kundërshtim në lidhje me këtë Humbj është më pak se 30 (tridhjetë) ditë, njoftimi duhet do t'i jepet Shitësit sipas kësaj Kontrate ng Blerësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data që ai ka marrë dijeni për këtë me njoftin me shkrim, ku të tregohen pretendimet që ai synon të bëjë në mënyrë të detajuar dhe t arsyeshme, së bashku me gjithë dokumentecionin që disponon, i cili mund të jetë i nevojshën për të mundësuar Shitësin për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje m Humbjen që është objekt i kësaj kërkese. Për qëllimin e kësaj dispozite, dijenia e Shoqërisë d të konsiderohet të jetë edhe dijenia e Blerësit.

Shitësi ka të drejtë të bëjë menaxhimin e rrethanave, të cilat janë shkak për ngritjen pretendimeve nga ana e Blerësit dhe Blerësi bie dakord të sigurojë, në bazë të kërkesës s Shitësit, se Shoqëria do të:

(i) mbajë Shitësin të informuar rregullisht dhe menjëherë për çdo njoftim, komunikin ose informacion tjetër në çdo mënyrë të marrë nga Shoqëria në lidhje me një pretendim të tillë,

(ii) bashkëpunojë me Shitësin në lidhje me zhdëmtimet dhe veprimet përkatëse, duke dhënë Shitësit mundësi të plota për të parë të gjitha shënimet, dokumentet, dosjet dhe të dhëna e lidhura me to, si dhe duke i siguruar mbështetjen e nevojshme nga punonjësit e saj,

(iii) të respektojë çdo udhëzim të Shitësit në realizimin e procedimeve ligjore dhe/os negociatave zgjidhëse dhe/ose iniciativave të tjera në lidhje me të.

Në qoftë se Shitësi nuk arrin të japë instruksionet menjëherë pas marrjes së njoftimi përkatës nga Blerësi, Blerësi pa shkelur sa me sipër, merr të gjitha hapat e arsyeshme, të cila mund të kërkohen për të zvogëluar shumën, për të cilën kërkohet dëmshpërblimi, si dh

mundëson Shoqërinë të ndërmarrë të gjitha këto hapa të arsyeshme; si dhe do ta njoftojë Shitësin plotësisht dhe menjëherë për këto iniciativa dhe hapa.

Marrja nga Blerësi ose Shoqëria e ndonjë iniciative në lidhje me këto pretendime pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të Shitësit ose mospërmbushja nga ana e Shoqërisë e dispozitave të mësipërme të këtij neni, bën që Shitësi të shkarkohet nga detyrimi për të dëmshpërblyer Blerësin në lidhje me pretendimin përkatës.

Shitësi do të jetë i detyruar të paguajë Blerësin ose Shoqërinë sipas këtij neni, vetëm nëse dhe kur Humbja përkatëse është bërë e pagueshme.

Neni 10

Forca madhore

Mospërmbushja e detyrimeve të marra përsipër sipas kësaj Kontrate prej ndonjërës palë, nuk do të konsiderohet shkelje ose mospërmbushje e kësaj Kontrate, në rast se kjo mospërmbushje vjen si pasojë e një Force Madhore, me kusht që Pala e dëmtuar nga kjo ngjarje:

(a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, kujdesin e duhur dhe masa alternative të arsyeshme, për të plotësuar kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate, dhe

(b) të ketë njoftuar Palën tjetër sa më shpejt që është e mundur për këtë ngjarje.

Çdo periudhë, brenda së cilës një Palë, sipas kësaj Kontrate, do të kryejë ndonjë veprim ose detyrë, do të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me periudhën e kohës, gjatë si cilës kjo Palë nuk ishte në gjendje që të kryente këtë veprim për shkak të Forcës Madhore.

Neni 11

Ligji që do të zbatohet dhe juridiksioni

Kjo Kontratë rregullohet nga e drejta angleze.

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë, efektivitetin, interpretimin, zbatimin e detyrueshëm dhe mbarimin e kësaj Kontrate do të zgjidhet përfundimisht nga një trup prej tre arbitrash sipas Rregullave të Pajtimit dhe Arbitrimit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Arbitrazhi do të zhvillohet në Paris dhe gjuha e procedimit të arbitrimit do të jetë gjuha angleze.

Palët me anën e kësaj Kontrate heqin dorë nga zbatimi i ndonjë rregulli tjetër statutor, dhe deklarojnë se njohin Rregullat e Pajtimit dhe Arbitrimit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Neni 12

Të ndryshme

12.1 Amendamentet

Asnjë amendament, modifikim, mbarim ose heqje dorë nga dispozitat e kësaj Kontrate, nuk do të jetë e vlefshme në asnjë rast në qoftë se nuk bëhet me shkrim dhe nuk nënshkruhet

nga ose në emër të secilës palë.

Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin e një të drejtë ose të ndonjë mjeti mbrojtjeje, të parashikuar nga kjo Kontratë ose me ligji, nuk përbën heqje dorë nga e drejta ose nga mjeti mbrotjes, ose heqje dorë nga të drejta ose mënyra të tjera mbrojtjeje. Mosushtrimi i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte ose i një mjeti mbrojtës të parashikuar me këtë Kontratë ose me ligji, nuk e pengon ushtrimin e mëtejshëm të së drejtës ose mjetit mbrojtës ose ushtrimin e një të drejtë ose të një mjeti mbrojtës tjetër.

12.2 Ndashmëria

Në qoftë se ndonjë dispozitë ose detyrim sipas kësaj Kontrate do të jetë i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në ndonjë juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve në asnjë mënyrë nuk do të ndikohen ose dëmtohen në ndonjë juridiksion tjetër.

Palët do të përpiqen të zëvendësojnë ndonjë dispozitë të pazbatueshëm ose të pavlefshme në masën më të madhe të mundshme për të arritur qëllimin e dispozitës së pazbatushme ose të pavlefshme.

12.3 Kopjet

Kjo Kontratë mund të nënshkruhet në një ose më shumë kopje dhe nga palë të ndryshme në kopje të veçanta, secila prej të cilave e nënshkruar dhe e dorëzuar në këtë mënyrë do të konsiderohet origjinal, por të gjitha këto kopje së bashku do përbëjnë një instrument të njëjtë dhe të vetëm; faqet e firmosura mund të shkëputen nga kopjet e shumëfishta dhe të vecanta dhe mund t'i ngjiten një kopjeje të vetme në mënyrë që të gjitha faqet e firmosura t'i ngjiten fizikisht të njëjtit dokument.

Dokumenti është në versionin anglisht dhe shqip. Në rast konflikti midis dy versioneve, përparësi do të ketë versioni anglisht.

12.4 Njofimet

Njoftimi ose komunikime të tjera sipas ose në lidhje me këtë Kontratë (më poshtë "Njoftimi") do të jetë:

- me shkrim
- në gjuhën angleze; dhe
- i dorëzuar ose i dërguar me postë rekomande ose teleks, faks, Palës që duhet ta marrë njoftimin në adresën e caktuar këtu më poshtë ose në një adresë tjetër të specifikuar nga kjo Palë.

Me përjashtim të rasteve kur provohet se është marrë më shpejt, njoftimi konsiderohet i dhënë nëse:

- është dërguar me postë 10 (dhjetë) ditë pune pas postimit të tij;
- është dërguar me telex, kur përgjigjja përkatëse është marrë; dhe
- është dërguar me faks kur konfirmimi i transmetimit është regjistruar nga faksi i dërguesit.

Adresat që u referohen janë:

Blerësi

- Emri i Palës: Cosmoholding - Albania S.A.
- Adresa: Athens, Kifisias 44
- Nr. Faksi: +301.617.75.07
- Dërguar në vëmendje të: Ms. Irini Nikolaidi

Shitësi

- Emri i Palës: Ministry of Public Economy and Privatisation
- Adresa: Tirana, Sheshi Skanderbeg
- Nr. Faksi: +355.4.225.154
- Dërguar në vëmendje të: Mr. Vasil Pano

12.5 Kalimi i të drejtave

Blerësi nuk mund të japë dhe kalojë ndonjë të drejtë sipas kësaj Kontrate në tërësi ose në veçanti pa pasur më parë pëlqimin me shkrim të Shitësit, pëlqim i cili nuk mund të mos jepet pa arsye.

12.6 Kostot dhe taksat

Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, secila Palë do të paguajë shpenzimet e veta që lidhen me negociatat, përgatitjet, nënshkrimet dhe realizimin prej saj të kësaj Kontrate dhe të secilit dokument të referuar në të.

12.7 Tërësia e Marrëveshjes

Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

Shitësi

Z. Mustafa Muçi

Nënshkruesit

Z. Evangelos Martigopoulos

Z. Ivar Sliper

L I G J

Nr.8661, datë 18.9.2000

PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT TIRANË
Nr. i Vendimit 12910/5

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETËM

Sot, më datë 21.12.2000, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Enkela Bajo pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "Albanian Mobile Comunications – AMC" sh.a. (më poshtë referuar si "Shoqëria") e paraqitur prej drejtorit të përgjithshëm të Shoqërisë. si dhe dokumentat e tjera bashkëngjitur kërkesës,

KONSTATOVA:

Shoqëria **"Albanian Mobile Communications - AMC"** Sh.A. është regjistruar si person juridik me vendim nr. 12910 datë 27 nëntor 1995. Ortaku Themelues i saj është Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit e Republikës së Shqipërisë. Në bazë të ligjit 8515 datë 21 07.1999 dhe ligjit 8660 datë 18.09.2000 shoqëria është privatizuar duke i shitur 85% të aksioneve shoqërisë së të drejtës greke Cosmoholding Albania S.A.

Më datë 23.08.2000 është zhvilluar mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Shoqërisë me pjesëmarrjen e 100% të kapitalit për të diskutuar mbi këtë rend dite:

1. Paraqitjen në Asamble të letrave të dorëheqjes të anëtarëve të Këshillit të Mbikqyrjes;
2. Paraqitjen në Asamble të letrave të dorëheqjes të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.
3. Emërimi i anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikqyrës.

Cosmoholding Albania S.A zotëruese e 85% të aksioneve përfaqësohej nga Z. Stefanos Octapodas dhe Z. Alexandros Athanasiou. Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit përfaqësohej nga Z. Pirro Xhixha.

Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës pas një diskutimi të hollësishëm, Asambleja me unanimitet vendosi të pranojë dorëheqjen e Z. Pirro Xhixha dhe Z. Dhame Pite nga posti i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës Asambleja me unanimitet vendosi pranimin e dorëheqjes së Z. Genci Hamzaraj nga posti i drejtorit të shoqërisë.

Në lidhje me pikën e tretë të rendit të ditës pas një diskutimi të hollësishëm Asambleja me unanimitet vendosi të emërojë anëtarë të këshillit mbikqyrës të shoqërisë:

- Z. Nikolaos MANASIS, qytetar grek, lindur më 05.07.1944, në Selanik dhe banues në Athinë, Kifissia (43, Petros Str.), Pass. nr. M 545536; dhe
- Z. Dimitris SCOULICARIS, qytetar grek, lindur më 12.06.1938, në Kriti Kritsa Lasithiou dhe banues në Athinë (Agathoupoleos Str.), Pass. nr. M 234959

Në vijim të sa më sipër në datë 23 gusht 2000 u zhvillua Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë për të zgjedhur drejtorinë e re. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm Z. Nikolaos Manasis dhe Z. Dimitris Scoulicaris.

Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës vendosi të emërojë Drejtorinë e Shoqërisë si më poshtë:

1. Drejtor i Përgjithshëm	Z. Stefanos Octapodas
2. Zv. Drejtor i Përgjithshëm	Z. Genc Hamazaraj
3. Anëtar	Z. Evangelos Martigopoulos
4. Anëtar	Z. Elias Fotiadis
5. Anëtar	Z. Nikolaos Tsolas
6. Anëtar	Znj. Irini Nikolaidi

Sot më datë 12.12.2000, duke u mbështetur në Nenin 8 të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", Z. Stefanos Octapodas ka paraqitur kërkesë para Gjykatës së Rrethit Tiranë për të depozituar në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate vendimet e mësipërme.

Pasi shqyrtova kërkesën e saj çmova se ajo është e drejtë dhe e bazuar në ligj

PËR KËTO ARSYE:

Dhe në bazë të ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar"

VENDOSA:

Pranimin e kërkesës së Shoqërisë Albanian Mobile Communications AMC Sh.A.

Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë të vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë datë 23 gusht 2000 dhe vendimit të Këshillit Mbikqyrës datë 23 gusht 2000.

Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse në kolonën nr.....7....., dhe nr. rendor .....7..... në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të kësaj Gjykate, duke bërë vijëzimet me bojë të kuqe.

Tiranë më 4. 12.2000

GJYQTARE

ENKELA BAJO

(19)

12910/6
06.06.2001

Zy A. Copo
16.05.2001

16 MAG. 2001

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
LINDITA S. LLESHI
NOTER
TIRANË

KERKESE

KERKUES: Shoqëria "Albanian Mobile Communications AMC" Sh.A., shkurt "AMC" Sh.A e përfaqësuar me prokurë nga Av. Erinda Ballanca lindur në Tiranë, më 29.10.1973 dhe pasaportë nr. 0368205 dhe Enkelejda Muçaj lindur në Tiranë, më 02.06.1974 e me numër pasaporte 0145950.

OBJEKTI: Depozitimi i dokumentave për caktimin e një anëtari të ri të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë Anonime "Albanian Mobile Communications AMC" Sh.A, shoqëri e së drejtës shqiptare në bazë të ligjit 7638 datë 28.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe të ligjit 7667 datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen zbatuar nga Shoqëritë Tregtare"

për kompetencë

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE
SEKSIONIT TREGTAR

Shoqëria "AMC" Sh.A., (më poshtë, "Shoqëria") është një shoqëri anonime pa ofertë publike e të drejtës shqiptare me seli në Rr. Gjergj Legisi, Laprakë, Tiranë, regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit të Tiranës me anë të vendimit nr 12910, datë 27.11.1995.

Shoqëria ka një kapital të nënshkruar dhe të paguar prej 813.822.000 lekë, i cili përbëhet nga 813.822.000 aksione me vlerë nominale prej 1.000 lekë. Kjo shoqëri e ushtron aktivitetin e saj kryesor në fushën e telekomunikacioneve, ashtu siç është parashikuar me hollësi në vendimin e Gjykatës.

Në datën 29.03.2001 është zhvilluar Mbledhja e Zakonshme e Asamblesë së Shoqërisë "AMC" Sh.A., ku qenë të pranishëm Z. Stefanos Oktapodas, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të Cosmoholding Albania Sh.A., Z. Vasil Pano, me cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, dhe Z. Genci Hamzaraj me cilësinë e të ftuarit. Z. Stefanos Oktapodas ka marrë përsipër detyrën e kryetarit të Mbledhjes së Asamblesë së Zakonshme të Shoqërisë.

Kryetari i Asamblesë, pasi verifikoi prezencën e aksionerëve dhe të quorumit të duhur të Shoqërisë, kaloi në diskutimin e rendit të ditës. Kryetari i Asamblesë u shpreh se Z. Dimitris SCOULICARIS, anëtar i Këshillit Mbikqyrës (më poshtë "Këshilli"), ka hequr dorë nga ngarkesa çdo angazhim në grupin e Cosmote-s dhe kështu i propozon Mbledhjes ta zëvendësojë atë, duke zgjedhur një anëtar të ri të Këshillit, në përputhje me nenin 105 të Ligjit 7638. Kryetari i sugjeron zgjedhjen e një anëtari të ri të Këshillit e pikërisht të Z. Megaklis STOUKIDIS, qytetar grek, inxhinier elektronik, me ekperiencë të madhe në sektorin e telekomunikacioneve të lëvizshme, profili profesional i të cilit i prezantohet të pranishmëve

nga ana e kryetarit. Pasi ortakët i analizuan ato dhe pasi diskutuan rreth tyre në detaj, vendosën me unanimitet për marrjen e këtyre vendimeve si më poshtë vijon:

- Zgjedhjen e Z. Megaklis STOUKIDIS, qytetar grek, lindur në Lesvos (Greqi), më 6.12.1953 e banues në Agiou Dimitrou, Psyhico (Greqi), me numër pasaporte M 873513, si anëtar i ri i Këshillit Mbikqyrës të AMC-së, në postin e Zëvendës Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës të AMC-së. Z. Megaklis STOUKIDIS zëvendëson Z. Dimitris SCOULICARIS.

Sot, më datë 11.05.2001, në bazë të ligjit 7667 datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", kërkoj depozitimin e dokumentit si më poshtë vijon:

- Proçesverbali i Asamblesë së Zakonshme të shoqërisë "AMC" Sh.A, me datë 29.03.2001. të vërtetuar rregullisht nga noteri, së bashku me dokumentet shoqëruese që janë:

  a) Prokurë e lëshuar në datë 27.03.2001, nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Z. Mustafa Muçi, në favor të Z. Vasil Pano, Drejtor i Drejtorisë së Privatizimit të Sektorëve Strategjikë pranë kësaj Ministrie, për të përfaqësuar këtë institucion në Mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme të Shoqërisë me datë 29.03.2001.

  b) Prokurë e lëshuar në datë 09.03.2001, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Cosmoholding Albania Sh.A., Z. Evagelos Martigopoulos, në favor të Z. Stefanos Oktapodas, për të përfaqësuar Cosmoholding Albania Sh.A., në Mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme, me datë 29.03.2001.

  c) Proçesverbal i mbledhjes nr. 7 të Bordit të Drejtorëve të Cosmoholding Albania Sh.A., datë 22.01.2001, ku është vendosur, ndër të tjera, edhe për tagrat e përfaqësimit të Drejtorit të Përgjithshëm Z. Evagelos Martigoluplos në lidhje me mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të shoqërisë "AMC" Sh.A., të vërtetuar rregullisht nga noteri.

KERKUES

Përfaqësuesi me prokurë speciale nga
Stefanos Oktapodas
Drejtor i Përgjithshëm i "AMC" Sh.A.
Av. Erinda Ballanca

Tiranë më 14.05.200

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr.....Rep.
Nr. .....822.....Kol.

VERTETIM

Sot më datë 10. 05. 2001, përpara meje, noteres Linda Lleshi, u paraqit personalisht Znj. Erinda Ballanca. Për identitetin e saj u sigurova nga letërnjoftimi personal, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, e cila më deklaroi se sa më sipër është një kërkesë drejtuar Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe unë e vërtetoj atë rregullisht.

NOTERE

Linda Lleshi

PULLE TAKSE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE LINDITA S. LLESHI NOTER TIRANË

TRUE COPY OF THE MINUTES OF THE BOARD MEETING OF COSMOHOLDING ALBANIA S.A. OF 22.1.2001

MEETING No 7

On Monday, the 22nd of January, 2001 at 17:00 a.m., at the headquarters of the Company in Kifissias Avenue No 44, Meeting No 7 of the Board of Directors of the Company under the name " COSMOHOLDING ALBANIA SOCIETE ANONYME" and the discriminative title "COSMOHOLDING ALBANIA" took place in order to discuss the current issues of the Company.

The following were present:

MANASIS NIKOLAOS	**CHAIRMAN**
FOTIADIS ELIAS	**VICE-CHAIRMAN**
MARTIGOPOULOS EVANGELOS	**MANAGING DIRECTOR**
TSOLAS NIKOLAOS	**MEMBER**
NIKOLAIDI IRINI	**MEMBER**

The board is at quorum.

The duties of secretary are performed by Mr. Kostas Vogiatzis.

AGENDA
(MEETING No 7/22.1.2001)

1. Approval of the agenda.
2. Ratification of the minutes of Meeting No 6/15.12.2001 of the Board of Directors.
3. Representation of the Company at the General Meetings of "Albanian Mobile Communications Sh. A." (AMC).

ITEM 1: APPROVAL OF THE AGENDA.

The Board of Directors approves unanimously the discussion of the above mentioned items of the agenda.

ITEM 2: RATIFICATION OF THE MINUTES OF MEETING No 63/26.02.1999 OF THE BOARD OF DIRECTORS.

The Board of Directors unanimously ratifies the minutes of Meeting Nos 64/26.03.1999 and 65/30.03.1999.

ITEM 3: REPRESENTATION OF THE COMPANY AT THE GENERAL MEETINGS OF "ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS Sh. A." (AMC).

The Board of Directors, after taking into consideration: a. Chairman's oral recommendation, and b. the discussed opinions, **decides unanimously** the following:

Authorizes the Managing Director to represent COSMOHOLDING ALBANIA at the General Meetings, Ordinary and Extra Ordinary, of "Albanian Mobile Communications Sh. A." (AMC) and to sign on behalf of COSMOHOLDING ALBANIA the General Meetings of AMC, as well as to appoint as proxy Lawyers or other persons, to which he assigns the above mentioned representation.

Following the above the Meeting is terminated.

THE CHAIRMAN	THE SECRETARY	THE MEMBERS
N. MANASIS	K. VOGIATZIS	E. MARTIGOPOULOS
		E. FOTIADIS
		N. TSOLAS
		E. NIKOLAIDI

KOPJE ORIGJINALE E PROCES-VERBALIT TË MBLEDHJES SË DREJTORISË TË COSMOHOLDING ALBANIA Sh.A. DATË 22.01.2001

TAKIM NR. 7

Ditën e Hënë, datë 22 Janar 2001, në orën 17.00, në selinë e Shoqërisë Kifissias me adresë në Avenue No. 44, Mbledhja e Drejtorisë Nr. 7 të shoqërisë "COSMOHOLDING ALBANIA SOCIETE ANONYME" dhe titullin dallues "COSMOHOLDING ALBANIA" u mbajt me qëllim për të diskutuar çështjet e ditës së Shoqërisë.

Personat e mëposhtëm ishin të pranishëm:

MANASIS NIKOLAOS	**Kryetar**
FOTIADIS ELIAS	**Nën-Kryetar**
MARTIGOPOULOS EVANGELOS	**Drejtor Ekzekutiv**
TSOLAS NICOLAOS	**Anëtar**
NIKOLAIDI IRINI	**Anëtar**

Drejtoria formon quorum-in.

Detyrat e sekretarit kryhen prej Z. Kostas Vogiatizis.

Rendi i Ditës
(Mbledhja Nr 7/22.1.2001)

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Ratifikimi i proces-verbalit të Mbledhjes Nr. 6/15.12.2001 të Drejtorisë.
3. Përfaqësimi i Shoqërisë në Mbledhjet e Përgjithshme të "Albanian Mobile Communications Sh.A." (AMC).

ÇËSHTJA 1: MIRATIMI I RENDIT TË DITËS.

Drejtoria miraton unanimisht diskutimin e çështjeve të lartpërmendura të rendit të ditës.

ÇËSHTJA 2: RATIFIKIMI I PROCES-VERBALIT TË MBLEDHJES NR. 63/26.02.1999 TË DREJTORISË

Drejtoria unanimisht ratifikon proces-verbalin e Mbledhjes Nr. 64/26.03.1999 dhe 65/30.03.1999.

ÇËSHTJA 3: PËRFAQËSIMI I SHOQËRSIË NË MBLEDHJET E PËRGJITHSHME TË "ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS Sh.A." (AMC).

Drejtoria, pasi mori në konsideratë a. Rekomandimin me gojë të Kryetarit, dhe b. opinionet e diskutuara, vendosi unanimisht si vijon:

Autorizon Drejtorin Ekzekutiv të përfaqësojë COSMOHOLDING ALBANIA në Mbledhjet e Përgjithshme të "Albanian Mobile Communications Sh.A." (AMC) dhe të nënshkruajë në emër të COSMOHOLDING ALBANIA Mbledhjet e Përgjithshme të AMC-së, si dhe të caktojë si përfaqësues ligjorë Avokatë ose persona të tjerë, to cilëve i kalon të drejtën e përfaqësimit të lartpërmendur.

Në lidhje me sa më sipër Mbledhja përfundon.

KRYETARI	SEKRETARI	ANËTARËT	
FIRMA N. MANASIS	FIRMA K. VOGIATZIS	E.MARTIGOPOULOS	Firma
		E. FOTIADIS	Firma
		N. TSOLAS	Firma
		E. NIKOLAIDI	Firma

PULLE TAKSE

VERTETIM I PERKTHIMIT

Unë vërtetoj se sot, më 18/05/2001, deklarova se versioni Shqip i dokumentit bashkëngjitur është me përkthim saktë i versionit anglisht dhe anasjelltas.

PERKTHYES
Artur Asllani

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 2925 **Rep.**
Nr. _____ **Kol.**

VERTETIM

Vërtetoj se sot më datë 18/05/2001, para meje noteres Arjana Mallkuci u paraqit Artur Asllani, i njohur personalisht prej meje, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili më deklaroi se e ka përkthyer dokumentin bashkangjitur nga anglishtja në shqip mëllej me origjinalin dhe e nënshkroi atë para meje noterit dhe unë e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERI

NOTERE
ARJANA MALLKUCI
RR. DURRESIT P. 11
TIRANE ☎ 250253

Albanian Mobile Communications AMC - Sh.A.
Rruga Gjergj Legjisi, Laprake, Tirana
Tel: 00355.4.234.915 Fax: 00355.4.235.157

MINUTES OF THE ORDINARY SHAREHOLDERS' MEETING OF ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS AMC - SH.A.

In the year 2001 on the 29th day of the month of March, at 11.30, the first call of the Ordinary Shareholders' Meeting (hereinafter, "Meeting") of ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS AMC - Sh.A. (the "Company") is held at the headquarters of the Company in Rruga Gjergj Legjsi, Laprake, Tirana.

The following people are present in person:

1 Mr. Stefanos OKTAPODAS, in his quality of representative of the Greek company Cosmoholding Albania S.A., which holds 85% of the share capital of the Company, as results from the proxy which is attached to these minutes (Annex 1), as well as in his quality of member of the Board of Directors of AMC (hereinafter, "Board");

2. Mr. Vasil PANO, in his quality of representative of the Ministry of Public Economy and Privatization of the Republic of Albania, as results from the proxy which is attached to these minutes (Annex 2), which holds 15% of the share capital of the Company;

3. Mr. Genci HAMZARAJ, in his quality of member of the Board.

Mr. Stefanos OKTAPODAS is called to chair the Meeting. The Chairman invites Mr. HAMZARAJ, who accepts, to act as secretary. The Chairman controls the regularity of the convocation of the Meeting and, in compliance with art. 133 of Law 7638, dated 19.11.1992, *On commercial companies*, as amended, noting that all the shareholders of the Company are present or represented, declares that the meeting is regularly held, and can discuss and resolve upon the following

AGENDA

1. APPOINTMENT OF A NEW MEMBER OF THE COUNCIL OF SUPERVISORS;
2. MISCELLANEOUS.

* * * *

The Chairman opens the discussion following the items indicated in the agenda.

1. APPOINTMENT OF A NEW MEMBER OF THE COUNCIL OF SUPERVISORS

Motion:

The Chairman communicates that Mr. Dimitris SCOULICARIS, member of the Council, has withdrawn from any commitment in the Cosmote group and, therefore, proposes to the Meeting to

replace him, appointing a new member of the Council, according to art. 105 of Law 7638. The Chairman suggests appointing as new member of the Council Mr. Megaklis STOUKIDIS, Greek citizen, electronic engineer, with a high experience in the mobile telecommunications sector, whose professional profile is described by the Chairman to the present people. Mr. Pano proposes to appoint as new member of the Council Mr. Pirro Xhixho, former member of the Council and Director of the General Department of Post and Telecommunications.

After throughout discussion on the issue, the Meeting unanimously

RESOLVES

1. the appointment of Mr. Megaklis STOUKIDIS, Greek citizen, born in Lesvos (Greece) on 6.12.1953, resident in Agiou Dimitriou, Psyhico (Greece), pass. no. M 873513, as new member of the Council of Supervisors of AMC, in the position of Vice-Chairman of the Council of Supervisors. Mr. Megaklis STOUKIDIS replaces Mr. Dimitris SCOULICARIS.

* * * *

Since no other issues are raised and nobody asks to speak, the Chairman declares that the Meeting is closed at 12.30. The Chairman reads these minutes to the shareholders, who declare that the minutes fully express their will, and undersigns these minutes with the Secretary.

The Chairman

Mr. Stefanos APOSTAS

REPUBLIKA E SHQIPERISE Albanian Mobile Communications AMC

The Secretary

Mr. Genci HAMZARAJ

Albanian Mobile Communications AMC –Sh.A
Rruga Gjergj Legisi, Laprakë, Tiranë
Tel: 00355.4.234.915 Fax: 00355.4.235.157

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES SE ZAKONSHME TE AKSIONEREVE TE ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS AMC-Sh.A.

Në vitin 2001, më ditën e 29-të të muajit Mars, ora 11.30, thirrja e parë e Mbledhjes së Zakonshme të Aksionerëve (që më poshtë quajtur Mbledhja) të shoqërisë ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS AMC-Sh.A. ("Shoqëria") u mbajt në selinë e Shoqërisë që ndodhet në adresën Rruga "Gjergj Legisi", Laprakë, Tiranë.

Të pranishëm personalisht personat e mëposhtëm:

1 Z. Stefanos OKTAPODAS, në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë greke Cosmoholding Albania S.A., e cila zotëron 85% të aksioneve të Shoqërisë, siç rezulton nga prokura e bashkëngjitur këtij proçesverbali (Shtojca 1), si dhe në cilësinë e tij të anëtarit të Bordit të Drejtorëve të AMC (më poshtë i quajtur, "Bordi");

2. Z. Vasil PANO, në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të Republikës së Shqipërisë, siç rezulton nga prokura e bashkëngjitur këtij proçesverbali (Shtojca 2), që mban 15% të aksioneve të Shoqërisë;

3. Z. Genci HAMZARAJ, në cilësinë e tij si anëtar bordi.

Z. Stefanos OKTAPODAS është caktuar të drejtojë takimin. Kryetari fton Z. HAMZARAJ të veprojë si sekretar dhe ai pranon. Kryetari kontrollon rregullsinë e mbledhjes dhe në përputhje me nenin 133 të Ligjit 7638, datë 19.11.1992, Mbi Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar, duke vënë re se të gjithë aksionerët e Shoqërisë janë të pranishëm ose të përfaqësuar, deklaron që Mbledhja është mbajtur rregullisht dhe mund të diskutojë e vendosë për sa vijon:

RENDI I DITES

1. CAKTIMI I NJE ANETARI TE RI TE KËSHILLIT MBIKQYRËS
2. TE NDRYSHME.

***

Kryetari hap diskutimin sipas rradhës së përcaktuar në rendin e ditës.

1. CAKTIMI I NJE ANETARI TE RI TE KËSHILLIT MBIKQYRËS

PROPOZIM:

Albanian Mobile Communications AMC –Sh.A
Rruga Gjergj Legisi, Laprakë, Tiranë
Tel: 00355.4.234.915 Fax: 00355.4.235.157

Kryetari shpreh se Z. Dimitris SCOULICARIS, anëtar i Këshillit, ka hequr dorë nga çdo angazhim në grupin e Cosmote-s dhe kështu i propozon Mbledhjes ta zëvendësojë atë, duke zgjedhur një anëtar të ri Këshillit, në përputhje me nenin 105 të Ligjit 7638. Kryetari sugjeron të zgjidhet si anëtar i ri i Këshillit Z. Megaklis STOUKIDIS, qytetar grek, inxhinier elektronik, me eksperiencë të madhe në sektorin e telekomunikacioneve mobile, profili profesional i të cilit i është prezantuar nga Kryetari, personave të pranishëm. Z. Pano propozon që të zgjidhet si Anëtar i Këshillit, Z. Pirro Xhixho, ish anëtar i Këshillit dhe Drejtor i Departamentit të Përgjithshëm të Postave dhe Telekomunikacioneve.

Pas disa diskutimesh mbi çështjen, Mbledhja unanimisht

Vendosi

1. Zgjedhjen e Z. Megaklis STOUKIDIS, qytetar grek, lindur në Lesvos (Greqi), më 6.12.1953, banues në Agiou Dimitriou, Psyhico (Greqi), me numër pasaporte M 873513, si anëtar i ri i Këshillit Mbikqyrës të AMC, në postin e Zëvendës-kryetarit të Këshillit Mbikqyrës të AMC-se. Z. Megaklis STOUKIDIS zëvendëson Z. Dimitris SCOULICARIS.

***

Meqë nuk ngrihen çështje të tjera për disktutim dhe askush nuk dëshiron të flasë, Kryetari e deklaron Mbledhjen të mbyllur në orën 12.30. Kryetari lexon këtë proces-verbal aksionerëve, dhe deklaron që ky proçes-verbal është shpreh vullnetin e tyre dhe e nënshkruan atë më Sekretarin.

Kryetari

Z. Stefanos OKTAPODAS

Sekretari

Z. Genci HAMZARAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË Albanian Mobile Communications sh.a AMC

PULLE TAKSE 100

VERTETIM I PERKTHIMIT

Unë vërtetoj se sot, më __/__/05/2001, deklarova se versioni Shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i saktë i versionit Anglisht dhe anasjelltas.

PERKTHYES

Artur Asllani

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 2526 **Rep.**
Nr. _____ **Kol.**

VERTETIM

Vërtetoj se sot më datë 13 /05/2001, para meje noteres Arjana Mallkuci u paraqit Artur Asllani, i njohur personalisht prej meje, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cil më deklaroi se e ka përkthyer dokumentin bashkangjitur nga anglishtja në shqip njëlloj me origjinalin dhe e nënshkroi atë para meje noterit dhe unë e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERI

NOTERE
ARJANA MALLKUCI
RR. DURRESIT P.11
TIRANE ☎ 250253

PROXY

9.3.2001

I, as a shareholder of "AMC – Albanian Mobile Communications" Sh.A., with registered office in Rruga Gjergj Legjisi, Laprake, Tirana, hereby delegate and appoint Mr Stephanos Oktapodas to represent me at the Ordinary Shareholders' Meeting of said company, to be held at the offices of the Company on March 29, 2001.

In case of absence or impediment of Mr.Stephanos Oktapodas he can be replaced by Ms Irini Nikolaidi

I hereby ratify in advance whatever my representative has done by virtue of this proxy.

The Managing Director of Cosmoholding Albania S.A.
Mr. Evagelos Martigopoulos

PROKURË

9.3.2001

Unë, si aksioner i "AMC – Albanian Mobile Communications" Sh.A., me seli në Rruga Gjergj Legjsi, Laprakë, Tiranë, me anë të kësaj prokure delegoj dhe caktoj Z./Znj. Stephanos Oktapodas të më përfaqësojë në Asamblenë e Zakonshme të kësaj shoqërie, që do të mbahet në selinë e Shoqërisë më 29 mars 2001.

Në rast mosparaqitjeje ose pamundësie të Z./Znj.Stephanos Oktapodas ai/ajo mund të zëvendësohet nga Z./Znj.Irini Nikolaidi.

Unë pranoj paraprakisht çfarëdo që do të kryejë përfaqësuesi im në bazë të kësaj prokure.

Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Cosmoholding Albania S.A.
Z. Evagelos Martigopoulos

PULLE TAKSE

VERTETIM I PERKTHIMIT

Unë vërtetoj se sot, më 15 /05/2001, deklarova se versioni Shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i saktë i versionit Anglisht dhe anasjelltas.

PERKTHYES

Artur Asllani

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 2824 **Rep.**
Nr. _____ **Kol.**

VERTETIM

Vërtetoj se sot më datë 15 /05/2001, para meje noteres Arjana Mallkuci u paraqit Artur Asllani, i njohur personalisht prej meje, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili më deklaroi se e ka përkthyer dokumentin bashkangjitur nga anglishtja në shqip njëlloj me origjinalin dhe e nënshkroi atë para meje noterit dhe unë e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERE

NOTERE
ARJANA MALLKUCI
RR. DURRESIT P. 11
TIRANE ☎ 250253

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
Drejtoria e Administrimit te Prones Publike.

Blvd. Deshmoret e Kombit Nr.2
E-mail: postmaster@mepp.tirana.al
Internet: http://www.mepp.gov.al

Tel: 355 42 226452
Fax 355 42 226452

Nr_____Prot. 2338/1

Tirane,me 27. 3. **2001**

AUTORIZIM

Ne zbatim te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992, "Per Shoqerite Tregetare" me cilesine e zoteruesit te paketes shteterore te aksioneve ne Sh.A "Albanian Mobile Communucations" Tirane, autorizohet Z.Zamir Stefani drejtor i Drejtorise Juridike ne M.E.P.P, dhe Z.Vaso Pano drejtor i Drejtorise se Privatizimit te Sektoreve Stradegjike ne M.E.P.P, te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblese se Zakonshme te Aksionereve ne daten 29.03.2001 .

Mbledhja zhvillohet ne seline e Shoqerise.

MINISTRI

MUSTAFA MUÇI

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE DHE PRIVATIZIMIT TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 1291/6

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me datë 06.05.2001, unë gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Rrethit Tiranë Anila Capo pasi mora në shqyrtim kërkesën e kërkuesit, Shoqërisë "Albanian Mobile Communications AMC" Sh.A., shkurt "AMC" Sh.A. e përfaqësuar me prokurë nga Av. Erinda Ballanca lindur në Tiranë, më 29.10.1973 dhe pasaportë nr. 0368208.

KONSTATOVA SE:

Shoqëria "AMC" Sh.A., (më poshtë. "Shoqëria") është një shoqëri anonime pa ofertë publike e të drejtës shqiptare me seli në Rr. Gjergj Legisi, Laprakë, Tiranë, regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit të Tiranës me vendimin nr. 12910, datë 27.11.1995.

Shoqëria ka një kapital të nënshkruar dhe të paguar prej 813.822.000 lekë, i cili përbëhet nga 813.822.000 aksione me vlerë nominale prej 1.000 lekë. Kjo Shoqëri e ushtron aktivitetin e saj kryesor në fushën e telekomunikacioneve, ashtu siç është parashikuar me hollësi në vendimin e Gjykatës.

Në datën 29.03.2001 është zhvilluar Mbledhja e Zakonshme e Asamblesë së Shoqërisë "AMC" Sh.A., ku qenë të pranishëm Z. Stefanos Oktapodas, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të Cosmoholding Albania Sh.A., Z. Vasil Pano, në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, dhe Z. Gene Hamzaraj në cilësinë e të fituarit, që së bashku përbëjnë quorumin.

Në këtë mbledhje u parashtrua fakti se Z. Dimitris SCOULICARIS, anëtar i Këshillit Mbikqyrës (më poshtë. "Këshilli"), kishte hequr dorë nga nga çdo angazhim në grupin e Cosmote-s dhe kështu iu propozua Mbledhjes ta zëvendësojë atë, duke zgjedhur një anëtar të ri të Këshillit, në përputhje me nenin 105 të Ligjit 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare". Kryetari sugjeroi zgjedhjen e një anëtari të ri të Këshillit, e pikërisht të Z. Megaklis STOUKIDIS, qytetar grek, inxhinier elektronik, me eksperiencë të madhe në sektorin e telekomunikacioneve të lëvizshme, profili profesional i të cilit i prezantohet të pranishmëve nga ana e kryetarit. Pasi ortakët i analizuan ato dhe pasi diskutuan rreth tyre në detaj, vendosën me unanimitet për marrjen e vendimit si më poshtë vijon:

- Zgjedhjen e Z. Megaklis STOUKIDIS, qytetar grek, lindur në Lesvos (Greqi), më 6.12.1953 e banues në Agiou Dimitrou, Psyhico (Greqi), me numër pasaporte M 873513, si anëtar i ri i Këshillit Mbikqyrës të AMC-së, në postin e Zëvendës Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës të AMC-së. Z. Megaklis STOUKIDIS zëvendëson Z. Dimitris SCOULICARIS.

Pas shqyrtova kërkesën e Shoqërisë dhe dokumentacionin shoqërues, çnjohu se ajo është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE

dhe në bazë të ligjit 7638 datë 19.11. 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe të ligjit 7667 datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare"

V E N D O S A

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin në Regjistrin Tregtar të Proçesverbalit të Asamblesë së Zakonshme të shoqërisë "AMC" Sh.A., me datë 29.03.2001, të vërtetuar rregullisht nga noteri, së bashku me dokumentet shoqëruese që janë:

   a) Prokurë e lëshuar në datë 27.03.2001, nga Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Z. Mustafa Muçi, në favor të Z. Vasil Pare, Drejtor i Drejtorisë së Privatizimit të Sektorëve Strategjikë prane kësaj Ministrie, për të përfaqësuar këtë institucion në Mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme të Shoqërisë me datë 29.03.2001.
   b) Prokurë e lëshuar në datë 09.03.2001, nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Cosmoholding Albania Sh.A., Z. Evagelos Martigopoulos, në favor të Z. Stefanos Oktapodas, për të përfaqësuar Cosmoholding Albania Sh.A., në Mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme, me datë 29.03.2001.
   c) Proçesverbal i mbledhjes nr. 7 të Bordit të Drejtorëve të Cosmoholding Albania Sh.A., datë 22.01.2001, ku është vendosur, ndër të tjera, edhe për tagrat e përfaqësimit të Drejtorit të Përgjithshëm Z. Evagelos Martigoluplos në lidhje me mbledhjet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të shoqërisë "AMC" Sh.A., të vërtetuar rregullisht nga noteri.

3. Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit Tregtar për të bërë ndryshimet përkatëse me nr rendor ... në kollonën ... duke bërë vijëzimet me bojë të kuqe.

GJYQTARE

ANILA CAPO

Tiranë, më 05.06.2001

Nr 2675 Reg.
Nr 968 Mb.

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Dhoma e noterise –T i r a n e

KONTRATE DHURIMI E AKSIONEVE

Sot me date 08.09.2004, para meje Xhevahire Brahja, notere ne qytetin e Tiranes, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

DHURUES:

Z. Fabian Miraj, emri i babait, Zef, lindur ne Shkoder me 04/08/1920, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Leter Njoftim Nr. Z 0535184

Znj. Aspasija Miraj, emri i babait, Lluka, e lindur ne Durres me 10/10/1928 madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Leter Njoftim Nr. Z 0535185

Znj. Elena Miraj, emri i babait, Mark, lindur ne Vlore me 14/05/1966, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Leter Njoftim Nr. N F 205293

PRANUES DHURIMI:

Z. Aleksander Miraj, emri i babait, Fabian, lindur ne Durres me 01/12/1957 madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Leter Njoftim Nr. Z 0162142

OBJEKTI I KONTRATES

Dhurimi i 250 aksioneve e barabarte me 250 000 leke ne kapitalin e shoqerise Albanian Mobile Communications sh a

Dhuruesit deklarojne se ne baze te ekstraktit te regjistrit te aksioneve te AKP-se, leshuar nga Qendra e Regjistrimit te Aksioneve, kane perkatesisht :

Z. Fabian Miraj, 100 aksione e barabarte me 100.000 leke,
Znj. Aspasia Miraj, 100 aksione e barabarte me 100.000 leke,
Znj. Elena Miraj, 50 aksione e barabarte me 50.000 leke,

Keto aksione dhuruesit me vullnetin e tyre te lire e te plote ja dhurojne pa asnje kusht dhe kundershperblim **Z. Aleksander Miraj,** i cili i pranon keto dhurime.

Me noterimin e kesaj kontrate dhe regjistrimin ne librin e aksioneve te shoqerise, dhuruesit çvishen nga pronesia e 250 aksioneve e barabarte me 250.000 leke te kapitalit te shoqerise Albanian Mobile Communications sh.a., dhe pronar i tyre behet **Z. Aleksander Miraj**.

Kjo kontrate hartohet ne baze te dispozitave perkatese te Kodit Civil per dhurimin dhe per cdo gje qe nuk eshte e permendur ne kete kontrate vlejne dispozitat e kodit civil per kontraten e dhurimit.

Kontrata u redaktua ne kater ekzemplare te vecante, ju lexua paleve me ze te larte dhe te qarte, te cilet e kuptuan permbajtjen e saj dhe pasi u gjet sipas vullnetit te tyre te lire nenshkruhet nga palet ne pranine time dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

DHURUESIT: **PRANUESI I DHURIMIT**

Fabian Miraj Fabian Miraj **Aleksander Miraj**
Aspasia Miraj Aspasia Miraj Aleksander Miraj
Elena Miraj Elena Miraj

PULLE PAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1623 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Iris Dhoma madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Kontrate dhurimi, Akt shenjesh Nr. 2678 Rep, Nr. 812 Kol, Tolion Ulinaj, Mirsonde

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

TAKSE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR.524.Rep,.
Nr.20/...Kol.

KONTRATE DHURIMI
(AKSIONESH)

Sot me daten 31/08/.2004(dymije e KATER).diten e marte u paraqiten perpara meje Noteres Pranvera KARAFILI ,me seli ne Rr. "Myslym Shyri". Nr.46/1 palet me cilesine si me poshte:

DHURUESIA : Lidja Zaimi e bija e Mazarit dhe e Paqyzes lindur ne Tirane me 8/09/1951,banues ne Tirane ne Rruga "Gj.Muzaka" P.18/2.Ap.8 madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar,e identifikuar me pashaporte NR0525706.

PRANUESI : Qazim Zaimi i biri i Abdiut dhe Muhurijes. lindurt ne Tirane me 22/02/1945, banues ne Tirane ne Rrugen :"Gj.Muzaka "P.18/2 Ap.8.madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pashaporete Nr 028941 8.
Palet e me siperme kerkuan redaktimin e kesaj kontrate dhurimi aksionesh ne baze te N.761 e vijues te K.Civil..si me poshte:

Dhuruesia Lidja Zaimi eshte aksionere ne Sh.A. **"Albania Mobile Communication** e regjistruar si Shoqeri Aksionere ne Gjykaten e Shkalles se pare Tirane me NR Aplikacionit 32/A date 9/12/2000, dhe zoteron **75 AKSIONE** me vlere nominale te aksionit 1000 Leke dhe vlera totale e aksioneve eshte 75.000(shtatedhjet e pese mije)Leke

Dhuruesja Lidja Zaimi I dhuron pranuesit Qazim Zaimi 75 AKSIONET e A.M.C ,me vleften nominale te tij , dhe gjithsej ne vleften 75000(shtatedhjet e pese mijlek te reja.. duke humbur cdo te drejte mbi kete pjese te kapitalit **prej 75 AKSIONE.**

Pranuesi: Qazim Zaimi **pranon dhurimin e kuotave te kapitalit perkatesishte prej 75 AKSIONE nga Lidja Zaimi** ne vleften 75000(shatedhjet e pese mij) lek te reja. keshtu duke pranuar keto kuota behet zoterues ne kapitalin e shoqerise Aksionere "Albania Mobile Communication" dhe te 75 Aksioneve te Lidja Zaimi.
Me realizimin e kesaj kontrate dhurimi ,dhuruesja Lidja Zaimi I jep te drejte pronesije mbi aksionet e saj.nepermjet dhurimit te kuotave te saj, te cilat I **kalojne Z Qazim Zaimi.**
Ne kete menyre Zonja Lidja Zaimit nuk I mbetet asnje aksion ne kete shoqeri.pasi ato I kalojne Z.Qazim Zaimit.
Kjo eshte nje kontrate dhurimi e perpiluar ne tre kopje dhe pasi lexohet me ze te larte dhe gjendet ne perputhje te plote me vullnetin e paleve kontraktuese. nenshkruhet rregullishte perpara meje noteres dhe une noteria e vertetoje ate sipas ligji

DHURUESIA PRANUESI

Lidja Zaimi Qazim Zaimi

NOTERE

Pranvera Karafili

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1624 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Ilia Pekmezi madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te hashkalidhur : Kontrate shitjeje Akademesh, Nr. 5244 K.P.
Lidja Loimi dhe Gezim Loimi. Nr 201 K.O.
Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.
Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

PULE TAKSE 100 LEKE SHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE.
Nr. Rep. 1850.
Nr. Kol. 1650.

PULLE TAKSE 50 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

KONTRATE DHURIMI

Ne Tirane sot me date 09.09.2004 (dymije e kater) para meje noteres Donika Konçi me qender ne Bulevardin "Zhan D'Ark" u paraqiten personalisht palet kontraktuese dhe kerkuan redaktimin e kesaj kontrate dhurimi si vijon:

DHURUESIT: 1 Flamur Demiraj, i biri i Demirit, lindur ne Gjirokaster me 5 Dhjetor 1946, identifikuar nga leternjoftimi NF Nr. 467812

2: Bukuri Demiraj, e Bejos, lindur ne Gjirokaster me 10 Janar 1953, identifikuar nga leternjoftimi QH Nr. 287334;

te gjithe madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Dhuruesit jane pronare aksionesh ne masen: Flamur Demiraj 75 000 leke, Bukuri Demiraj 75 000 leke, te cilat jane dorezuar ne AMC Tirane (Albanian Mobile Communication), sipas formulareve Nr.98/A dhe 98/B, date 09.12.2000 te kerkesave per blerje aksionesh per person fizik te AKP.Tirane.

Me cilesine e pronareve dhuruesit Flamur Demiraj dhe Bukuri Demiraj deklarojne-se ja dhurojne pa shperblim perkatesisht aksionet e tyre zonjes Merita Demiraj, e cila i pranon shumat e aksioneve ne masen totale prej 150 000 (njeqind e pesedhjetemije) lekesh.

Me kete dhurim Flamur Demiraj dhe Bukuri Demiraj zhvishen nga pronesia mbi aksionet e mesiperme dhe pronar i tyre behet Merita Demiraj .

Pronares Merita Demiraj i lind e drejta te rregjistroje ne rregjistrin perkates te AKP Tirane pronesine mbi aksionet prej 150 000 (njeqind e pesedhjetemije) lekesh te dhuruar nga Flamur Demiraj dhe Bukuri Demiraj.

Kjo kontrate u redaktua dhe vertetua ne 4(kater) kopje, origjinali i pare i se ciles mbahet ne arshiven e kesaj zyre, njera i dergohet Zyres se AKP Tirane, dhe nga nje kopje u jepet paleve.

Une noterja pasi ju lexova paleve kontraktuese permbajtjen e Kontrates se mesiperme dhe konstatova se eshte sipas vullnetit te tyre, lejova nenshkrimin ne prezecen time dhe sipas ligjit i vertetoj ato.

Baza Ligjore:Neni 761 e vijuesa te Kodit Civil

DHURUESIT | **PRANUESE E DHURIMIT**

Flamur Demiraj | **Bukuri Demiraj** | **Merita Demiraj**

Flamur Demiraj | Bukuri Demiraj | Merita Demiraj

NOTERE

Donika Konçi

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1625 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Irio Pekmezi madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Kontrate shitjeje Akademiku, Nr. 1250 Rep Nr 160 Kol. Mamur Demiraj, tek Merita Demiraj

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

BULLETI TAKSE 100 LEKE R.SHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 4687 **REP**
NR 417 **KOL**

K O N T R A T E SHITBLERJE
PASURI E LUAJTSHME
A k s i o n e

Ne Tirane ,sot me date 09.09.2004 para meje noteres Aferdita Haxhia me adrese ne rrugen " Hoxha Tahsin " 113 me nr telefon e fax . 224754 u paraqiten personalisht palet kontraktuese dhe kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shtije me rezerve te pasurise se paluajteshme .

SHITESI T;

1- ARSINO JANO bija e Andonit e datelindjes 08.03.1942 me banim ne Tirane rruga " T. Tashko "me nr AZ 405364 te leter njoftimit te tije personal , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , madhore .

2- ANASTAS JANO biri i Taqit i datelindjes 20.10.1932 me banim ne Tirane rruga " T. Tashko " me nr AZ 405363 te leter njoftimit te saje personal , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , madhore .

3-MIRELA JANO bija e Anastasit dhe e Arsinos e datelindjes 24.05.1969 me banim ne Tirane madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , madhore

BLERESI.

1- SONILA JANO bija e Anastasit dhe e Arsinos e datelindjes 25.10.1974 me banim ne Tirane me nr 0490009 te pasaportesse saje personale , madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , madhore

BAZA LIGJORE :Neni 83,705 e vijues te Kodit Civil .

OBJEKTI I KONTRATES eshte :

Kalimi pronesise i 225 000 aksione(dyqinde e njezete pese mije aksione) nepermjet kesaj kontrate shitblerje nga pala shitese tek pala blerese e pasurise se luajteshmje e llojit AKSIONE te depozituara nga pala sejcili shites prane AKP' Tirane .

Shitesit kan psurin e turete ligjeshme dhe 1 -ANASTAS JANO zoteron 100 000 aksione 2 - ARSINO JANO zoteron 75 000 aksione dhe 3-MIRELA JANO zoteron *50 000 aksione . gjithsej pala blerese blene gjithsej 225 000 aksione(dyqinde e njezete pese mije aksione)*

Çmimi i blerjes te ketyre aksioneve eshte me 225 000 leke.

Palet e mesiperme kane rene dakort nepermjet perfaqesuesit te tyre dhe kan vendosur qe me vlere ne lek ti kalojne pales blerese keto aksione .

Sot u pagua teresisht shuma e lekeve jashte zyres se noterise leket per blerjen e kesaj shume te aksioneve .

Sot ,me nenshkrimin e kesaj kontrate shitjeje dhe likujdimit te shumes per blerjen e ketyre aksioneve , 225 000 aksione(dyqinde e njezete pese mije aksione) vihet ne dispiozicion te bleresit z. Sonila JANO si dhe i gjithe dokumentacioni i nevojshem ekzistues i proneise dhe gjendja faktike e rregjistruar ne pronesi te z. Sonila Jano 225 000 aksione(dyqinde e njezete pese mije aksione)

Bashkangjitur jane ; vertetimi i pronesise , Kopjet e e blerjes se aksione per sejcilin shites individualisht .

Kontrata e shitjes redaktohet ne TRE kopje me fuqi te barabarta vepruse, palet e lexojne me ze te larte, e kuptojne qarte dhe e firmosin ate me vullnetin e tyre te lire e te plote.Une Noterja pasi bindem per vullnetin e tyre te lire e te plote e legalizoj ate sipas ligjit.

SHITESIT

ANASTAS JANO ARSINO JANO MIRELA JANO

BLERSIT

SONILA JANO

NOTERE

Aferdita Haxhia

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1026 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Teuis Pekmezi madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Kontrata Shitblerje, Nr. 4687 Rep Nr 417 Kol, Ardiana Jano, me Kemile Jano

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

PUNE TAKSE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE - TIRANE
N. 10735 Rep.
N. 749 Kol.

KONTRATE DHURIMI
/aksioneve te shoqerise/

Sot, me daten 11.09.2004, perpara meje noterit, Agim Xh. Robo, anetar i Dhomes se Notereve, Tirane, ne zyren noteriale, ne Rrugen Ismail Qemali, P.27/1, u paraqiten palet kontraktuese, si me poshte : ----------

DHURUESI : Znj. Anila Refik Çoba, lindur ne Tirane, me 25 – mars 1965, banuese ne Tirane, n. pasaporte 0489062, poseduese e 50.000 (pesedhjete mije) aksioneve te shoqerise AMC sh.a., person juridik shqiptar i njohur dhe regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Tiranes; ----------

PERFITUESI : Z. Albert Isuf Çoba, lindur ne Tirane, me 1 – korrik 1957, banues ne Tirane, n. pasaporte 0489064, aksioner po ne shoqerine AMC, Tirane; ------

te gjithe persona madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat perkatese te identifikimit, te cilet, me vullnetin e tyre te lire kerkuan redaktimin e kontrates se dhurimit te aksioneve, me kushtet e meposhtme: ----------

Anila Çoba eshte aksionere ne shoqerine "AMC" sh.a., person juridik shqiptar, regjistruar ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Tiranes dhe zoteron 50.000 (pesedhjete mije) aksione te kapitalit themeltar te kesaj shoqerie dhe i dhuron te gjitha keto aksione, bashkeshortit te saj Albert Çoba. ----------

Dhuruesi garanton Perfituesin qe aksionet, objekt i kesaj kontrate, jane plotesisht te disponueshme, te trasferueshme dhe te lira nga çdo lloj pengu, ipoteke apo barre tjeter ligjore. ----------

Lidhur per sa me siper, bleresi Albert Çoba, perveç aksioneve qe zoteron tashme ne shoqerine "AMC" sh.a., behet pronar edhe i 50.000 (pesedhjete mije) aksioneve te Anila Çoba. ----------

Kontrata perpilohet ne nje faqe dhe tre kopje origjinale dhe ne baze te vullnetit te lire dhe te plote te personave pjesmarres. Pasi lexohet me ze te larte, deklarohet se eshte kuptuar, miratohet dhe firmoset rregullisht prej tyre dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit. ----------
---

DHURUESI
Anila Çoba

PERFITUESI
Albert Çoba

NOTERI
Agim XH. ROBO

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1627 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Ines Pekmezi madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Kontrate shitjeje, Nr 10735 Rep Nr. 749 Kol, Anila Çala dhe Albert Çala

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

TAKSË
100 LEKE
R.SHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE VLORE
NOTERE SAIMIRA HOXHA

Vlore me 08.09.2004
REP 2042
Kol 496

KONTRATE DHURIMI
(Pasuri e Lujteshme)
AKSIONESH
(Baza ligjore nenet 761 – 771 te Kodit Civil shqiptar)

Ne Vlore sot diten e Premte me date 10.09.2004 (dymije e kater) para meje Noteres se Rrethit Vlore,SAIMIRA HOXHA ,ne zyren time noteriale te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Vlore u paraqiten personalisht palet :

Me cilesine e pales dhuruese :

1. ***Nestor Jonuzi ,*** i biri i Tahsim ,lindur me 15.10.1944 ne Vlore e banues ne VLORE ne lagjen 28 Nentori .I panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit jam bindur nga Leternjoftimi me Nr 423964 e sserise UG.
2. ***Zilullahe Jonuzi ,*** e bija e Ibrahim ,lindur me 07.01.1920 ne Vlore e banues ne VLORE ne lagjen 28 Nentori .E panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit jam bindur nga Leternjoftimi me Nr 391503 e sserise UG.
3. ***Mentor Jonuzi ,*** i biri i Tahsim ,lindur me 01.08.1942 ne Vlore e banues ne VLORE ne lagjen 28 Nentori .I panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit jam bindur nga Pasaporta me Nr 1908407.
4. ***Lala Jonuzi ,*** e bija e Dushan ,lindur me 19.08.1951 ne Vlore e banuese ne VLORE ne lagjen 28 Nentori .E panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit jam bindur nga Leternjoftimi me Nr 391505 e sserise UG.
5. ***Ruben Jonuzi ,*** i biri i Mentor ,lindur me 07.10.1973 ne Vlore e banues ne VLORE ne lagjen 28 Nentori .I panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit jam bindur nga Pasaporta me Nr Z0291936.
6. ***Sofika Jonuzi ,*** e bija e Vasil ,lindur me 09.07.1975 ne Vlore e banuese ne VLORE ne lagjen 28 Nentori .I panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit jam bindur nga Pasaporta me Nr Z0763866.

Me cilesine e Perfituesit te Dhurimit:

7. ***Diana Jonuzi ,*** e bija e Dushan ,lindur me 14.11.1955 ne Vlore e banuese ne rruga ,, Ali Visha ,, Pallati 13 , shkalla3 , ap 6 Tirane .E panjohur prej meje Noteres per identitetin e te cilit jam bindur nga Leternjoftimi me Nr 391506 e sserise UG.

Madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar te cilet jane pronare te aksioneve ne masen : Zilullahe Jonuzi 100.000 leke, Mentor Jonuzi 75000 leke, Nestor Jonuzi 75000 lek , Lala Jonuzi 75000 leke, Ruben Jonuzi 75000 leke,Sofika Jonuzi 50000 leke . te cilat jane dorezuar ne AMC Tirane (Albanian Mobile Comunication) sias formulareve perkatesisht Zilullahe Jonuzi Nr 94/A date 11.12.2000, Mentor Jonuzi Nr 94/B date 11.12.2000 , Nestor Jonuzi , Nr 94/C date 09.12.2000 , Lala Jonuzi Nr 94/E date 09.12.2000 ,

Ruben Jonuzi Nr 94/F date 09.12.2000, Sofika Jonuzi , Nr 94 / G Date 09.12.2000.
Te kerkesave per blerje aksionesh per person fizik te AKP Tirane .
Me cilesine e pronareve dhuruesit Zilullahe Jonuzi, Mentor Jonuzi, Nestor Jonuzi , Lala Jonuzi, Ruben Jonuzi, Sofika Jonuzi ,deklarojne se ia dhurojne pa shperblim aksionet e tyre Zj . Diana Jonuzi , e cila I pranon shumat e aksioneve ne masen totale prej 425.000 (katerqind e njezete e pese mije) lekesh .
Me kete dhurim dhuruesit Zilullahe Jonuzi, Mentor Jonuzi, Nestor Jonuzi , Lala Jonuzi, Ruben Jonuzi, Sofika Jonuzi zhvishen nga pronesia mbi aksionet dhe pronare e tyre behet Diana Jonuzi .
Kontrata u lexua u kuptua dhe si u gjend sipas vullnetit te lire dhe te plote te paleve u nenshkrua rregullisht para meje noteres.
Me nenshkrimin e ketij akti Dhuruesi zhvishet nga pronesia dhe pronar vleres prej 425000l (katerqind e njezete e pese mije) lekesh behet perfituesi i dhurimit e cila deklaron se e pranon dhurimin e bere.

DHURUESIT

1. Nestor Jonuzi
2. Zilullahe Jonuzi
3. Mentor Jonuzi
4. Lala Jonuzi
5. Ruben Jonuzi
6. Sofika Jonuzi

PRANUESE E DHURIMIT

Diana Jonuzi

Une noterja pasi u binda per vullnetin e deklarimit hartoj aktin ne shtate kopje te barabarta ligjore, origjinali I pare I se ciles mbahet ne arshiven e kesaj zyre , njera I dergohet zyres se AKP Tirane dhe nga nje kopje u jepet paleve , e legalizoj dhe e vertetoj ne baze te nenit 39,51 te Ligjit per Noterine Dt 01/06/1994

NOTERE
SAIMIRA HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1628 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Ines Bakmazi madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkelidhur : Kontrate shitjeje Apartamenti Nr. 102 K.P. Nr. 2916/1, Vendbanim Tomori dhe Diana Jasiqi

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

SHTETI I SHQIPERISE TAKSE 100 LEKE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 1580 REP.
NR. 159 KOL.

PULLE TAKSE

KONTRATE DHURIMI

Sot ne Tirane me date 10.09.2004 (dymije e kater) perpara meje noteres se Dhomes se Notereve, Tirane Dylbere Elmazaj, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

(i) Z. **Agim Petrit KOÇI**, shtetas shqiptar, lindur me date 25/09/1952, mbajtes i pasaportes me nr. 1282396, (ii) Znj. **Hyrie Nexhip KOÇI**, shtetase shqiptare, lindur me date 07/07/1950; dhe (iii) Z.**Gentian Agim KOÇI**, shtetas shqiptar, lindur me date 27/03/1975, mbajtes i pasaportes me nr. Z0678701, te tre madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar; (te gjithe se bashku ne cilesine e *Dhuruesit*)

Dhe

Z. **Leonard KOÇI**, shtetas shqiptar, lindur me 15/04/1972, banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. Z0589418 (ne cilesine e *Pranuesit*)

MEQENESE

a) Te gjithe palet e kesaj kontrate jane pronare te ligjshem te 250 aksioneve me vlere nominale 1000 Lek qe perfaqesojne 0.0307192482% te kapitalit te shoqerise AMC, shoqeri anonime e themeluar dhe qe ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar.
b) Dhuruesit deshirojne te transferojne ne favor te Pranuesit pa kundershperblim, aksionet qe zoterojne ne shoqerine AMC, te zoteruara nga ata;

ATEHERE
Palet bien dakort per sa me poshte vijon:

Neni 1. Objekti i Kontrates

Sipas kushteve te parashikuara ne kete Kontrate, Dhuruesit i dhurojne Pranuesit dhe ky i fundit pranon prej tyre te gjitha aksionet qe zoterojne individualisht ne shoqerine AMC dhe ne menyre te detajuar:

Agim KOÇI, i dhuron Pranuesit nr. 75 aksione te cilat i zoteron ne shoqerine AMC.

Hyrie KOÇI, i dhuron Pranuesit nr. 75 aksione te cilat i zoteron ne shoqerine AMC.

Gentian KOÇI, i dhuron Pranuesit nr. 50 aksione te cilat i zoteron ne shoqerine AMC.

Neni 2. Transferimi i Titullit
Nepermjet nenshkrimit te kesaj kontrate, Pranuesi pranon te behet i vetmi titullar i ligjshem i nr. 200 (dyqind) aksioneve te zoteruara nga Dhuruesit ne shoqerine AMC, me vlere te pergjithshme 200,000 (dymilion) Leke, qe perfaqesojne 0.0307192482 % te kapitalit te kesaj shoqerie, dhe Dhuruesit zhvishen nga do e drejte mbi keto aksione.

Neni 3. Te Ndryshme
Kjo Kontrate Dhurimi, se bashku me dokumentet qe i bashkengjiten, perbejne te gjithe marreveshjen midis paleve ne lidhje me objektin e mesiperm.

Neni 4. Ligji i Zbatueshem
Palet bien dakort qe kjo Kontrate do te zbatohet dhe interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Per cfare nuk parashikohet ne kete Kontrate aplikohen dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise mbi dhurimin.

Kjo Kontrate Dhurimi e cila hartohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe, pasi i lexohet paleve me ze te larte nga une Noteri, dhe pasi ata e gjeten permbajtjen e saj ne perputhje te plote me vullnetin e tyre te lire, e nenshkruajne para meje dhe une Noteri e vertetoj nenshkrimin e tyre sipas ligjit.

Dhuruesit:

Agim KOÇI

Hyrie KOÇI

Gentian KOÇI

Pranuesi:

Leonard KOÇI

NOTERI

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1629 Rep

VERTETIM

Sot me datën 01/12/2006(dymije e gjashte) u paraqit Ines Pëllumbi madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Kontrata shitjes, Nr. 1580 Rep Nr. 158 Kol, Agim Koçi tek Leonard Koçi.

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE.
Nr. Rep. 1892
Nr. Kol. 158

KONTRATE DHURIMI

Ne Tirane sot me date 13.09.2004 (dymije e kater) para meje noteres Donika Konçi me qender ne Bulevardin "Zhan D'Ark" u paraqiten personalisht palet kontraktuese dhe kerkuan redaktimin e kesaj kontrate dhurimi si vijon:

DHURUESIT: 1. Halil Sula, i biri i Ymerit, lindur ne Tirane me 04 Prill 1935, identifikuar nga pasaporta Nr.0176626

2. Vaje Sula, e Rrapushit, lindur ne Tirane me 16 Prill 1943, identifikuar nga certifikata Nr.13 / 34.

3. Refat Sula i Halilit, lindur ne Tirane me 05 Dhjetor 1966, identifikuar nga certifikata Nr. 13 / 34.

4. Haki Sula i Halilit, lindur ne Tirane me 30 Tetor 1967, identifikuar nga pasaporta Nr.0176372.

; te gjithe madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Dhuruesit jane pronare aksionesh ne masen: Halil Sula 100 000 leke, Vaje Sula 75 000 leke, Refat Sula 50 000 leke, Haki Sula 50 000 te cilat jane dorezuar ne AMC Tirane (Albanian Mobile Communication), sipas formulareve Nr.47/a, 47/b, 47/c, 47/d, date 11.12.2000 te kerkesave per blerje aksionesh per person fizik te AKP.Tirane.

Me cilesine e pronareve dhuruesit Halil Sula, Vaje Sula, Refat Sula dhe Haki Sula deklarojne se ja dhurojne pa shperblim perkatesisht aksionet e tyre zotit Lulzim Sula, i cili i pranon shumat e aksioneve ne masen totale prej 275 000 (dyqind e shtatedhjetepesemije) lekesh.

Me kete dhurim Halil Sula, Vaje Sula, Refat Sula dhe Haki Sula zhvishen nga pronesia mbi aksionet e mesiperme dhe pronar i tyre behet Lulzim Sula .

Pronarit Lulzim Sula i lind e drejta te rregjistroje ne rregjistrin perkates te QRA Tirane pronesine mbi aksionet prej 275 000 (dyqind e shtatedhjetepesemije) lekesh te dhuruar nga Halil Sula, Vaje Sula, Refat Sula dhe Haki Sula.

Kjo kontrate u redaktua dhe vertetua ne 6 (gjashte) kopje, origjinali i pare i se ciles mbahet ne arshiven e kesaj zyre, njera i dergohet Zyres se QRA Tirane, dhe nga nje kopje u jepet paleve.

Une noterja pasi ju lexova paleve kontraktuese permbajtjen e Kontrates se mesiperme dhe konstatova se eshte sipas vullnetit te tyre, lejova nenshkrimin ne prezecen time dhe sipas ligjit i vertetoj ato.

Baza Ligjore:Neni 761 e vijuesa te Kodit Civil

DHURUESIT | **PRANUESI I DHURIMIT**

Halil Sula | **Refat Sula** | **Lulzim Sula**

Vaje Sula | **Haki Sula**

NOTERE

Donika Konçi

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1630 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Ina Dhimza madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkaldhur : Kontrata Shitjes, nr. 1182 Rep nr. 1062, Adil Sula ish Luzim Sula.

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

TAKSE LE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. Rep. 3325
Nr. Kol. 530

KONTRATE DHURIMI

Sot me date 14.09.2004 (dymije e kater) para meje noteres Diana Kamberi , me qender ne Tirane rruga "Mine Peza" u paraqiten personalisht palet kontraktuese dhe kerkuan redaktimin e kesaj kontrate dhurimi si vijon:

DHURUESIT:

1. **Bardhyl Drenofci**, i biri Ibrahimit, lindur ne Tirane me 14.09.1937, identifikuar nga leternjoftimi AZ Nr. 499636
2. **Gjylfida Drenofci**, e bija Hajdarit, lindur ne Tirane me 24.08.1949, identifikuar nga leternjoftimi UG Nr. 014881.
3. **Blerta Drenofci**, e bija e Besnikut, lindur ne Tirane me 19.06.1970, identifikuar nga leternjoftimi NF Nr. 483987.
4. **Elira Drenofci**, e bija e Bardhylit, lindur ne Tirane me 23.10.1973, identifikuar nga leternjoftimi QH Nr. 337238

dhe **PRANUESI I DHURIMIT**

Latif Drenofci, i biri i Bardhylit, lindur ne Tirane me 28.04.1970, identifikuar nga leternjoftimi NF Nr. 468399;

te gjithe madhore , me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Dhuruesit jane pronare aksionesh respektivisht ne masen:

Bardhyl Drenofci	100 000 leke;	Gjylfida Drenofci	75 000 leke;
Elira Drenofci	50 000 leke;	Blerta Drenofci	50 000 leke

te cilat jane dorezuar ne AMC (Albanian Mobile Communications) sipas formulareve respektive Nr. 37a, Nr. 37b, Nr. 37c, Nr. 37d date 10.12.2000 (dymije) te kerkesave per blerje aksionesh per person fizik te AKP Tirane.

Me cilesine e pronareve dhuruesit Bardhyl Drenofci, Gjylfida Drenofci, Elira Drenofci dhe Blerta Drenofci deklarojne se ja dhurojne pa shperblim perkatesisht aksionet e tyre zotit Latif Drenofci, i cili pranon shumen e aksioneve ne masen totale prej 275 000 (dyqind e shtatedhjetepesemije) lekesh.

Me keto dhurim Bardhyl Drenofci, Gjylfida Drenofci, Elira Drenofci dhe Blerta Drenofci zhvishen nga pronesia mbi aksionet e mesiperme dhe pronar i tyre behet Latif Drenofci.

Pronarit Latif Drenofci i lind e drejta te rregjistroje ne regjistrin perkates te QRA Tirane pronesine mbi aksionet prej 275 000 (dyqind e shtatedhjetepesemije) lekesh te dhuruar nga Bardhyl Drenofci, Gjylfida Drenofci, Elira Drenofci dhe Blerta Drenofci.

Kjo kontrate u redaktua dhe vertetua ne 6 (gjashte) kopje , origjinali i pare i se ciles mbahet ne arshiven e kesaj zyre, njera i dergohet Zyres se QRA Tirane dhe nga nje kopje u jepet paleve.

Une, noterja pasi ju lexova paleve kotraktuese permbajtjen e Kontrates se mesiperme dhe konstatova se eshte sipas vullnetit te tyre, lejova nenshkrimin ne prezencen time dhe sipas ligjit i vertetoj ate.

Baza Ligjore: Neni 761 e vijuesa te Kodit Civil

DHURUESIT | **PRANUESI I DHURIMIT**

Bardhyl Drenofci | **Gjylfida Drenofci** | **Latif Drenofci**

Elira Drenofci | **Blerta Drenofci**

NOTERE

DIANA KAMBERI

NOTERE
DIANA KAMBERI
TIRANË ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1631 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Irena Pelumbi madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Kontrati shitjes Nr. 13325 Rep Nr. 530 Kol, Bordigji Durrahai, ish Lotisi Durrahi

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

REPUBLIKA E SHQIPERISE TOLICA TIRANE
TEMBLE TAKSE
100 LEKE
REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. REP NR. KOL
2471 288

KONTRATE DHURIMI AKSIONE

Ne Tirane sot me date 14.09.2004 ,para meje noteres Xhevahire BRAHAJ me adrese ne Bulevardi " Bajram CURRI " prane Gjykates se shkalles se pare Tirane, per redaktimin e kesaj kontrate shitblerje kuota kapitali , u paraqiten personalisht palet ;

DHURUESIT : Gezim SULO i biri i Fiqriut i datelindjes 1944, banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin e te cileve u sigurova nga pasaporta me nr. 0368034.

Luljeta SULO e bija e Petritit e datelindjes 1949, me banim ne Tirane madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftim,i me nr. EV 055585.

PRANUESI I DHURIMIT : Edvin SULO, i biri i Gezimit e datelindjes 1974, me banim ne Tirane madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta e tij nr. QH 357930.

Objekti i Kontrates :

Dhurimi i 150 aksioneve e barabarte me 150.000 njeqint e pesedhjete mije leke ne kapitalin e shoqerise Albanian Mobile Communications sh.a .

Dhuruesit deklarojne se ne baze te ekstraktit te regjistrit te aksioneve kane perkatesisht

1. Gezim Sulo 75 aksione te barabarta me 75.000 leke
2. Luljeta Sulo 75 aksione te barabarta me 75.000 leke.
3. Edvin Sulo 50 aksione te barabarta me 50.000 leke .

Dhuruesit deklarojne se aksionet e tyre me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ja dhurojne pranuesit te dhurimit z. Edvin Sulo i cili deklaron se e pranon kete dhurim.

Kjo kontrate eshte hartuar ne baze te dispozitave te Kodit Civil dhe per çfare nuk eshte parashikuar ne kete kontrate do te zbatohen dispozitat e ketij kodi .

Kontrata u hartua ne ter kopje te barasvlefshme nga te cila t nga nje u jepet paleve dhe nje ruhet prane zyres se noterise perkatese. Kontrata pasi u hartua dhe u lexua nga palet dhe si u gjet ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote u nenshkrua prej tyre pa vrejtje ne prezencen e noteres. Une noterja e vertetoj ate konforme ligjit.

P A L E T

DHURUESI
GEZIM SULO

LULJETA SULO

PRANUESI I DHURIMIT
EDVIN SULO

N O T E R E
XHEVAHIRE BRAHAJ

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1632 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Ferid Rrumezi madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Kontrate shitjeje e gjeziri Sulo tek Edvini Sulo, nr. 2251 Rep, Nr 272 Kol.

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

TAKSE 100 LEKE R.S.SHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR REPERTORI: 4873
NR KOLEKSION: 577

AKT DHURIM
(AKSIONE NE AMC)

Sotsme daten 31.08.2004 (Dymije e Kater), ne Dhomen Noterise Tirane dhe para meje noteres se kesaj dhome te quajtures Mira M. VUKAJ, u paraqiten personalisht palet kontraktuese:

DHURUESIT: 1. Stavro Apostol Beka i datelindjes 05.04.1944, lindur ne Llongo Gjirokaster dhe banues ne Tirane Rr ' Isa Boletini « Nr 38, me leternjoftim numer QH 342122.

2. Bukurie Ismail Beka e datelindjes 1953, lindur dhe banuse ne Tirane rr « Isa Boletini « Nr 38, me leternjoftim numer AZ 467084.

PRANUES I DHURIMIT: 1. Amarildo Stavro Beka i datelindjes 16.09.1974. lindur dhe banues ne Tirane Rr " Isa Boletini " 38, me leternjoftim numer QH 342371.

Per identitetin e te cileve u sigurova ne baze te leter njoftimeve te tyre personale dhe pasi konstatova se I kane te gjitha aftesite e ligjes,me kerkesen e tyre I redaktova kete akt dhurimi Aksione te A.M.C. dhe qe me poshte pershkruhet..

Dhuruesit Stavro dhe Bukurie Beka I dhurojne Z.Amarildo Beka, (Djalit tyre) pjesen e plote te Aksioneve te A.M.C...

Keto aksione zotrohen nga dhurusit ne baze te Vertetimeve te AKP Tirane me Nr.aplikacioni 60/a dhe 60/ b date 10.12.2000 ....

Keto aksione pranohen me mirnjohje nga pranusi i dhurimit te mesiperm.

Ketij akti I bashkangjitet Aplikacioni i aksioneve te Qendres AKP.Tirane .

Ky akt pasi ju lexua me ze te larte te paraqiturve para meje paleve te ciilet duke u gjetur konform kerkimit dhe vullnetit te tyre te plote,ne prezencen time e pranuan aktin dhe e nenshkruan ate si me poshte rezulton

DHURUESIT

Stavro Beka
Stavro Beka

Bukurie Beka

PRANUESI I DHURIMIT

Amarildo Beka
Amarildo Beka

NOTERE
Mira M. VUKAJ

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1633 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit [illegible] madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : [illegible] Rep, [illegible]
[illegible]

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.
Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

BILLETA TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE.
Nr. Rep. 1902
Nr. Kol. 160

KONTRATE- DHURIMI

Ne Tirane sot me date 14.09.2004 (dymije e kater) para meje noteres Donika Konçi me qender ne Bulevardin "Zhan D'Ark" u paraqiten personalisht palet kontraktuese dhe kerkuan redaktimin e kesaj kontrate dhurimi si vijon:

DHURUESIT:

1. **Petrit Permeti,** i biri i Nuriut, lindur ne Tirane me 05 Prill 1931, identifikuar nga pasaporta Nr0422150
2. **Merzo Permeti,** e bija e Sabriut, lindur ne Tirane me 02 Shtator 1931, e identifikuar nga pasaporta Nr.0422149
3. **Arjana Permeti** e Petritit, lindur ne Tirane me 12 Gusht 1965, identifikuar nga pasaporta Nr.Z0602836
4. **Artur Permeti** i Petritit, lindur ne Tirane me 18 Prill 1969, identifikuar nga pasaporta Nr.1035631;

te gjithe madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Dhuruesit jane pronare aksionesh ne masen: Petrit Permeti 100 000 leke, Merzo Permeti 100 000 leke, Arjana Permeti 50 000 leke, Artur Permeti 50 000 te cilat jane dorezuar ne AMC Tirane (Albanian Mobile Communication), sipas formulareve Nr.20/a, 20/b, 20/c, 20/d, date 10.12.2000 te kerkesave per blerje aksionesh per person fizik te AKP.Tirane.

Me cilesine e pronareve dhuruesit Petrit Permeti, Merzo Permeti, Arjana Permeti, Artur Permeti, deklarojne se ja dhurojne pa shperblim perkatesisht aksionet e tyre zonjes Donika Permeti, e cila e pranon shumat e aksioneve ne masen totale prej 300 000 (Treqindmije) lekesh.

Me kete dhurim Petrit Permeti, Merzo Permeti, Arjana Permeti, Artur Permeti, ndivishen nga pronesia mbi aksionet e mesiperme dhe pronar i tyre behet Donika Permeti .

Pronares Donika Permeti i lind e drejta te regjistroje ne regjistrin perkates te QRA Tirane pronesine mbi aksionet prej 300 000 (treqindmije) lekesh te dhuruar nga Petrit Permeti, Merzo Permeti, Arjana Permeti, Artur Permeti.

Kjo kontrate u redaktua dhe vertetua ne 6 (gjashte) kopje, origjinali i pare i se ciles mbahet ne arshiven e kesaj zyre, njera i dergohet Zyres se QRA Tirane, dhe nga nje kopje u jepet paleve.

Une noterja pasi ju lexova paleve kontraktuese permbajtjen e Kontrates se mesiperme dhe konstatova se eshte sipas vullnetit te tyre, lejova nenshkrimin ne prezecen time dhe sipas ligjit i vertetoj ato.

Baza Ligjore:Neni 761 e vijuesa te Kodit Civil

DHURUESIT | **PRANUESI I DHURIMIT**

Petrit Permeti
P/ Arjana Permeti

Arjana Permeti
Arjana Permeti

Donika Permeti
Donika Permeti

Merzo Permeti

Artur Permeti
Artur Permeti

NOTERE

Donika Konçi

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1634 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Aleks Pekmezi madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Kontrate Shitjeje, Nr 1902 Rep Nr. 1600/02, Petrit Pekmezi tek Domiko Pekmezi
Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.
Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

TAKSE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERE

AKT DHURIMI
(AKSIONE)

Sot ne date 15.09.2004 (dymije e kater) ne Tirane lidhet kjo kontrate dhurimi aksionesh si me poshte :

DHURUESI:

Sami CARA , i biri i Ademit dhe i Nurijes i datelindjes 23.05.1936, lindur ne Durres dhe banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr NF 488152.

Vjollca CARA, e bija e Hysenit dhe e Menduhijes e datelindjes 30.03.1941, lindur dhe banues ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me leternjoftimin Nr EV 482166 .

Elvana CARA, e bija e Samiut dhe e Vjollces e datelindjes 16.07.1967, lindur dhe banuese ne Tirane , madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me pashaporte me nr. NF 480487 .

PRANUESE E DHURIMIT :

Nevila CARA, e bija e Samiut dhe e Vjollces e datelindjes 27.01.1975, lindur dhe banuese ne Tirane , madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me pashaporte me nr. QH 354498 .

Te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate dhurimi kuotash si me poshte :

Bazuar ne formularin Nr 1/01 date 04.12.2000 , Z. Sami Cara eshte pronar i nje shume aksionesh 100.000 (njeqind mije leke) prane Shoqerise " AMC" .
Bazuar ne formularin Nr 1/6 date 09.12.2000 , Zj. Vjollca Cara eshte pronare e nje shume aksionesh 75.000 (shtatedhjete e pese mije leke) prane Shoqerise " AMC" .
Bazuar ne formularin Nr 1/C date 09.12.2000 , Zj. Elvana Cara eshte pronare e nje shume aksionesh 50.000 (pesedhjete mije leke) prane Shoqerise " AMC" .

Me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhuruesat Z. Sami, Vjollca dhe Elvana CARA , aksionet e tyre te shenuara me siper ia dhurojne pa asnje kusht dhe kundershperblim, pranueses se dhurimit Zj. Nevila CARA .

Pala pranuese e pranon dhurimin qe i behet nga dhuruesat.

Ne keto rrethana Zj. Nevila CARA , se bashku me aksionet e saj ne vleren 50.000 leke , behet pronare e aksioneve gjithsej **275.000 leke** (dyqind e shtatedhjete e pese mije leke) prane "AMC".

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhuruesat zhvishen plotesisht nga pronesia mbi aksionet e mesiperme dhe pronare e tyre behet pranuesja e dhurimit **Zj. Nevila CARA**

Kontrata u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte , sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote e nenshkruan rregullisht

DHURUESA **PRANUESE E DHURIMIT**

Vjollca Cara Vjollca Cara

Sami Cara S. Cara

Nevila Cara

Notere Majlinda Lleshi

Dhoma e Notereve Tirane

Rr"S. Delvina "

Tel ++234555

Nr 6.P.65 **rep**

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot ne date 15.09.2004 (dymije e kater) ne Tirane ne Zyren e Noterise para meje Noteres **Majlinda Lleshi** u paraqiten personalisht

Sami CARA , i biri i Ademit dhe i Nurijes i datelindjes 23.05.1936, lindur ne Durres dhe banues ne Tirane , madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin Nr NF 488152.

Vjollca CARA, e bija e Hysenit dhe e Menduhijes e datelindjes 30.03.1941, lindur dhe banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me leternjoftimin Nr EV 482166 .

Elvana CARA, e bija e Samiut dhe e Vjollces e datelindjes 16.07.1967, lindur dhe banuese ne Tirane , madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me pashaporte me nr NF 450487 .

Nevila CARA, e bija e Samiut dhe e Vjollces e datelindjes 27.01.1975, lindur dhe banuese ne Tirane , madhore dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me pashaporte me nr QH 354498

per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat identifikuese te cilet deklaruan se sa me siper eshte nenshkruar prej tyre dhe une Noterja pasi e gjej te rregullt e vertetoj sipas ligjit.

PULLE TAKSE

100 LEKE

SHQIPERISE

TEL

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 2852 Rep

VERTETIM

Sot me daten 04 / 12 /2006(dymije e gjashte) u paraqit Irit Rekonga madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Leshtrete Shtetimi arsimnatës noterisë Sami Çaro e Nenila Çaro.

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

PULLE TAKSE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERE
Meri Çala

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 522 REP
NR. 318 KOL.

BULLE TAKSE 50 LEKE

KONTRATE DHURIMI AKSIONESH

Ne Tirane sot me date 17.09.2004(dymije e kater) perpara meje noteres Elsa Sina, me seli ne Rr."Mihal Grameno" u paraqiten personalisht palet kontraktuese si me poshte:

DHURUESI: Arben Bejko, i biri i Mit'hatit, lindur e banues ne Tirane, i datelindjes 09.03.1957, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr.0000557, ketu e me poshte referuar si Dhuruesi.

PRANUESI I DHURIMIT: Viollca Bejko, e bija e Abdullait, lindur e banuese ne Tirane, e datelindjes 09.03.1966, madhore e me zotesi te plote juridike e per te vepruar, e identifikuar me pasaporte nr.Z1017126, ketu e me poshte referuar si |Pranuesi i Dhurimit.

OBJEKTI I KONTRATES: DHURIM AKSIONESH.

Ne baze te raportit mbi shperndarjen e aksioneve te shoqerise "ALBANIA MOBILE COMMUNICATION" sh.a , qendra AKP Tirane(Ekstraktit te Regjistrit te Aksioneve) Dhuruesi ka ne zoterim 75 (shtatedhjete e pese) aksione me vlere 75.000 (shtatedhjete e pese mije leke).

Dhuruesi deklaron me vullnetin e tij te lire se keto aksione te depozituara si me lart ja dhuron PRANUESIT (bashkeshortes se tij), pa asnje kusht dhe kundershperblim dhe Pranuesi deklaron se pranon me mirenjohje kete dhurate.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate Dhuruesi humbet cdo te drejte reale mbi keto aksione ndersa Pranuesi i Dhurimit behet zoteruesi i vetem dhe i ligjshem i ketyre aksioneve.

Ne baze te kesaj kontrate palet detyrohen te bejne ndryshimet perkatese ne Rregjistrin Themeltar te Aksioneve perkatesisht dhe rregjistrimin ne favor te pranuesit te dhurimit Znj.Vjollca Bejko

Kontrata u hartua ne tre kopje nga une noteri, u lexua me ze te larte paleve dhe pasi u gjet e shkruar drejt dhe sipas vullnetit te tyre u nenshkrua regullisht ne pranine time.

Une noterja e vertetoj sipas ligjit.

PALET

DHURUESI:
ARBEN BEJKO

PRANUESI I DHURIMIT:
Vjollca Bejko

NOTERE
ELSA SINA

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1636 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01/12/2006(dymije e gjashte) u paraqit Ines Pekmezi madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Kontrate Blerjeje Akoimesh Nr. 5122 Rep , Nr. 318 Kol Artan Bejko , Gjulia Bejko

Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

BULLETAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

NOTERE

Taksa e pulles u pagua dhe u aplikua ne origjinalin e aktit te depozituar ne zyren e Noterise Peshkopi.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
ZYRA E NOTERISE DIBER
NR. 9183 REPERTORI"

NOTER PUBLIK
Ilir KRASHI
Studio Noteriale,Bulevardi
Nazmi Rushiti" Peshkopi

KONTRATE DHURIMI E AKSIONEVE

Ne qytetin e Peshkopise,sot me date 10.09.2004(dymije e kater)dite e premte,para meje **NOTERIT PUBLIK Ilir KRASHI,** i regjistruar ne **DHOMEN E NOTEREVE TIRANE**,me zyre ne bulevardin "Nazmi Rushiti"te qyteti te Peshkopise,u paraqiten personalisht palet:

DHURUESIT:1.AGIM BASHA , i biri i Ismailit,lindur me 1945 e banues ne qytetin e Peshkopise,i vetpunesuar,

2.GJYSLE BASHA e bija e Iljazit,lindur me 1947 e banuese ne qytetin e Peshkopise,ne pension,qe te dy me zotesi te plote juridike e per te vepruar,te njohur personalisht prej meje.

PRANUESI I DHURIMIT:ANITA BASHA(SPAHIU), e bija e Agimit,lindur me 1975 e banuese ne qytetin e Tiranes,identifikuar prej meje me pasaporten me numer 1650919,me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

OBJEKTI I KONTRATES:

Dhurimi I 150 aksioneve e barabarte me 150.000 leke ne kapitalin e shoqerise Albanian Mobile Communications sh.a.

Dhuruesit deklarojne se ne baze te ekstraktit te regjistrit te aksioneve te AKP-se,leshuar nga Qendra e Regjistrimit te Aksioneve,kane perkatesisht:

z.Agim Basha,75 aksione e barabarte me 75.000 leke

Znj.Gjysle Basha,75 aksione e barabarte me 75.000 leke.

Keto aksione dhuruesit me vullnetin e tyre te lire e te plote ja dhurojne pa asnje kusht che kundershperblim znj.Anita Basha(Spahiu), e cila e pranon kete dhurim.

Me noterizimin e kesaj kontrate dhe regjistrimin ne librin e aksioneve te shoqerise,dhuruesit c'vishen nga pronesia e 150 aksioneve e barabarte me 150.000 leke te kapitalit te shoqerise Albanian Mobile Communications sh.a, dhe pronar i tyre behet znj.Anita Basha (Spahiu).

Kjo kontrate hartohet ne baze te dispozitave perkatese te Kodit Civil per dhurimin dhe per cdo gje qe nuk eshte e permendur ne kete kontrate vlejne dispozitat e Kodit Civil per kontraten e dhurimit.

Kontrata lidhet sipas vullnetit te lire te paleve e bazuar ne kerkesat e nenit 761 e vijues te Kodit Civil e Ligjit Nr.7829 date 1.6.1994"Per noterine"ne tre origjinale me permbajtje te njete,nga te cilet nje origjinal depozitohet ne zyren e noterise Peshkopi e dy iu jepen paleve kontraktuese,te cileve pasi ju lexua nga ana ime permbajtja e kontrates e pasi u gjet ne perputhje me vullnetin e paleve,ata deklaruan para meje se e kuptuan dhe e pranuan ate,duke e shkruar dhe nenshkruar rregullisht ne pranine time dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit dhe per te gjitha efektet e tij.

DHURUESIT:	PRANUESI I DHURIMIT:	NOTER
Agim Basha	Anita Basha (Spahiu)	Ilir KRASHI
Gjysle Basha		

REPUBLIKA E SHQIPERIUSE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
STUDIO NOTERIALE
ÇALA & TOLICA
Nr. 1637 Rep

VERTETIM

Sot me daten 01/12/2006(dymije e gjashte) u paraqit Ilir Sekmexi madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar , per identitetin u njoha nga dokumenti i identifikimit u paraqit nga personi , i cili kerkoi nga une vertetimin me origjinalin te fotokopjes se dokumentit te bashkalidhur : Kontrat shitjemiedhsionove Nr 9783 Rep, Agim Bosha ne Anita Bosha.
Une noterja , pasi bera krahasimin e permbajtjes me dokumentin origjinal , nga verifikimi vertetova se kopja eshte e njejte me dokumentin origjinal.
Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te Ligjit 7829 date 01.06.1994 per noterine (i ndryshuar) sipas udhezimit te Ministris se Drejtesise Nr. 6291 date 17.08.2005 pika 3,4 ,7.

PUBLIKE TAKSE
100 LEKE
RSHQIPERISE

NOTERE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE FIER
NOTERE PUBLIKE ILDA SHARRA
NR.1573 Rep. Nr.478 Kol

KONTRATE DHURIMI
(Pasuri e luajtshme)

Sot me date ***15/09/2004 (pesembedhjete shtator dymije e kater***) ***dite e merkure*** ,para meje noteres **publike Ilda Sharra** me seli ne Fier u paraqiten personalishte palet e poshteshenuara te cilat ne baze te ligjit" Per noterine" me kerkuan redaktimin e Kontrates se Dhurimit me kete permbajtje:

PALA DHURUESE :

- ***NIKOLETA GJERMENI*** datelindja 1950 ,lindur e banuese ne Fier , madhore me zotesi te plote per te vepruar, njohur me Leternjoftmin personal Seria EV nr 425400 .
- ***ARISTIDH GJERMENI*** datelindja 1940 , lindur ne Lushnje e banues ne Fier , madhore ,me zotesi te plote per te vepruar ,njohur me leternjoftmin personal Seria AZ nr 441403 .

PRANUESE E DHURIMIT :

- ***GENTIANA GJERMENI*** datelindja 1975 , lindur ne Fier e banuese ne Tirane ,madhore ,me zotesi te plote per te vepruar,njohur personalisht prej meje noteres .

BAZA JURIDIKE E KONTRATES SE DHURIMIT

Eshte neni 761 e vijues i Kodit Civil.

Palet me vullnetin e tyre te lire dhe te plote me deklaruan se :

Pala dhuruese ka ne pronesine e saj ne baze te formularit te kerkesave per blerje aksionesh per person fizik nr 54/A dhe 54/B prane sha "A.M.C.", Bono privatizimi ne shumen 75.000 sejcili dhurues qe I perkasin 75.000 leke dhuruesit ARISTIDH GJERMENI dhe 75.000 leke dhurueses NIKOLETA GJERMENI .

